



MEDIA NË SHQIPËRI, PËRPARA PASQYRËS
MEDIA NË SHQIPËRI, PËRPARA PASQYRËS
MEDIA NË SHQIPËRI, PËRPARA PASQYRËS



Të dashur lexues,

Në dt.24 Nëntor 2017, Komiteti Shqiptar i Helsinkit (KShH) me mbështetje të organizatës suedeze Civil Rights Defenders organizoi konferencën “Media në Shqipëri përpara pasqyrës”.

Qëllimi i konferencës ishte vendosja e medias para pasqyrës për të diskutuar problematikat dhe sfidat me të cilat po përballet media dhe gazetarët në vendin tonë. Zakonisht gazetarët ndjekin dhe pasqyrojnë aktivitetet e terrenit, ndërkohë që problematikat që ekzistojnë për lirinë e shprehjes në Shqipëri nuk kanë patur vëmendjen e mjaftueshme të komunitetit të gazetarëve dhe rrjedhimisht edhe të publikut, i cili ka si burim kryesor informimi median.

Situata e aktuale e medias në Shqipëri u trajtua në këndvështrime reale dhe kritike në shumë dimensione nga të ftuarit e kësaj konference, mes të cilëve ambasadorë dhe përfaqësues të trupës diplomatike në vendin tonë, drejtues të redaksive të lajmeve, studiues e pedagogë të gazetarisë, juristë e përfaqësues të shoqërisë civile.

Me një larmi temash, të ftuarit analizuan problemet më të mëdha me të cilat përballet tregu mediatik sot, duke evidentuar edhe ndikimin e trendit global i cili ka shënuar regres në drejtim të respektimit të fjalës së lirë por gjithashtu edhe ndikimin e zhvillimit të epokës digjitale, të lidhjeve të papërshtatshme të interesave të biznesit dhe politikës me median. Në fokus të kësaj konference ishte edhe nevoja për një respektim më të mirë të të drejtave të gazetarëve, një pjese e të cilëve punon në informalitet, kufizohen për shkak të linjës editoriale dhe ndikimit të pronarëve të medias në transmetimin e fjalës së lirë dhe analizës profesionale. Shqetësuese në këtë drejtim janë mungesa e solidaritetit mes të gjithë gazetarëve, mungesa e mekanizmave vetërregullues të pavarur, përdorimi i fake neës si një kundërpeshë për tju kundërvënë medias, si dhe etiketimet me ngjyime ofenduese ndaj medias, të cilat e dëmtojnë fjalën e lirë dhe integritetin moral dhe profesional të gazetarëve.

Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut ka theksuar se gazetarët dhe organizatat joqeveritare kanë një funksion jetik të mbikqyrjes publike si dhe ndaj sundimit të ligjit, gjë që kërkon që ata ta bëjnë këtë në mënyrë të hapur dhe të sigurtë. Temat e trajtuara në këtë konferencë adresuan gjithashtu raportin mes fjalës së lirë dhe të drejtave dhe lirive të tjera të njeriut, kufizimet proporcionale dhe legjitime që parashikon Konventa Evropiane e të Drejtave të njeriut në këtë drejtim si dhe rolin e rëndësishëm që ka media për të promovuar diversitetin mes njerëzve, duke evidentuar nevojën për një vëmendje më të madhe ndaj problemeve sociale me të cilat përballen grupet në nevojë të shoqërisë shqiptare si rolin e rëndësishëm të medias në luftën ndaj diskriminimit.

Referatet dhe hulumtimet e të ftuarve të kësaj konference vijnë të publikuara për publikun dhe të gjithë të interesuarit në këtë botim të Komitetit Shqiptar të Helsinkit, me shpresën se ato do të jenë moment i rëndësishëm reflektimi për të gjithë aktorët që janë të interesuar të sjellin ndryshime pozitive për një media të lirë, profesionale dhe aktive në mbrojtje të të drejtave dhe lirive të gazetarëve por gjithashtu edhe të drejtave dhe lirive të shtetasve që përballen me padrejtësi dhe janë të pafuqishëm për të kërkuar të drejtat e tyre nga organet e pushtetit publik. Në këtë rrugëtim, bashkëpunimi mes medias dhe shoqërisë civile merr rëndësi të veçantë dhe duhet të fuqizohet.

Gjejmë rastin të shprehim falenderimet e sinqerta për mbështetjen dhe bashkëpunimin që kemi patur në realizimin e konferencës dhe të këtij botimi, nga përfaqësuesit e Civil Rights Defenders, Autoritetit të Medias Audiovizive, Ambasadës Suedeze në Shqipëri, Ambasadës së Mbretërisë së Vendeve të Ulëta në Shqipëri, Ambasadës Britanike në Shqipëri, gazetarët, juristët dhe aktivistët e të drejtave të njeriut që kontribuan me hulumtimet dhe analizat e tyre, Z. Kujtim Çashku në cilësinë e anëtarit të asamblesë së KShH dhe stafin e organizatës tonë, Z. Lutfi Dervishi që moderoi diskutimin. Jemi mirënjohës për kontributin e veçantë që është dhënë nga dy gazetaret profesioniste, Znj. Erida Gjermani dhe Znj. Karolina Risto, pa ndihmesën e të cilave kjo nismë e KShH-së do të kishte qenë e vështirë të bëhej realitet.

Sinqerisht,

Erida Skëndaj
Drejtoresh Ekzekutive

PËRMBAJTJA

<i>FJALA PËRSHENDETËSE MBI LIRINË E MEDIAS, NGA Z. JOHAN NDISI</i>	07
<i>FJALA PËRSHENDETËSE MBI LIRINË E MEDIAS, NGA, ZNJ. DEWI VAN DE WEERD</i>	09
<i>FJALA PËRSHENDETËSE MBI LIRINË E MEDIAS, NGA, Z. SEAN MELBOURNE</i>	11
<i>GAZETARI SHQIPTAR PËRBALLË SFIDAVE TË KOMUNIKIMIT NË EPOKËN DIGJITALE</i>	14
<i>MEDIA DHE PROBLEMATIKAT E MEKANIZMAVE VETËRREGULLUES TE SAJ</i>	25
<i>GJYKATA DHE MEDIA</i>	32
<i>FAKE NEWS TË QËLLIMSHËM APO NGA PAAFTËSIA?</i>	36
<i>EVOLUIMI ETIK I MEDIAS</i>	40
<i>MEDIA MES (VET)CENSURËS DHE POLITIKËS</i>	43
<i>MBROJTJA E BURIMEVE TË INFORMACIONIT TË MEDIAS</i>	48
<i>INVESTIGIMI NË SHQIPËRI, GAZETARËT E RINJ DHE NAFTA NË LABORATOR</i>	54
<i>LIRI MEDIATIKE? PO, POR PA REKLAMA</i>	60
<i>DISKRIMINIMI, NJË PERSON NUK ËSHTË I NDRYSHËM NËSE NUK E TRAJTON NDRYSHE</i>	65
<i>PREZUMIMI I PAFAJËSISË DHE MEDIA</i>	70



FJALA PËRSHËNDETËSE MBI LIRINË E MEDIAS, NGA Z. JOHAN NDISI

Liria e shprehjes dhe e informacionit është një nga themelet e një shoqërie të shëndetshme demokratike si dhe e rritjes sociale dhe ekonomike. Rrjedhja e lirë e ideve dhe informacionit është e domosdoshme për inovacionin dhe mbështet parimet e përgjegjësisë dhe transparencës brenda një shoqërie.

Për fat të keq, në mbarë botën, të drejtat e njeriut po sfidohen gjithnjë e më shumë. Hapësira demokratike për mbrojtësit e të drejtave të njeriut, opinionistëve, gazetarëve dhe bloggerëve, sa vjen e po tkurret. Auto-censurimi, legjislati represiv dhe kërcënimet, janë duke ua hequr zërin gazetarëve dhe shoqërisë civile, një tendencë kjo që duhet ndaluar.

Në vitin 2016, Suedia festoi 250 vjetorin e Aktit Suedez të Shtypit, që është një shtyllë e demokracisë dhe e para e këtij lloji në botë. Liria e shprehjes dhe liria e shtypit është një pjesë jetike e shoqërisë demokratike suedeze, dhe një kërcënim kundër saj përbën një kërcënim kundër vetë demokracisë.

Megjithëse një 250 vjetor ia vlen të kremtohet, Suedia ende përballet vazhdimisht me sfida ndaj lirisë së shtypit. Kjo tregon se liria e shtypit nuk mund të merret si e mirëqenë dhe se ne duhet të trajtojmë sfidat e mbetura, të ruajmë lirinë e shtypit dhe të mbështesim zhvillimin e medias, në Suedi, Shqipëri dhe në rang botëror.

Në Shqipëri, disa prej këtyre sfidave përfshijnë sigurimin e burimeve të financimit që lejojnë pavarësinë e plotë të qendrave mediatike nga interesat politike dhe private, si dhe përmirësimin e sigurisë në punë të gazetarëve. Asnjë gazetar nuk duhet ta shikojë të nevojshme ushtrimin e auto-censurës.

Suedia mbështet lirinë e shtypit dhe gazetarinë e guximshme përmes Mbrojtësve të të Drejtave Civile dhe Rrjetit Ballkanik të Gazetarisë Investigative. Suedia është e përfshirë me kënaqësi në promovimin e të drejtave të njeriut përmes partneritetit me organizata të tilla si Komiteti Shqiptar i Helsinkit ndër të tjera edhe në çështje të tilla si liria e shtypit.

Nga ana pozitive, themelimi i Këshillit të Mediave të Shqipërisë në vitin 2015, tregon angazhimin dhe synimin për të rritur transparencën, besueshmërinë dhe pavarësinë e medias në Shqipëri.

Peizazhi në ndryshim e sipër i mediave, me një sasi të madhe informacioni në dispozicion, shton kërkesat në rritje ndaj gazetarëve për sigurimin e fakteve dhe argumenteve kritike dhe të hulumtuara siç duhet, me qëllim që të mund të sigurojnë një burim thelbësor informacioni për qytetarët. Në këtë drejtim, Këshilli i Mediave Shqiptare luan një rol të rëndësishëm, duke siguruar forma të ndryshme të rritjes së kapaciteteve të gazetarëve dhe duke monitoruar mediat në Shqipëri.

Shoqëritë në mbarë botën duhet të pranojnë rëndësinë e medias, dhe vetë gazetarët duhet të mbajnë gjithmonë parasysh përgjegjësinë e rëndësishme që kanë.

Faleminderit.





FJALA PËRSHËNDETËSE MBI LIRINË E MEDIAS, NGA ZNJ. DEWI VAN DE WEERD

Është përsëri ajo kohë e vitit, kur qeveritë paraqesin buxhetet e tyre vjetore. Ne sapo e kemi bërë këtë në Holandë dhe parlamenti ynë kërkoi që më shumë para të shpenzohen në funksion të mbrojtjes së gazetarëve në botën mbarë. Ministri ynë i ri i Punëve të Jashtme, Halbe Zijlstra, e miratoi këtë kërkesë.

Përse?

Sepse, thënë me shprehjen e famshme, *Hjustën, kemi një problem.*

Disa fakte shkurtimisht:

- Lajmi i trishtuar është se liria e shtypit në mbarë botën është në nivelin historik më të ulët këtë vit.
- Vetëm 1 në 7 qytetarë kanë qasje në media të lira dhe të pavarura.
- Kërcënimi i medias vazhdon dhe kjo çon në auto-censurim dhe edhe më keq. Kjo bën që zërat e pavarur të heshtin.
- Sulmon respektimin e të drejtave të njeriut në demokracitë tona

Të tërë jemi në dijeni të kategorizimit që Freedom House i bëri Shqipërisë: *Shqipëria konsiderohet vetëm pjesërisht e lirë.*

- Me keqardhje më duhet të them se situata në Shqipëri nuk është ende në përputhje me standardet e BE-së.
- Me keqardhje më duhet të them që këtë pranverë një gazetare këtu u ngacmua seksualisht.
- Me keqardhje më duhet të them, që frikësimi i gazetarëve ndodh shpesh. Britmat dhe të sharat e shumta nuk favorizojnë një klimë respekti dhe lirie për të folurin. Njerëzit ndihen të kërcënuar.
- Me keqardhje më duhet të them që interesat e biznesit, medias dhe politikës duket se janë ngushtësisht të mpleksura në këtë vend.

Përkundër kësaj situatë, ka edhe disa lajme të mira, dhe unë do të doja të ndaja disa syresh me ju.

- Lajmi i mirë është se disa zëra të rinj mundën të ngriheshin këtë vit. Kam parë se qytetarët i kanë dhënë jetë një nisme të re dhe interesante, e cila nuk publikon vetëm lajme të këqija, por përqendrohet në historitë me interes njerëzor.
- Lajmi i mirë është se Shqipëria ka ambicie të qarta për të hapur negociatat me BE-në. Si një vend kandidat për anëtarësim, Shqipëria rrjedhimisht është zotuar që të sigurojë pluralizmin e peizazhit mediatik dhe krijimin e një mjedisi në të cilin gazetarët të ndjehen të lirë të bëjnë punën e tyre siç duhet.

Holanda monitoron përparimin e Shqipërisë në këtë drejtim, ashtu sikurse bëjnë edhe vendet e tjera anëtare. Ka ende hapësirë të konsiderueshme për përmirësim. Promovimi i lirisë së medias është dhe duhet të jetë një parim themelor i çdo demokracie.

Ne gjithashtu përpiqemi të japin ndihmesën tonë.

- Duke mbështetur nismat e pavarura për të dhëna më të hapura, të cilat të mund të për doren nga gazetarët dhe qytetarët.
- Duke mbështetur hulumtimet në treguesit që matin përparimin në media.
- Duke ofruar trajnime mbi gazetarinë investigative.

Pra, në lidhje me mediat shqiptare, le të shihemi në pasqyrë dhe të vërejmë se çfarë mund të bëjmë të gjithë së bashku për të forcuar shtypin e lirë në këtë vend.

Falënderoj KSHH-në për këtë nismë dhe AMA-n për mikpritjen e saj.

- Shqipëria ka nevojë që shumë më tepër zëra të pavarur të ngrihen.
- Institucionet e saj mediatike, duhet të luajnë rolin e tyre në mënyrë më të pavarur.
- Shtetasit dhe gazetarët mund të punojnë më shumë së bashku në fakt-mbledhje, nëpër blogje dhe në kraudfunding (apo me mbledhje fondesh nga baza e gjerë).



FJALA PËRSHËNDETËSE MBI LIRINË E MEDIAS, NGA Z. SEAN MELBOURNE

Unë e kam për nder që jam ftuar nga Komiteti Shqiptar i Helsinkit për të mbajtur fjalën time në këtë konferencë të sotme, mbi një temë të rëndësishme e cila duhet të na preokupojë të gjithëve.

Kjo bisedë rreth lirisë së medias vjen në një kohë kur në mbarë botën, liria e shtypit gjendet nën kërcënim. Sulmet ndaj gazetarëve janë shtuar, dhe disa shtete gjithnjë e më shumë po i kthehen me vetëdije dhe nganjëherë pa vetëdije përdorimit të masave kufizuese që kanë efektin e kontrollimit të prodhimit dhe përmbajtjes mediatike.

Mbretëria e Bashkuar gëzon një reputacion të njohur si përkrahëse e lirisë së medias në nivel ndërkombëtar; dhe ne përpiqemi të sjellim rezultate reale nëpërmjet nismave të shënjestruara mirë.

Rreth fillimit të këtij muaji, qeveria e Britanisë së Madhe, u angazhua të shpenzonte 1 milion paund gjatë vitit të ardhshëm financiar, në projekte që do t'u mundësojnë gazetarëve dhe specialistëve të mediave, promovimin e shtypit të tyre të lirë dhe përkrahjen e të drejtave të njeriut. Financime do të jenë të disponueshme për projektet e lirisë së shtypit në vendet ku liria e medias ndodhet nën trysni të konsiderueshme.

Ne e konsiderojmë lirinë e medias si një nga themelet kryesore të një demokracie plotësisht funksionale. Shtypi luan një rol kyç në sigurimin e përgjegjshmërisë dhe shtetit të së drejtës. Një media e lirë është jetike për krijimin e një popullate aktive, të informuar dhe të angazhuar, dhe ajo ndihmon në krijimin e një bote më të sigurt dhe më të begatë.

Popullsia e Shqipërisë do jetë në gjendje të marrë vendime të lira dhe të informuara për jetën dhe vendin e saj, po që se kjo liri do të pasqyrohet në institucionet e saj mediatike. Kjo mund të arrihet vetëm nëpërmjet qasjes tek opinione të sakta, të drejta dhe të paanshme, si dhe tek një shumëllojshmëri e zërave dhe informacionit.

Aftësitë e shtypit varen nga një mjedis ligjor që lejon lulëzimin e një sektori pluralist mediatik dhe që mbron gjithashtu një qasje të lirë në informacion. Qasja në informacion të pacensuruar, si dhe një shtyp i lirë, janë aspekte thelbësore përmes të cilave qytetarët mund t'i kërkojnë llogari qeverisë së tyre. Kjo ndihmon në garantimin e efektivitetit dhe reagueshmërisë së qeverive, gjë që është thelbësore për zhvillimin afatgjatë.

Shqipëria ka disa gazetarë individualë të shkëlqyer. Por një raport nga OJQ-ja e respektuar Freedom House për vitin 2017, vlerëson se Shqipëria ka një shtyp pjesërisht të lirë. Me fjalë të tjera 'nuk është keq, por duhet të bëhet shumë më mirë'.

Të tërë ne që jemi në këtë sallë, kemi një interes të përbashkët në nxitjen e lirisë së medias në Shqipëri. Së bashku, ne mund të punojmë për t'u siguruar që raportet e ardhshme të Freedom House dhe vlerësimet e tjera të pavarura, të tregojnë se Shqipëria ka arritur dhe mban një status të një vendi me "Shtyp të Lirë".

Faleminderit.

ABSTRAKT

GAZETARI SHQIPTAR PËRBALLË SFIDAVE TË KOMUNIKIMIT NË EPOKËN DIGJITALE

Trendi i zhvillimeve teknologjike në rang global në industrinë e medias ka ndikuar edhe funksionimin dhe zhvillimin e medias shqiptare, si nga aspekti teknik dhe infrastrukturor, po ashtu edhe në cilësinë dhe kushtet e burimeve njerëzore të angazhuara në këtë fushë.

Në ditët tona, publikët e shumëllojshëm po ekspozohen përballë flukseve të pakufishëm të informacionit, herë të kontrolluara e herë jo, nga burime të njohura apo anonime, duke ngritur kështu pyetjen dhe shqetësimin se “A na nevojiten më gazetarët?”.

Ky studim do të analizojë pikërisht rëndësinë e gazetarit në epokën e komunikimit digjital, sfidat me të cilat ai përballet, duke vënë theksin si në kushtet e punës në të cilat gazetarët punojnë dhe marrëdhëniet që ata ndërtojnë me aktorët e brendshëm dhe të jashtëm të redaksisë, por edhe në vetë cilësinë e gazetarëve dhe atyre që aspirojnë për të punuar në këtë profesion.

Analiza është mbështetur në metodat cilësore dhe sasiore të kërkimit shkencor, ku hapësirë u është kushtuar qasjeve të studiuesve të fushës, si edhe dy anketimeve të ndryshme të zhvilluara me gazetarë dhe studentë të gazetarisë brenda territorit të Republikës së Shqipërisë.

Në fund të studimit arrihet në konkluzionin se në kohën kur informacioni është më i bollshëm se kurrë më parë dhe në mungesë të një produkti cilësor informativ ai po humbet vlerë gjithnjë e më shumë; mediat shqiptare nuk janë ta gatshme të përballojnë sfidat e konvergimit; shkollat e gazetarisë dhe komunikimit duhet të përditësojnë dhe rishikojnë kurrikulat e tyre; si edhe domosdoshmëria për të ndërgjegjësuar gazetarët e rinj dhe studentët e gazetarisë për rëndësinë e profesionit të tyre.

FJALËT KYÇE: gazetari shqiptar, sfidat e gazetarisë, komunikimi digjital, roli i gazetarit

METODOLOGJIA

Nisur nga zhvillimet e vrullshme teknologjike në fushën e teknologjive të informacionit, studimi sjellë një analizë të kushteve, sfidave dhe profilit të gazetarëve shqiptarë, kryesisht atyre të rinj në epokën digjitale.

Studimi mbështetet në dy metodat themelore të kërkimit shkencor, cilësore dhe sasiore.

Në mbështetje të analizës cilësore, u jemi referuar disa autorëve kryesorë të fushës, vendas dhe të huaj, kryesisht punimeve dhe studime të zhvilluara gjatë viteve të fundit. Gjithashtu, është bërë edhe një analizë sipërfaqësore e faqeve të internetit të departamenteve të gazetarisë dhe komunikimit në universitetet shqiptare që e ofrojnë këtë formim.

Nga ana tjetër, analiza sasiore mbështetet në të dhëna parësore të mbledhura përmes dy anketimeve të zhvilluara me gazetarë dhe me studentë të gazetarisë. Anketimi i parë është zhvilluar në pranverën e vitit 2015 me rreth 370 gazetarë nga e gjithë Shqipëria, ndërsa i dyti është realizuar 377 studentë gazetarie dhe komunikimi në pesë universitete të ndryshme, Universitetin e Tiranës, Kolegjin Universitar Bedër, Universitetin Evropian të Tiranës, Universitetin Aleksandër Xhuvani në Elbasan dhe Universitetin Luigj Gurakuqi në Shkodër.

HIPOTEZA

Nisur nga të dhënat cilësore dhe sasiore të mbledhura në kuadër të këtij studimi, kemi ngritur hipotezën e mëposhtme:

Pavarësisht investimeve në infrastrukturën, për sa i përket produktit që ofron, media shqiptare nuk po arrin të kap trendin e përcaktuar nga zhvillimet teknologjike dhe konvergjenca në rrjet, si pasojë kjo e një modeli të dështuar ekonomik të saj, problem ky që mbështet edhe nga cilësia e burimeve njerëzore që përfshihen në këtë sektor.

Pyetjet kërkimore:

A premtori modeli ekonomik mbi të cilin mbështet media një të ardhme për gazetarinë shqiptare?

A premtorinë shkollat e gazetarisë shqiptare një formim cilësor profesional?

A janë gazetarët/studentët e gazetarisë një shpresë për të ardhmen e gazetarisë shqiptare?

DËSHTIMI I MODELIT TRADICIONAL

Gazetaria e ditëve tona po shoqërohet gjithnjë e më shumë nga një valë ndryshimesh që shpesh na shfaqen pozitive, e shpesh herë si negative. Zhvillimet dhe paqartësitë kanë ndikuar ndjeshëm të gjithë aktorët e përfshirë në këtë sektor, duke nisur nga ata të brendshëm si pronarët, drejtuesit e mediave, gazetarët e kushdo tjetër që është pjesë e zinxhirit të informacionit dhe përmbajtjes mediatike, e deri tek ata aktorë që kërkojnë të kenë ndikimin e tyre mbi gazetarët dhe median në përgjithësi, që kryesisht i përkasin politikës dhe biznesit, por jo vetëm. Kjo situatë aktuale e gazetarisë përbën shqetësim jo vetëm për gazetarët, por edhe për publikun, për modelet e biznesit në këtë fushë, si dhe për rolet dhe praktikën e gazetarisë si profesion.

Që në fillim duhet thënë se modeli ekonomik tradicional i dikurshëm tashmë ka dështuar. "Për mediat tradicionale, ku punon pjesa më e madhe e gazetarëve, problemi kryesor vjen më shumë nga të ardhurat, se sa nga audienca. Kjo e fundit migron me shpejtësi drejt internetit ku ajo rritet, por reklamuesit nuk e ndjekin.

Për fat të keq gazetat rrënohen në çastin kur audiencia e tyre globale rritet.” (Scherer 2012, 20) Jo vetëm gazetat, por të gjitha llojet e mediave konvencionale po përjetojnë krizën e largimit të audiencave, rrjedhimisht edhe humbjen e reklamuesve, të cilët po gjejnë mënyrat e drejtpërdrejta për të mbërritur tek konsumatorët. Në këto kushte kur burimi kryesor i medias së dikurshme, reklama, po çmediatizohet gjithnjë e më shumë, rrjedhimisht financimi i redaksive me qindra vetë duket gjithnjë e më i vështirë. Nga ana tjetër, duke parë cilësinë e produktit që mediat i ofrojnë konsumatorit, pra informacionin që i servira audiencave, mund të themi se mediat si biznese tashmë e kanë të vështirë të konkurrojnë mes tyre përmes këtij “mali” jo cilësor. E gjitha kjo ndodh pasi përpjekjet për të ulur kostot kanë efekte të rëndësishme mbi lajmin. “Kjo shoqërohet kryesisht me uljen e mbulimit të fushave të caktuara të lajmit si kultura, lokalja, bota, lajmi investigativ etj., uljen e numrit të gazetarëve profesionistë e me karrierë dhe zëvendësimin e tyre me gazetarë më të rinj për arsye të ndryshimeve në paga, mbushjen e edicioneve informative me më shumë lajme të ardhura përmes njoftimeve për shtyp etj..” (Çipuri 2016, 158)

Mark Cooper e ka analizuar këtë mënyrë të funksionuarit të medias si një rrugë që e çon atë drejt një tregu të dështuar. “Nisur nga ky model arsyetimi analitik, ai mendon se modeli komercial i kompanive mediatike, funksionimi i tyre brenda koncepteve të një tregu privat tejet të liberalizuar, atje ku veprojnë vetëm ligjet e tregut të mbështetur në logjikën e ‘fitimit maksimal’, është pikërisht problemi që përbën bazën e vështirësive ekonomike dhe financiare të mediave të sotme dhe mbi të gjitha të ndikimeve negative të tyre mbi gazetarinë cilësore.” (Çipuri 2016, 157)

Sipas Cooper, e para vlerë e ekonomisë së tregut është të hedhë në treg një mall të cilësisë së lartë. Një treg liberal i përzjerjes të interesave ekonomike, financiare dhe politike, është kundër misionit ekonomik të tregut, në rastin konkret, kundër mallit-informacion të dëshiruar. Duke i qëndruar rëndësisë së cilësisë së produktit që media prodhon, pra të informacionit, Cooper thotë se “nuk duhet anashkaluar mendimi se pika më e rëndësishme është se vlera e cilësisë së gazetarisë duhet të trajtohet në këndvështrimin e politikave botuese dhe jo në ato të ekonomisë. Roli i pushtetit të katërt është të ndihmojë qeverisjen e mirë. Gazetaria cilësore është mjeti që përdoret për të realizuar këtë mision. Zakonisht, kjo realizohet përmes monitorimit të pushteteve të tjera, pra të atyre politiko-shoqërore, ekonomike dhe sociale.” (Cooper 2011, 327)

Nga ana tjetër, vetë organizimi i redaksive të informacionit ka ndryshuar pothuajse tërësisht. Teksa numri i gazetarëve në redaksitë të mediave tradicionale ka pësuar rënie gjithnjë e më të madhe, numri i gazetarëve në redaksitë të mediave të reja po rritet me po të njëjtat ritme. Raportet e AKEP tregojnë se janë mbi 750 faqe online që janë licencuar brenda territorit të Republikës së Shqipërisë. Situata ka nxjerrë në pah shumë probleme të tjera brenda industrisë së medias. Redaksitë tradicionale duket se janë kthyer në burim informacioni për redaksitë të mediave të reja, gazetarët e të cilave përgjithësisht ndjekin transmetimet e drejtpërdrejta televizive për të mbushur hapësirat e pakufishmenë rrjet. Gara për të raportuar në kohë reale ka thyer çdo parim të mbështetur në etikën profesionale, ka nxitur mungesën e diskutimeve redaksionale para publikimit të një lajmi, si edhe ndër shumë të tjera ka dëmtuar edhe hierarkinë e dikurshme të redaksive. Informacioni nuk kalon më nëpër filtrat e tëashtuquajturve “gatekeepers”, por e gjen veten në ekranin e gjithkujt, kudo dhe kurdo.

SFIDAT KRYESORE TË GAZETARIT

Nisur nga vëzhgimet në terren, modeli ekonomik, shfrytëzimi i industrisë së medias për për interesa të caktuara, kushtet dhe sfidat e gazetarëve, kemi vlerësuar si sfidat më të rëndësishme të këtyre të fundit tre çështje kryesore, modeli ekonomik të industrisë së medias, shkollat e gazetarisë dhe komunikimit në Shqipëri, si edhe profilin e studentëve të gazetarisë dhe vizionin e tyre për të ardhmen në këtë profesion.

Mënyra se si mediat po funksionojnë në ditët e sotme të shtyjnë të mendosh se brenda kësaj industrie ka lindur një model i ri ekonomik, cilësia dhe mbarëvajtja e të cilit mund të jetë një objekt hulumtimi më vete. Modeli i dikurshëm i industrisë së mediave konvencionale duket se ka dështuar. “Kompani të tilla si Google, Facebook, Apple dhe Yahoo janë dominojnë tregun, zotërojnë miliarda dollarë sipërmarrje në tregun global dhe kanë tërhequr shumicën e reklamave, si edhe të ardhura të tjera prej të cilave mund të kishin përfituar mediat konvencionale. [...] Mediat konvencionale kanë qenë të ngadalta në përshtatjen e këtyre teknologjive brenda praktikave të bizneseve të tyre.” (Pavlik 2013, 184)

Marrëdhëniet midis mediave si industri prodhuese dhe qytetarëve si konsumatorë kanë ndryshuar rrënjësisht. Në kushtet e komunikimit interaktiv në Internet, ky raport na shfaqet me cilësi krejt ndryshe. “Gjithnjë e më shumë individë zotërojnë kompjuterët e tyre, lidhje në internet, telefona të lëvizshëm, dhe me miliarda prej tyre e prodhojnë vetë ata, e ritransmetojnë vetë ata, informacionin e marrë nga media apo të konceptuar në mënyrë krejt të pavarur.” (Fuga 2017, 743) Pra, jemi në kushtet kur vetë konsumatori është edhe prodhuesi i përmbajtjes së informacionit, gjë kjo që në një farë mënyrë vë në pikëpyetje rëndësinë dhe domosdoshmërinë e gazetarit, duke shtyrë edhe studiuesit e ndryshëm që të ngrenë pyetjen “A na duhen më gazetaret?” (Scherer 2012)

Në vijimësi të analizës që sjell Mark Cooper, i cituar më sipër, Artan Fuga rithekson cilësinë produktit-informacion, kushtet në të cilat ai prodhohet dhe çmimin e tij. “Një pjesë gjithnjë e më e madhe e informacionit është falas, në kuptimin që përdoruesi i tij nuk paguan asgjë për ta marrë atëspecifikisht.” (Fuga 2017, 743) Pra, jemi në kushtet që një industri prodhon mallra falas, e cila sipas Fugës, me rënien e komunikimit në duart e konsumatorit, krahas shumë pasojave pozitive dhe negative, çoi në lindje raportesh të reja pronësie midis dhënësit, marrësit dhe përmbajtjes së informacionit.


I gjithë ky info-obezitet, i cili në fakt është shumë më i madh se sa ai që konsumohet, dhe që vërtetësia e të cilit mbetet gjithnjë e shoqëruar me një dyshim, shtyn mediat konvencionale që të rendin pas kërkimit të publikëve të shumtë, të cilët duket se mund të tërhiqen vetëm përmes raportimeve mbi skandalet, kronikën e zezë, rubrikat rozë, etj., duke lënë jashtë rubrikat më të rëndësishme për të cilat publiku ka nevojë, por që ka mbërritur në stadin që nuk arrin ta kuptojë.

Analizuar nga aspekti i burimeve financiare të industrisë së medias, flukset e reklamave të dikurshme i përkasin vetëm së shkuarës. Bizneset kanë zhvilluar strategji të reja komunikimi me konsumatorët, në mënyrë të tillë që e anashkalojnë median konvencionale. Përmes mundësive që ofron interneti, ata arrijnë në shumë më shumë audiencë se sa mund të arrinin përmes ekraneve televizive, e atë më shumë përmes faqeve të gazetave apo emisioneve radiofonike. Kjo ka të bëjë me atë që studiuesit e quajnë “çmediatizim i reklamës”. “Reklama e çmediatizuar ka sjellë rënie të buxheteve të mediave dhe ka transformuar krejtësisht peizazhin mediatik në të gjithë planetin.” (Fuga 2017, 748)

Nisur nga gjithçka sa u tha më sipër, nga format e reja të konvergjençës mediatike dhe të mënyrës se si organizohen redaksitë e informacionit në mediat konvencionale dhe ato online, apo edhe në të gjithë mekanizmin që shoqëron zinxhirin e informacionit nga mbledhja, përgatitja e deri tek shpërndarja e tij tek audiencat, roli i gazetarit mbetet një temë që duhet studiuar me shumë kujdes.

Në këtë këndvështrim, janë të shumta sfidat kryesore që studiuesit sjellin në vëmendje. Sipas Artan Fugës, një sfidë ka të bëjë me rinovimin e kulturës profesionale të gazetarit. “Gazetari shqiptar ende nuk është i përgatitur nga përvoja e tij, nga formimi dhe nga tradita e vet, qetë përfitojë nga teknologjitë e reja të informacionit dhe të ndërtojë një komunikim interaktiv me audiencat e tij.” (Fuga 2017, 750) Nga një studim i zhvilluar në vitin 2015 me 370 gazetarë të anketuar, rezultoi se gazetarët shqiptarë nuk janë të shqetësuar nga reagimi i mundshëm i audiencave ndaj produktit-informacion që ata ofrojnë.

SA E VLERËSONI SI PROBLEM “HUMBJEN E BESIMIT TË PUBLIKUT NDAJ GAZETARISË”?



BURIMI; RAMADAN ÇIPURI, ANKETË E ZHVILLUAR ME GAZETARË SHQIPTARË, MARS-PRILL 2016

Siç vihet re edhe në grafikun e mësipërm, edhe pse gazetarët shqiptarë e vlerësojnë si një problem real humbjen e besimit të publikut ndaj gazetarisë, ata nuk para shqetësohen për këtë gjë. “Kur ata u pyetën në lidhje me këtë çështje, 140 nga 306 gazetarë (45.8%) e pohuan këtë problem si të rëndësishëm dhe 119 të tjerë (38.9%) si shumë të rëndësishëm. Pra, janë rreth 85 % e gazetarëve që bëjnë një vlerësim të tillë. Vetëm 10 gazetarë nga 306, ose 3.3% e tyre, e shikojnë si aspak ose jo të rëndësishëm, ndërsa 37 të tjerë ose 12.1% shprehen të pavendosur.” (Çipuri 2016, 283) Përpos këtyre përqindjeve mbi pranueshmërinë e fenomenit si problem, gazetarët shqiptarë nuk shqetësohen ndaj reagimeve të ndjekësve të tyre. “Kur u pyetën në lidhje me këtë çështje, vetëm 65 gazetarë nga 305 që dhanë opinion e vlerësuan audiencën si ndikuese në brendinë e lajmit. 155 të tjerë, ose rreth 50% e tyre, u shprehën se nuk ishin dakord me këtë gjë.” (Çipuri 2016, 283) Pra, raportojnë, por nuk ndjekin reagimin e audiencave.

Një tjetër problem i rëndësishëm që ka të bëjë me modelin e funksionimit të mediave shqiptare është përpjekja e tyre për të qenë gjithnjë e më shumë gjeneraliste, në një moment kur informacioni është gjithnjë e më shumë hiperlokal. E gjitha kjo bëhet me dëshirën për të pasur audiencë sa më të gjëra, por që në të vërtetë jep efekt të kundërt përse i përket imazhit të këtyre mediave përballë audiencave. Kjo është sfida e dytë që Fuga parashtron, e cila sipas tij ka të bëjë me profilin e orientimit të tyre thjesht si media gjeneraliste.

Sfida e tretë sipas Fugës është rinovimi i kulturës së administrimit të mediave. “Në disa media është kuptuar sikur versioni online është kopje elektronike e versionit të gazetës së shkruar apo sikur transmetimet në ekranin e televizionit kalojnë thjesht online duke krijuar mundësinë për t’u ndjekur edhe në ekranin e kompjuterit.” (Fuga 2017, 752) Është pikërisht ky shqetësim që Fuga ngre, sipas të cilit drejtuesit e medias nuk kuptojnë se audiencë pret tjetër kulturë shkrimi, raportimi dhe transmetimi të lajmeve online, më sintetike, më të vullshme, të aktualizuara minutë pas minute, të shkruar në formë jolineare, por me ndërthurje kodesh multimediale, si një sinkretizim midis tekstit, figurës dhe zërit.

SFIDA 2: SHKOLLAT E GAZETARISË DHE KOMUNIKIMIT NË SHQIPËRI

Nisur nga aftësitë e fituara gjatë shkollimit dhe eksperiencës profesionale, edhe sot e kësaj dite studimet e gazetarisë vlerësohen si shumë të rëndësishme për këdo që dëshiron të ketë një karrierë në industrinë e medias, por pse jo edhe në fusha të tjera. Pavarësisht përparësive që të ofron një profesion i tillë, shkollat e gazetarisë shqiptare, fatkeqësisht vazhdojnë të prodhojnë gazetarë për mediat konvencionale të dikurshme, duke mos përshtatur formimin e tyre me trendin gjithnjë e më shumë në rritje të teknologjisë dhe formave të reja të komunikimit dhe raportimit përmes internetit. Studentëve u mësohet gjithnjë e më pak se ata mund të kenë bizneset e tyre në këtë fushë, si dhe po aq pak ata ndihmohen për të hedhur një hap të tillë.

Studiues të shumtë kanë ngritur shqetësimin e mënyrës se si po edukohen gazetarët e rinj në shkollat e gazetarisë, gjë kjo që duket mëse evidente edhe në realitetin shqiptar.

Profesor në Arizona State University, Dan Gillmor thekson domosdoshmërinë për të krijuar një terren ku studentët e gazetarisë të përgatiten në një mjedis mëndërdisiplinar, për sa kohë që ata gjatë ushtrimit të profesionit të tyre bashkëpunojnë ngushtë me individë dhe çështje që vijnë nga profesione të tjera. “Ne duhet të nxitim me çdo kusht partneritet brenda universiteteve, me degët e biznesit, inxhinierive kompjuterike, me filmin, shkencat politike, drejtësinë dhe programe të tjera.” (Gillmor 2016, 816)

Gazetarët e së ardhmes mund të mos punojnë drejtpërdrejtë me programuesit e rrjeteve kompjuterike, por ata së paku duhet të marrin disa kurse rreth programeve më të thjeshta, përtej paketës Windows, në mënyrë që të kuptojnë se si duhet të komunikojnë me specialistët e informatikës. Ata duhet të dinë si të ndërtojnë një blog, si të përdorin JavaScript etj.. Studentëve të gazetarisë u duhen mësuar teknikat e iniciativave individuale, të ashtuquajtura si start up.

Gazetarët e rinj sot, por që nesër do të jenë profesionistë të së ardhmes, duhet që me çdo kusht të kuptojnë bazat e statistikës, të rëndësishme këto jo vetëm për të zhvilluar sondazhe kërkimore, por edhe për të kuptuar sa më qartë të dhënat që lexojnë. “Fatkeqësisht, gazetarët dhe studentët e gazetarisë janë shumë të dobët në matematikë dhe këtë e tregojnë me çdo mënyrë.” (Gillmor 2016, 816) P.sh. mediat raportojnë gjithnjë e më pak gjëra që kanë të bëjnë me statistikat dhe ekonominë në përgjithësi, duke i krijuar hapësirë gjithnjë e më shumë lajmeve të kronikës, terrorit, etj. Në fakt, ky është një keq orientim i audiencave.

Një nga problemet e mëdha të shkollave të gazetarisë është se ato nuk ju mësojnë studentëve të tyre modelin e biznesit të mediave në të cilat këta studentë do të punojnë. “Shkollat e gazetarisë duhet të pajisin studentët e tyre me kurse të posaçme rreth koncepteve të biznesit, sidomos me ato që kanë të bëjnë me funksionimin e medias.” (Gillmor 2016, 816)


“Shkollat e gazetarisë nuk mund të izoloohen brenda ishujve universitar, të shkëputura nga komuniteti, sidomos në një kohë kur mediat konvencionale po zbehen dhe po dështojnë nga dita në ditë”. (Gillmor 2016, 816) Edhe pse nuk mungojnë projektet e orientuara drejt nevojave të agjencive publike apo komuniteteve të ndryshme, në të cilat angazhohen kryesisht stafet akademike, studentët e gazetarisë përgjithësisht mbeten jashtë këtyre praktikave.

Mjafton një lundrim sipërfaqësor në faqet e internetit të departamenteve të gazetarisë dhe komunikimit në Shqipëri, për të kuptuar shqetësimin në lidhje me këto çështje. Kurrikulat e publikuara në to janë shumë të vjetra për një fushë kaq dinamike siç është ajo e medias dhe komunikimit. Këto kurrikula, duhen përditësuar në mënyrë të vazhdueshme, mbase edhe çdo vit, duke i pasuruar ato me zhvillimet më të fundit. Edhe pse nuk mund të konsiderohet justifikim, por që mund të hapë një tjetër temë diskutimi dhe hulumtimi, përkrah vullnetit të stafeve akademike të këtyre shkollave, pengesë në këtë drejtim mbetet edhe legjislati shqiptar mbi arsimin e lartë, sipas të cilit çdo përditësim kurrikule me mbi 20-25 % të saj, të kushtëzohet me një proces të gjatë administrativ për riorganizimin e këtyre programeve. Në realitetin shqiptar, ky proces përveç energjive të harxhuara nga burimet njerëzore të përfshira në të, shoqërohet edhe nga kosto financiare, të cilat përgjithësisht kthehen në pengesë kur bëhet fjalë për universitete private, por pse jo edhe për ato publike.

SFIDA 3: MUNGESA E DËSHIRËS PËR PROFESIONIN DHE VIZIONIT PËR TË ARDHMEN TEK GAZETARËTE RINJ

Një tjetër problem i rëndësishëm dhe që duket se i paraprin ditëve të vështira për gazetarinë shqiptare ka të bëjë edhe me profilin e studentëve të gazetarisë dhe komunikimit, të cilit që në auditorët universitarë karakterizohen nga një mungesë e theksuar e vizionit dhe dëshirës për të ushtruar këtë profesion. Sipas një anketimi të zhvilluar në janar të vitit 2016 me 377 studentë gazetarie dhe komunikimi, përfshi këtu edhe një departament komunikimi dhe marrëdhëniesh me publikun në pesë universitete shqiptare, në Universitetin e Tiranës, Kolegjin Universitar Bedër, Universitetin Evropian të Tiranës, Universitetin Aleksandër Xhuvani në Elbasan dhe Universitetin Luigj Gurakuqi në Shkodër, rezultojnë se një pjesë e rëndësishme e tyre, mbi 34 për qind, ose thënë ndryshe 130 nga 377 në total preferojnë të profilizohen në fushën e marrëdhëniesh me publikun dhe jo në media. Ndërkohë, për të qartësuar raportet midis studentëve të gazetarisë dhe atyre të marrëdhëniesh publike që u kontaktuan, vlen të theksohet fakti se nga të intervistuarit janë vetëm 68 studentë që vijojnë studimet për marrëdhënie publike.

CILA FUSHË JU PËLQEN PËR T'U PROFILIZUAR NE PROFESIONIN TUAJ?



BURIMI: ANKETIM I ZHVILLUAR NGA RAMADAN ÇIPURI, JANAR, 2016

Studentët e gazetarisë duket se janë të shkëputur pothuajse tërësisht nga mediat konvencionale, pasi burimi kryesor i informimit për ta mbeten mediat e reja. Rreth 72% e tyre, ose 268 nga 377 të anketuar, e pranojnë këtë fakt. Kjo ndodh pavarësisht se shumica e atyre që preferojnë të ushtrorin gazetarinë pëlqejnë më shumë televizionin (rreth 40%) dhe i besojnë gjithashtu më shumë atij (rreth 68%).

CILËS MEDIEJE I BESONI MË SHUMË?

	FREKUENCA	PËRQINDJE	PËRQINDJA E VLEFSHME	PËRQINDJE KUMULATIVE
Gazetës	52	13.8	13.8	13.8
Radios	3	0.8	0.8	14.6
TV	253	67.1	67.1	81.7
Burimeve në internet (portale etj)	69	18.3	18.3	100.0
Total	377	100.0	100.0	

TË VLEFSHME

BURIMI: ANKETIM I ZHVILLUAR NGA RAMADAN ÇIPURI, JANAR, 2016

Në këto kushte, sjellim në vëmendje shqetësimin e përmendur me sipër të ngritur nga Artan Fuga, se mediat shqiptare nuk janë të përgatitura për llojet e ndryshme të transmetimeve, apo çështjet e diskutuara në vijim, ku edhe pse trendi kërkon përditësim të kurrikulave mësimore në përshtatshmëri me zhvillimet teknologjike, ato sërish mbeten të vjetruara. Pra, në një farë mënyrë, qasja dhe dëshira e studentëve të gazetarisë nuk përputhet me atë që ndodh në realitet.

Nga ana tjetër, studentët e gazetarisë dhe komunikimit nuk lexojnë më gazeta.

Të dhënat nga anketa tregojnë se mbi 28 për qind e studentëve të gazetarisë nuk lexojnë asnjëherë gazeta, ndërkohë që ata që lexojnë një ose dy herë në javë një gazetë janë në rreth 51 për qind, ose e thënë ndryshe 191 nga 377 të anketuar.

Janë më pak se 6 për qind e tyre që lexojnë gazeta çdo javë.

NË SA DITË TË JAVËS LEXONI GAZETA?


	Frekuenca	Përqindje	Përqindja e vlefshme	Përqindje kumulative
0	82	21.7	21.7	28.2
1	116	30.8	30.8	52.5
2	75	19.9	19.9	72.4
3	48	12.7	12.7	85.1
4	14	3.7	3.7	88.9
5	20	5.3	5.3	94.2
6	22	5.8	5.8	100.0
Total	377	100.0	100.0	

BURIMI: ANKETIM I ZHVILLUAR NGA RAMADAN ÇIPURI, JANAR, 2016

Studentët e gazetarisë nuk lexojnë libra.

Rreth 6 për qind e tyre pranojnë se nuk lexojnë asnjë libër jashtë shkollor gjatë një viti akademik, rreth 26 për qind lexojnë 1-2 libra, rreth 36 për qind lexojnë 3-4 libra, rreth 14 për qind lexojnë 5-6 dhe rreth 18 për qind lexojnë mbi sasinë e fundit. Ndërkohë, shumë pak prej tyre, vetëm 8.5 për qind lexojnë libra që kanë të bëjnë me profesionin. Rreth 79 për qind preferojnë të lexojnë ro-mane.

SA LIBRA JASHTËSHKOLLOR LEXOINI GJATË NJË VITI?



BURIMI: ANKETIM I ZHVILLUAR NGA RAMADAN ÇIPURI, JANAR, 2016

Studentët e gazetarisë duket se kohën e lirë ia kushtojnë kryesisht rrjeteve sociale. Siç vihet re edhe në tabelën e mëposhtme, rreth 60 për qind e tyre kalojnë nga 2 deri në 4 orë në ditë në rrjetet sociale.

Sa orë në ditë shpenzoni mesatarisht në rrjetet sociale?

	Frekuenca	Përqindje	Përqindja e vlefshme	Përqindje kumulative
Nuk përdor	11	2.9	2.9	2.9
1-2 orë	54	14.3	14.3	17.2
2-3 orë	131	34.7	34.7	52.0
3-4 orë	92	24.4	24.4	76.4
4-5 orë	41	10.9	10.9	87.3
+5 orë	48	12.7	12.7	100.0
Total	377	100.0	100.0	

TË VLEFSHME

BURIMI: ANKETIM I ZHVILLUAR NGA RAMADAN ÇIPURI, JANAR, 2016

PËRFUNDIME

Nisur nga të dhënat dhe analiza e mësipërme, arrijmë në përfundimin se media shqiptare, e mbështetur në një model ekonomik që nuk premtan të ardhme dhe konkurrencë brenda aktorëve që përbëjnë këtë industri, në mungesë të një plani strategjik për të marrë masat e duhura, do të rrezikojë gjithnjë e më shumë të ardhmen e saj. Ideja se i njëjti produkt mediatik mund të ofrohet përmes formave të ndryshme, në transmetimet konvencionale dhe ato në internet, nuk mund të funksionojë, gjë kjo që është karakteristikë e medias shqiptare.

Shkollat e gazetarisë shqiptare duhet të përmirësojnë dhe përditësojnë ofertat e tyre, duke i përshtatur ato me zhvillimet teknologjike që karakterizojnë industrinë e medias dhe komunikimit.

Përmirësimi i industrisë së medias dhe i ofertës së shkollave të gazetarisë do të ndikojë edhe në motivimin e studentëve të gazetarisë dhe komunikimit, të cilët do të jenë garancia e së ardhmes së këtij profesioni.

BIBLIOGRAFIA

Çipuri, Ramadan. 2016. Vetëcensura, realitete të gazetarisë shqiptare. Tiranë: Papirus.

Cooper, Mark. 2011. «The future of journalism: Adressing pervasive market failure with public policy.»
Në Will the last reporter please turn out the lights? The collapse of journalism and What can be done to fix it,
320-339. New York: The News Press.

Fuga, Artan. 2017. Metamorfozë dhe metakomunikim. Tiranë: Papirus.

Gillmor, Dan. 2016. «Towards a New Model for Journalism Education.» Journalism Practice 815-819.
doi:10.1080/17512786.2016.1164998.

Pavlik, John V. 2013. «Inovation and the future of journalism.» Digital Journalism 1: 181-193. doi:10.1080/21670811.2012.756666.

Scherer, Eric. 2012. A na duhen më gazetarët? Përkthyer nga Tomi Nakuçi. Tiranë: Papirus.

MEDIA DHE PROBLEMATIKAT E MEKANIZMAVE VETERREGULLUES TE SAJ

HYRJJE

Në udhëzuesin e OSBE (2008) mbi vetë-rregullimin në media jepen pesë argumente mbi nevojën e vetë-rregullimit: nevoja për liri editoriale, nevoja për të minimizuar ndërhyrjen e shtetit, nevoja për të inkurajuar cilësinë e mediave, nevoja për përgjegjshmëri në media dhe nevoja që lexuesve tu ofrohet akses në media. Me të drejtë praktikrat perëndimore bëjnë dallimin midis nevojës për vetë rregullim të medias, rregullim ligjor të saj, dhe censurës apo auto-censurës, dy koncepte mbi të cilat është pamundësua media e lirë gjatë më shumë se një gjysmëshekulli në Shqipëri. Vetë-rregullimi ka të bëjë me “vendosjen e parimeve minimale për etikën, saktësinë, të drejtat personale e kështu me radhë duke ruajtur njëkohësisht lirinë editoriale në raportimet dhe opinionet e shprehura. Ai mbron në të njëjtën kohë të drejtën e gazetarëve për të qenë të pavarur dhe për t’u gjykuar në lidhje me gabimet e tyre profesionale jo nga ata që janë në pushtet, por nga kolegët e tyre”.

Koncepti i vetë-rregullimit të medias është i ri në Shqipëri për vetë komunitetin e medias dhe shumë më i ri për komunitetin e gjerë që media ka për objekt trajtimi e informimi. Trajtesa e mëposhtme analizon faktorët ndikues në gjendjen e brishtë të mungesës së instrumenteve vetë-rregullues, historikun e përpjekjeve për organizim të vetë gazetarëve, problematikave dhe specifikave në raport me sektorët e tjerë në Shqipëri. Duke e analizuar mjedisin mediatik si pjesë të mjedisit shoqëror dhe politik, punimi shpjegon lidhjet midis medias e politikës, midis medias tradicionale dhe medieve të reja, midis komunitetit të medias dhe pakicës pronare të saj, raportet midis medias dhe legjislacionit, dhe mbi këtë bazë ofron vlerësime, gjetje dhe rekomandime për ndërhyrje përmirësuese për të ardhmen.

MEDIAT PLURALISTE SI VIJIM I MEDIEVE TW VJETRA

Ne ryshimi i sistemit politik në Shqipëri u shoqërua me lindjen e shtypit të ri, medias pluraliste. Në ikjen nga modeli i gazetave në shërbim të një partie gjatë regjimit të kaluar, krijuam gazetën e parë në sistemin e ri, - një gazetë të re por përsëri partiake. Dallimi? Media e re i përkiste një partie të dytë politike, konkurruese me partinë e parë. Pra pluralizmi politik u shoqërua dhe lindjen e partive të reja konkurruese politike dhe bashkë me to, edhe të mediave të reja partiake konkurruese mes tyre. Titujt e parë më të njohur krahas “Zëri i Popullit” u bënë “Rilindja Demokratike”, “Republika”, Alternativa SD”, “Kombi”, “Atdheu”, “Balli i Kombit”, “Aleanca”, etj, të gjitha gazeta zyrtare të partive politike. Edhe pas 27 vitesh ne mbetemi nga vendet e pakta në kontinent ku gazetat partiake vijojnë të jenë aktive dhe citohen në pasqyrimin e shtypit të ditës.

¹ OSBE / Miklós Haraszti, “Udhëzues për vetërregullimin e mediave”, Vjenë 2008

² Po aty

Hapi i dytë i krijimit të medias pluraliste ishte shndërrimi i gazetave të tjera satelite të PPSH në gazeta të pavarura. Kështu ndodhi me të gjitha gazetat kryesore, përfshirë “Bashkimi”, “Puna”, “Zëri i Rinisë”, “Drita”, “Hosteni” dhe deri tek “Sporti”. Sot pothuajse të gjitha nuk ekzistojnë më, për shkak se mungoi burimi kryesor i mbijetesës, - financimi, i cili gjatë regjimit të kaluar ishte detyrë partie, kurse në fazën e parë të tranzicionit u arrit falë donacioneve të ndryshme ndërkombëtare. Ka gazeta lokale që mbijetuan, përfshirë “Koha Jonë”, të cilat u përshtaten me tregun dhe mbijetuan kryesisht përmes donacioneve indirekte politike.

Nismat e pjesshme për krijim të mediave të reja, titujve të rinj dhe praktikave të reja informative fillimisht rezultuan të dështuara. Edhe nismat e redaksive të gazetave të reja “partiake” për të përçuar informacion më pluralist nga tradita e gazetave partiake, gjithashtu dështuan. Gazeta “RD” ndryshoi katër kryeredaktorë në dy vitet e para të saj, në proces identifikimi të profilit të saj në kushtet e pluralizmit politik dhe të një medie të ndërvarur nga një parti politike. E njëjta praktikë ndodhi edhe me mediat e tjera partiake, si dhe me RTSH, ATSH dhe strukturat e tyre lokale informative.

Kjo panoramë e kalimit nga media në izolim në median pluraliste vlen për të theksuar problematikët dhe paradokset me të cilat nisi pluralizmi politik dhe mediatik në Shqipëri. Të njëjtat cilësi i gjejmë edhe në mekanizmat e përfaqësimit të medias, përfshirë mekanizmat rregullatorë dhe vetë-rregullatorë.

GAZETARËT DHE KRIZA E VETË – PËRFAQËSIMIT

Në fillim të viteve '90, rolin kryesor në përfaqësimin e medias vijoi ta kishte Bashkimi i Gazetarëve të Shqipërisë, (BGSH), organizatë satelite e PPSH. Ajo trashëgonte struktura, anëtarësi të zgjedhur, mjedise pune dhe financim të qëndrueshëm nga shteti. Drejtuesit e saj ishin njëherësh edhe drejtues politikë, kryesisht me burim nga gazetatat kryesore të regjimit, “Zëri i Popullit” dhe “Bashkimi”. Në vitet e para të tranzicionit roli dhe funksioni i BGSH u kufizua ndjeshëm derisa u bë i parëndësishëm. Gazetarët e angazhuar në mediat e reja refuzuan procesin reformues në BGSH dhe për pasojë, me nxitjen e qeverisë së re të djathtë ose opozitës së majtë lindën një sërë nismash të reja për krijime të shoqatave të gazetarëve.

Nevoja për përfaqësim dhe rregullim të vetë medias, për sindikata brenda medias dhe për raporte të reja mbi të drejtat e përgjegjësitë me pushtetet e tjera nxiti disa nisma për krijim të organizatave të reja për gazetarët. Shumica e tyre ishin nisma me bazë media të caktuara, ku secila media e madhe dhe secila palë në media (palë pro qeverisë apo kundër saj) donte të kishte shoqatën e vet dhe ku inspirues u bënë këshillat dhe asistencat e vazhdueshme ndërkombëtare në këtë drejtim. Në memorien e medias mund të citohen disa shoqata të tilla, ku më kryesoret janë Shoqata e Gazetarëve Profesioniste (1993), Lidhja e Gazetarëve (1994), Forumi i Medias së Lirë (1998), Shoqata e Mediave Elektronike, etj. Prej më shumë se një 15 vitesh katër këto shoqata drejtohen nga gazetarë por njëherësh edhe investitorë në media, Armand Shkullaku, Aleksandër Frangaj, Ylli Rakipi dhe Mero Baze. Tre prej tyre janë sipërmarrës edhe në fusha të tjera jashtë medias dhe secili prej tyre ka pasur ose vijon të ketë media të ndryshme private në pronësi.

Aktiviteti i tyre ka qenë aktiv në rastet e skandaleve që lidhen me raportet media – politikë, kryesisht përmes deklaratave publike dhe raste të veçuara të protestave në publik. Ato u bënë aktive sidomos në fazat e kalimit të legjislationit mbi median, mbi RTSH apo AMA (ish KKRT), si dhe në disa prej rasteve të incidenteve të dhunshme të zyrtarëve ndaj gazetarëve. Duke qenë vetë drejtues të medias, asnjëra prej tyre nuk kishte fokus mbrojtjen e të drejtave të gazetarëve, sidomos të drejtave të tyre në redaksi, në marrëdhënie me pronarët e medias apo në aspektin e të drejtave ndaj të të tretëve, ku bëjnë pjesë politika apo grupe biznesi, sponsorizuese të enteve botuese të vetë drejtuesve të shoqatave. Gjurmët e tyre sot ruhen ende në ndonjë raport mbi median nga organizatat ndërkombëtare, në pjesëmarrje në konferenca apo seminare jashtë vendit, por jo në cilësinë e përfaqësimit dhe mbrojtjes së të drejtave dhe pozitës së gazetarëve në Shqipëri.

Gjatë një debati parlamentar në legjislaturën e kaluar, deputeti ish gazetar A.Peza, citohet të jetë shprehur se “për sa i përket Shoqatës së Gazetarëve Profesionistë, kam qenë de jure dhe de facto 20 vjet anëtar i kësaj shoqate dhe kemi bërë vetëm një mbledhje në vitin 1994 apo 1995, kur 10 Preç Zogaj, që ishte atëherë kryetar i shoqatës, u zëvendësua nga Armand Shkullaku. Që atëherë as nuk jemi mbledhur, as nuk kemi marrë karta, as nuk kemi paguar kuotizime dhe de facto ajo ekziston vetëm nëpër letra nëpër gjykata, ndërsa në praktikë, unë 20 vjet si gazetar, asnjëherë nuk jam ndjerë pjesë e aktiviteteve, duke qenë anëtar i saj”. Të njëjtin arsytim e gjejmë edhe në citime të tjera nga gazetarë të njohur referuar grupimeve të tjera të krijuara në vite, të cilat, më shumë se shoqata përfaqësuese të medias dhe mbrojtëse e të drejtave të tyre, kanë funksionuar si instrumente të përkohshme lobimi dhe prezantimi për drejtuesit e saj.

Shembuj të tillë dëshmojnë se struktura e tyre funksionare ka mbetur në çdo kohë jo transparente dhe jo përfaqësuese. Duke ndjekur modelin e partive politike, edhe shoqatat e medias u identifikuan me drejtuesin e tyre dhe nuk pati asnjëherë rregulla të brendshme demokratike funksionimi apo zgjedhore. Për pasojë, fuqia e tyre në veprim dhe besueshmëria e tyre në publik pësu-an rënie të vazhdueshme, saqë sot pjesa më e madhe e publikut dhe e vetë medias, nuk është në dijeni as të ekzistencës së tyre. Shumica e drejtuesve të shoqatave të mediave në momente të caktuara kanë hyrë në politikë, kanë kandiduar për deputetë apo janë zgjedhur në poste drejtuese në parti të ndryshme politike, duke miksuar identitetin publik midis njeriut të medias dhe njeriut politik.

MJEDISI AKTUAL PËRFAQËSUES NË MEDIA

Shqipëria prej vitesh ka Kod Etik për median, ka legjislacion dhe akte të tjera me synime rregullatore në media, por efikasiteti i tyre praktik është minimal. Kodi Etik nuk ka instrumenta etike funksionale, gazetarët nuk kanë Këshill Etike për të vlerësuar vetveten dhe ankimimet e lexuesve/shikuesve, si dhe në përgjithësi asnjë media nuk e njeh dhe as e zbaton atë në integritetin e tij. Përpjekjet e më shumë se një dekade më parë e ndonjë media për të pasur drejtues etik në redaksi, rezultoi jo e suksesshme dhe aktualisht një pozicion i tillë nuk ekziston në asnjë nga mediat publike e private.

OSBE ka sugjeruar se hartimi i Kodeve të Etikës është përgjegjësi e vetë gazetarëve dhe se nuk kërkohet domosdoshmërisht konsultim e pjesëmarrje e grupeve botuese e pronarëve të medias. Ata mund të përfshihen vetëm nëse janë gazetarë, por përcaktues janë vetë gazetarët. Në rastin shqiptar grupet botuese dhe pronarët e medias janë shumë më aktiv dhe më përcaktues sesa gazetarët në çdo vendimmarrje që lidhet me median, përfshirë jetësimi i Kodit Etik, respektimi i Kodit të Punës, i standardeve të lirisë së informimit, etj. Edhe në rastet e përpjekjeve për krijimin e grupeve të vetë-rregulluara të gazetarëve që janë aktualisht ende prezent në media, dominues janë pozitave drejtuese nga drejtues mediash dhe drejtues të OJF-ve apo aktiviteteve të tjera, që përdorin angazhimin mediatic si angazhim dytësor. Vetë gazetarët e redaksive nuk kanë ndonjë organizim sindikal funksional, me përjashtim të ndonjë grupimi të pjesshëm dhe të përkohshëm midis gazetarëve ekonomistë, gazetarëve socialë, gazetarëve të kronikës apo korrespondentëve.

Problematike mbetet debate mbi legjitimitetin e përfaqësimit të interesave të medias. Në mars 2017 KQZ, në zbatim të Kodit Zgjedhor dhe detyrimit për ngritjen e Bordit të Monitorimit të Medias (BMM) në fushatën elektorale njoftoi se nga verifikimi në Gjykatën e Faktit Tiranë ka identifikuar 83 organizata që veprojnë në fushën e medias, nga të cilat 57 nuk kishin adresa aktuale të identifikueshme. Në këtë listë gjenden subjekte aktive si qendra “Rrjeti Ballkanik për Gazetarinë Investigative” BIRN, Fondacioni “Instituti Shqiptar i Medias”, “Shoqata Unioni i Gazetarëve Shqiptarë”, etj, ashtu edhe subjekte pa identitet e njohje publike (shumica e subjekteve).

³ Komisioni për Edukimin dhe Mjetet e Informimit Publik, Procesverbal, më 24.10.2016, Tiranë.

Shifra 83 organizata nënkupto se kemi një numër të madh shoqatash dhe OJF të tjera që veprojnë në fushën e medias, një rekord për një vend të vogël si Shqipëri, por fakti se mbi 90% e tyre janë emërtime e krijime formale, pa aktivitet dhe pa identitet publik e madje as zyrtar, tregon se kemi të bëjmë me fiktivitet në përfaqësim dhe një realitet tjerët nga ai që ofrojnë statistikat gjyqësore.

Fiktiviteti i organizimeve të tilla është fenomen shoqëror tranzicioni, - ndodh tek partitë, tek OJF-të, etj, por në dallim nga to, një pjesë e këtyre organizatave fiktive të medias (keq)përdoren sa herë kemi procese zgjedhore për në organet në varësi nga Kuvendi (AMA, Këshilli Drejtues i RTSH, BMM, etj), pasi e drejta e tyre e propozimit përdoret nga aktorët politikë për të përzgjedhur si përfaqësues të medias individë, të cilët shpesh nuk kanë lidhje profesionale me median.

Gjatë viteve të fundit kemi pasur aktivitet më të rregullt nga grupime të dekadës së fundit, sic është Unioni i Gazetarëve, kryesisht në debate mediatike, në raportime përpara institucioneve, në qëndrime në mbrojtje të gazetarëve apo në aktivitete lokale të degëve. Në faqën zyrtare të organizatës ka informacion minimal, megjithatë meritojnë vlerësim pozitiv disa nisma të saj, përfshirë denoncimin e nivelit të lartë të informalitetit në media, gjendjen sociale të gazetarëve, presionin politik apo inkurajimi me çmime kombëtare të disa prej gazetarëve.

Një faktor pengues për standarde më të larta të funksionimit të medias dhe organeve rregullatore të saj është sistemi abuziv i marrëdhënieve midis politikës dhe mediave. Çdo mazhorancë sapo vjen në pushtet kalon në tri faza të marrëdhënieve me median, - në fazën e kompromentimit të saj përmes kompromentimit të pronarëve kryesorë investues në to, në fazën e marrjes nën kontroll të AMA, TVSH, ATSH dhe rrjetin publik të informacionit dhe më pas në fazën e denigrimit të medias, injorimit të saj, investimit për ta bërë atë të pabesueshme dhe kundërvënëse ndaj prioriteteve të shoqërisë. Retorika e ish kryeministrit Nano në vitet 2002-2004 dhe e ish kryeministrit Berisha në vitet 2011-2013 ishte e njëjtë me retorikën që përdor aktualisht kryeministri Rama në mandatin e dytë të tij dhe njëherësh, krejt e kundërt me retorikën e ligjërimit e zotit Nano në vitet 1997-1999, zotit Berisha në vitet 2005-2007 apo zotit Rama në vitet e para të qeverisjes 2013-2015.

Nga ana tjetër secila mazhorancë promovon dhe financon media e gazetarë pro saj, duke imponuar një sistem të përmbysur vlerash dhe referimi. Po ashtu, çdo mazhorancë vazhdimisht krijon media të reja përmes investimeve informale, sidomos vitet e fundit me mediat sociale. Vetëm në fushatën e fundit zgjedhore 2017 u krijuan më shumë se 100 blogje të reja politike, të financuara nga tri partitë kryesore politike, Partia Socialiste, Partia Demokratike dhe Lëvizja Socialiste për Integrim. Funkzioni i tyre është dukshëm propagandistik dhe desinformues duke e shndërruar fenomenin e "fake news" në sistem mediatik në Shqipëri.

PËRFUNDIME DHE REKOMANDIME

Legjislacioni mbi median gjatë tranzicionit është përshkruar nga tri tipare:

- e para, nga ndërhyrjet e vazhdueshme politike në hartimin e ligjeve bazë apo në ndryshimet ligjore në funksion të qëlli meve politike të momentit, sic ndodhi vitet e fundit edhe me zgjedhjen e drejtorit të përgjithshëm të TVSH;
- e dyta, nga amendimet ligjore sa herë kemi rotacion politik, sidomos në legjislacionin rregullator për TVSH, për AMA apo për Kodin Zgjedhor
- e treta, nga kundërshtitë ligjore të atilla sa vënë në pikëpyetje parime të ligjeve të mëparshme, siç ishin kundërshtitë midis legjislacionit mbi median dhe Kodin Zgjedhor (2017), legjislacioni mbi lirinë e medias, të drejtën e informimit, ligjin mbi të dhënat personale apo aktet ligjore mbi sekretin shtetëror, etj.

⁴ Njoftim i KQZ. <http://www.cec.org.al/sq-al/Kreu/ID/579/Deklarate-per-shtyp>

Media dhe mjedisi mediatik në Shqipëri është po aq i brishtë sa mjedisi civil, akademik dhe vetë niveli i shtetit të së drejtës. Ai reflekton problematikat komplekse të vetë shoqërisë dhe tranzicionit. Media shqiptare nuk ka mekanizma funksionalë vetërregullues dhe rregullues, dhe ndodhet ende në fazën e krijimit të identitetit të saj në rivalitet të ashpër midis mediave tradicionale e të reja, midis mediave me mbështetje politike dhe atyre që duan të mbrojnë interesin publik.

Në tërësi mund të evidenton dhjetë faktorë pengues për standarde më të larta të vetë-rregullimit e medias shqiptare:

1. Brishtësia e komunitetit të gazetarëve, interesat e kundërta të tyre dhe rendja në përgjithësi e gazetarëve kryesorë pas rrjedhave dhe ofertave politike periodike
2. Zhgënjimi nga modelet e organizatave të deritanishme, mungesa e besimit se një organik sindikalist do të mund të ofron te mbrojtje për të drejtat e gazetarëve
3. Brishtësia e sistemit të financimit të medias, puna e gazetarëve në media si mbijetesë ekonomike, mungesa e pavarësisë në profesion dhe në financim dhe rrezikimi i kontratave të punës
4. Politikat e gabuara dhe pragmatiste të donatorëve ndërkombëtarë, kryesisht të zyrtarëve të BE, OSBE, etj, - të cilët i kanë përqendruar asistencat e tyre financiare në mbështetje të mediave të caktuara luajale apo shoqatave fiktive luajale, pa arritur të krijojnë një mjedis mediatik konkurrues dhe as organe vetërregulluese të verifikueshme dhe efektive
5. Dominimi i medias nga gazetarë biznesmenë, gazetarë botues dhe gazetarë politikanë, - interesi i përbashkët i tyre për të pamundësuar ekzistencën e mekanizmave të transparencës, llogaridhënies, cilësisë dhe konkurrencës profesionale
6. Politikat monopol përmes marrëveshjeve zyrtare dhe informale midis botuesve kryesorë kundër gazetarëve kritikë, pa mundësia e një tregu mediatik mbi vlerat e aftësisë e konkurrencës
7. Përqendrimi i medias kryesisht në Tiranë, kufizimi madje vetëm në aksin kryesor të kryeqytetit, kalimi i medias lokale në shtojcë të administratës lokale, dhe pamundësia për një rrjet kombëtar të medias dhe punonjësve të saj
8. Rivaliteti i ashpër midis formave të ndryshme të medias, - medias së shkruar, asaj elektronike, medias sociale, dhe formave të tjera mediatike, - deri në atë masë sa konkurrenca e ashpër për dominim dhe reklama përjashton ekzistencën e tjetrit dhe i gëzohet dështimit të tij
9. Fokusimi i kufizuar i programeve mësimore mbi këto problematika në studimet mbi gazetarinë dhe marrëdhëniet publike në universitetet shqiptare
10. Mjedisi dekurajues i organizimeve civile në Shqipëri, në lëvizjet sindikaliste, ndjenjën e komunitetit dhe kolektivitetit, sensin e promovimit të të drejtave jashtë të drejtës personale, sensi i përgjegjësisë në profesion dhe në marrëdhënie me publikun.

Në 10 vlerësimet e mësipërme duhen kërkuar edhe mjetet e rrugët e mundshme të ndërhyrjeve dhe fokusit të ardhshëm për të përmirësuar gjendjen e medias dhe për të krijuar standarde më të larta të rregullimit dhe vetë-rregullimit të saj. Gjatë muajit nëntor 2017 disa prej botuesve kryesorë të mediave të shkruara dhe sociale arritën në akord parimor midis tyre për rregulla etike kundër plagjiaturës së lajmeve dhe të drejtave të autorit mbi lajmet e ditës. Nisma u diktua nga fenomeni i masivitetit të medieve të reja sociale, shumica e të cilave nuk prodhojnë, por vetëm sa qarkullojnë lajmet e gazetarëve të rregullt të redaksive.

Në këtë këndvështrim nisma është pozitive dhe një tregues se nëse redaksitë e ndryshme në media kanë interesa të përbashkëta mund të kërkojnë dhe të arrijnë kompromise etike dhe mekanizma rregullatorë midis tyre. Të njëjtat praktika i kemi parë edhe në raste të tjeran specifike, kur një numë redaksish kanë mbajtur qëndrime publike të përbashkëta, sidomos në rastet kur cenohen interesat financiare të tyre. Nëse këto praktika pozitive do të shtriheshin edhe në akordin për legalizimin sipas legjisllacionit të punës dhe aktivitetit në media, me kontrata të rregullta dhe me elementë të rregullt të Kodit të Punës, dhe më tej, në akord kundër “fake neës” që prodhohen me shumicë edhe kundër vetë medieve e gazetarëve, atëherë do të kemi të bëjmë me një fazë të re reagimi e ndërgjegjësimi.

Bashkëveprimi i faktorëve të mësipërm në sensin pozitiv, sidomos midis komunitetit të medias, organizimit të tyre sindikal dhe etik horizontal, do të mund të krijojnë një mjedis të ri shumë mediatik sesa politik, do të legjitimonin punën dhe profesionet në media, do të krijojnë identitete mediatike dhe do t'i lejojnë gazetarët e qytetarët të krijojnë një marrëdhënie të re ndërvarësi dhe ndikimi të dyanshëm. Ky mund të jetë proces i gjatë, që kërkon kohë dhe investime, ndërgjegjësim dhe kulturë qytetare, rritje profesionale dhe hapësirë më konkurruese, por gjithsesi, duke pasur një axhendë dhe objektiv afatgjatë do të jetë më e lehtë fokusimi në to, si për median, ashtu edhe për institucionet vendimmarrëse dhe partnerët donatorë ndërkombëtarë.

GJYKATA DHE MEDIA

Si duhet të jetë gjyqtari në një sistem demokratik ?

Ish Kryetari i Gjykatës së Lartë të Izraelit Aharon Barok në librin e tij “Gjyqtari në demokraci” për portretizimin e figurës së gjyqtarit i referohet vetes së vet. Ai shkruan:

“Si gjyqtar unë nuk kam platformë politike. Nuk jam person politik. I djathtë dhe i majtë, fetar dhe laik, i pasur dhe i varfër, burrë dhe grua, i aftë dhe i paaftë, të gjithë janë të barabartë në sytë e mi. Të gjithë janë qenie njerëzore. Nuk kërkoj të sundoj. Unë i njoh zinxhirët që më lidhin si gjyqtar dhe si kryetar i Gjykatës së Lartë. E kam theksuar shpesh sundimin e ligjit dhe jo të gjyqtarit. Unë e shoh detyrën time si mision. Të gjykuarit nuk është punë është mënyrë jetese. Sa herë që hyj në sallën e gjykimit hyj me ndjenjën e thellë se ndërsa gjykoj pres edhe të gjykohem”.

Lidhur me këtë portretizim konçiz dhe kuptimplotë mund të bëhet pyetja:

A është kjo e arritshme ?

Po, kjo është e arritshme, por nuk është e lehtë. Është një proces relativisht i gjatë. Nuk mund të flitet për përsosmëri. Por nuk mund të pretendosh për shtet të së drejtës nëse gjykatat nuk janë të pavarura. Janë gjykatat e pavarura ato që garantojnë shtetin e së drejtës dmth sundimin e ligjit. Pavarësia e gjyqësorit është sanksionuar në Kushtetutë dhe në ligj por kjo mund të ngelet slogan nëse nuk i mbyllet rrugët ndërhyrjeve dhe presioneve të kundraligjshme mbi gjykatat në tërësi dhe në veçanti mbi gjyqtarin. Ashtu siç korrupsioni godet pavarësinë edhe pavarësia nuk lejon korrupsionin. Korrupsion ka në shumë fusha, por në sistemin gjyqësor ai është më i ndjeshëm dhe shpesh me pasoja më të dëmshme. Janë organet shtetërore që në kundërshtim me ligjin çenojnë të drejtat e shtetasve. Por në fund të fundit janë gjykatat që i rivendosin ato.

Mungesa e pavarësisë reflekton në paanshmërinë që është parim tjetër i rëndësishëm në një shoqëri demokratike. Të jesh i paanshëm do të thotë të mos paragjykoj, t'i shmangesh konfliktit të interesit, të jesh i papërlyer, të respektosh parimin e prezumimit të pafajësisë. Pavarësia dhe paanshmëria nuk mund të shkëputen nga niveli i profesionalizmit nga standartet gjithmonë në rritje të gjykimit dhe vendimarrjes. Në këtë drejtim roli i medias është mjaft i rëndësishëm.

Media nuk mund të heshtë kur diçka ka interes për publikun. Gazetaria investigative nuk mund të tërhiqet, nëse dalin ose zbulohen prova apo fakte të reja që nuk dihen më parë dhe që janë shmangur apo manipuluar. Ajo edhe në Shqipëri nuk është një mision i pamundur, por kërkohet profesionalizëm, durim, këmbëngulje dhe guxim. Gazetaria investigative mbështetet në fakte edhe pse ato mund të mos jenë plotësisht të sakta dhe del nevoja e verifikimeve të mëtejshme nga organet përkatëse të drejtësisë.

Në çështjen Fre de Rua kundër Francës, Gjykata e Strasburgut është shprehur:

“Gazetarët përfitojnë nga mundësitë e publikimit të informacionit për çështje të rëndësishme publike, por me kusht që të veprojnë në mirëbesim me bazë faktike dhe juridike si edhe të sigurojnë një informacion të besueshëm në pajtim me etikën e gazetarit”.

Ka raste edhe pse të rralla që gazetari procedohet në rrugë civile apo penale. Në raste të tilla, gjykatat duhet të jenë shumë të vëmendshme sepse masat ndaj gazetarit mund të dekurajojnë shtypin në kryerjen e misionit të tij dhe në nxitjen e debatit politik

“Shoqëria- thuhet në një vendim të Gjykatës për të Drejtat e Njeriut- i ka besuar gjyqtarëve një rol shumë të rëndësishëm e megjithatë pritet që ato të veprojnë nën kontrollin e publikut. Nëse nuk e përmbushin këtë detyrë zbulohen ndaj kritikës nga e cila nuk meritojnë të mbrohen”.

Gjykata e Strasburgut duke vlerësuar rolin e rëndësishëm të gjyqësorit në një vendim tjetër ka tërhequr vëmendjen se fushata mediatike në këtë apo atë rast mund të çenojë besueshmërinë e procesit gjyqësor duke ndikuar negativisht në opinionin publik dhe në vetë gjykatën që do të vendosë mbi fajësinë ose jo të të akuzuarve. Por pavarësisht nga këto raste relativisht të rralla diskutimi publik i vendimeve gjyqësore si dhe kritika ndaj tyre nuk mund të ndalohet. Kështu psh edhe një vendim i formës së prerë gjyqësor në vetvete nuk mund të përbëjë provë për të thënë se media gënjen kur ofron informacion dhe pikëpamje ndryshe nga ato që përmban vendimi i mësipërm.

Në praktikën e Gjykatës Europiane të të Drejtave të Njeriut evidentohen gjithashtu raste kur gazetari profesionist është ndëshkuar edhe kur ai ka zbuluar të dhëna dhe fakte që kanë kushtëzuar rishikimin e vendimeve që prej kohësh kishin marrë formë të prerë. Në çdo rast gjykata është e detyruar të balancojë rolin e gjyqësorit dhe lirinë e shtypit për të informuar mbi çështje të interesit publik.

Natyrisht, kur kritika ka si qëllim kryesisht fyerjen ose shpifjen ndaj gjykatës, ajo nuk i shërben debatit publik dhe mbrojtja që i jepet lirisë së shtypit është tepër e ngushtë. Nuk besoj të ketë patur interes për publikun botimi në median tonë të mesazheve intime të shkëmbyera midis dy personave, edhe pse njëri prej tyre akuzohej për kryerjen e një krimi. Theksojmë se mesazhe të kësaj natyre në rastin konkret nuk i shërbenin zbulimit të së vërtetës dhe as debatit publik.

Nuk besoj gjithashtu të ketë pasur interes publik kritika e drejtë që media i ka bërë një personi publik ku veç të tjerave përmendet edhe marrëdhënia e tij para 5 viteve me një femër, fotografia e së cilës është publikuar në të njëjtën media dhe pa pëlqimin e saj, gjë që mund të krijonte një konflikt të panevojshëm familjar.

Zhvillimi i seancave gjyqësore si rregull është publik. Për median, siç dihet, ato janë burim i rëndësishëm informacioni. Është në vlerësimin e medias se çfarë informacioni ka ose jo interes për publikun. Në këtë vështrim për të arritur në përfundime të drejta dhe të bazuara, do të duhej të mbështeteshim në fakte dhe analiza objektive, gjë që është e vështirë të bëhet në kuadrin e një diskutimi. Vlen të përmendet se ky problem është i lidhur ngushtë me parimin e lirisë së shprehjes pra edhe lirisë së medias, me njohjen e disa parimeve në bazë të të cilave zhvillohet seanca gjyqësore midis të cilave edhe me atë të respektimit të së drejtës së personalitetit dhe të privatësisë. Natyrisht nuk kërkohet që gazetari të jetë specialist në fushën e drejtësisë.

Gjatë përgatitjes së këtij diskutimi më ka tërhequr vëmendjen jurisprudenca kushtetuese e Republikës Federale Gjermane, që veç të tjerave, trajton edhe rolin e medias në informacionin që ajo i jep publikut lidhur me zhvillimin e proceseve penale në përgjithësi dhe në veçanti në adresë të autorit të krimit. Trajtimi doktrinar i referohet vendimeve të Gjykatës Kushtetuese Gjermane. Më lejoni që shkurtimisht të përmend vetëm disa pjesë të këtij vendimi. Në të thuhet:

1. Publiku duhet të informohet për kryerjen e krimeve duke përfshirë identitetin e të akuzuarve dhe rrethanat që kanë çuar në këtë krim. Krimet janë pjesë e historisë bashkëkohore paraqitja e të cilave është detyrë e mediave.
2. Interesi në marrjen e informacionit nuk është absolut. Rëndësia e së drejtës së personalitetit kërkon jo vetëm vigjilencë në emër të sferës personale por edhe respektim të parimit të proporcionalitetit. Cënimi i sferës personale, kufizohet në raport me nevojën e informacionit që ka interes publik ndërsa dëmi që mund të pësojë i akuzuari duhet të jetë në proporcion me rëndësinë e shkeljes. Për pasojë nuk është gjithmonë e lejueshme të zbulohet emri, të ekspozohet foto grafia apo të përdoren mjete të tjera për identifikimin e autorit të krimit.
3. Efekti rrezatues i garancisë kushtetuese të së drejtës së personalitetit nuk i jep të drejtë medias të ndërhyjë në mënyrë të pakufizuar në sferën personale dhe private të autorit të krimit. Kur përmbushet interesi i publikut në marrjen e informacionit të freskët për krimin, rritet e drejta e autorit të krimit për ta lënë atë të qetë. Sapo një gjykatë penale e ka dënuar të akuzuarin për një akt që ka tërhequr vëmendjen e publikut dhe ai ka përjetuar reagimin e menjëhershëm të komunitetit, çdo invazion i mëtejshëm apo i përsëritur ndaj sferës personale të autorit të krimit, normalisht nuk mund të justifikohet.
4. Transmetimi televiziv lidhur me një krim që nuk justifikohet më me interesin e publikut në marrjen e informacionit do të ishte i dëmshëm nëse do të rrezikonte rehabilitimin social të autorit të krimit.

FAKE NEWS

GAZETARËT DHE POLITIKA

Fake News është fjala më në modë e politikës e cila po përdoret jo për të treguar një problem që ka media aktualisht, por për të gjetur një Alibi. Kjo fjalë po përdoret si baltë për të vënë shenjën e barazimit mbi gjithcka, mbi këdo, median tradicionale dhe median e re të rrjeteve sociale. Në këtu kemi gjetjen shqiptare, quhet, Kazan, më herët një kryetar partie nisi edhe të shpallte cmime për Fake Neës sa herë që nuk i pëlqene ndonjë lajm. Kjo është mënyra se si ne që kemi zgjedhur që gazetarinë ta kemi profesion, e shikojmë, përmendjen e termit Fake Neës kryesisht nga politika.

Por në thelb problemi qëndron, pamvarësisht përgjithësisht.

Në fillimet e saj gazetaria e Shqipërisë postkomuniste vërtitej mes shkollës së vjetër të mediave të ish partisë së punës dhe të rinjëve që kishin më shumë pasion se sa profesionalizëm, kujtoni gazetën Koha Jonë. Duke kopjuar por edhe duke mësuar në punë e sipër nga një prej mentorëve më të mirë të gazetarisë shqiptare, Carlo Bollino, u krijua një brez gazetarësh profesionistë që shpërblimin më të madh të punës së tyre kishin lajmin e vërtetë. Ishte koha e gazetarëve botues e cila më vonë ndryshoi por që nuk preku vërtetësinë e lajmit. Gjatë kësaj kohe në median shqiptare kishte media që përdornin lajme të rreme, qëllimisht apo nga paaftësia, por që nuk mundën t'i mbijetojnë. Sot mund t'ju përmend emra që me siguri i keni harruar se kanë qarkulluar ndonjëherë në tregun shqiptar. Lajmet e pavërteta në atë kohë e kishin një filtër që nuk lejonte të kalonte gjithcka. Për shkak të mënyrës së funksionimit të mediave tradicionale ku janë gazetarët profesionistë ata që vendosin për rëndësinë e lajmit, faktet që duhet t'i tregojnë lexuesit, publiku ishte shumë më i mbrojtur nga dezinformimi i Fake Neës. Nëse ajo ka ndodhur, kjo ka ardhur në rradhë të parë nga paaftësia profesionale e gazetarëve, apo është bërë qëllimisht nga botuesit, por as në rastin e parë dhe as në të dytin nuk ka funksionuar, ose dëmi ka qenë shumë më i vogël.

Por gjithcka ndryshoi me kohën e internetit, gazetarisë on line e cila në momentin kur u përzje me rrjetet sociale nxorën në sipërfaqe problemin e madh të Fake Neës dhe coroditjes që shkakton kjo lloj media. Nëse në një gazetë apo edicion informativ në cdo televizion, është një grup profesionistësh që vendosin se cduhet transmetuar se si duhet transmetuar. Me truket e profesionit i tregon edhe publikun, lajmin e rëndësishëm, apo lajmin e lehtë. Në rrjetet sociale ndodh një proces që nëse shoqërohet me një nivel të ulët kulturor, është i rrezikshëm. Lexuesi i lajmëve në rrjetet sociale lexon lajme pa një rregull të caktuar, filtër apo shenjë për rëndësinë e lajmit. Në facebook mund të gjesh të parin, një lajm të BBC që ka hetuar me muaj tregun e skllerëve në Libi dhe më pas një lajm apo koment të kujdo që i shkrep në kokë një gjë dhe e shkruan. Të tipit, "E bujshme, zbulohet ku u ul anija aliene në liqenet e Belshit". Për lajmin e parë BBC ka angazhuar fonde, gazetarë profesionistë që rrezikojnë edhe jetën për lajmin e vërtetë, ndërsa për lajmin e dytë Amanpuri nga Elbasani ka shfrytëzuar një spartphone dhe gjithë fantazinë e shfrenuar me synimin për të tërhequr disa klikime.

Në fakt kështu lindën në Shqipëri Fake Neës, pjesa më e madhe nga paaftësia, injoranca dhe mundësia që rrjetet sociale i dhanë cdo budallai të ketë lirinë e shprehjes.

Kjo është koha kur në Shqipëri shpërtheu moda e portaleve, disa për të bërë vetëm komente, disa gazetari dhe komente dhe një pjesë e madhe për të bërë vetëm lekë. Me 5 mijë lekë të vjetra një portal që askush nuk ja se kush e ka në pronësi, publikon një lajm Fake Neës për të goditur një biznes, një zyrtar, një ministër, një deputetë, një politikan, për të njoftuar një person.

Këtu kemi hyrë në botën e pistë të Fake Neës që bëhet për qëllim. Në Shqipëri janë mbi 2 mijë portale dhe blogje. Dhe shumë pak janë ato të cilat njihen. Edhe në botën e portaleve ka nisur të veprojë përzgjedhja dhe më të ndjekurat të bëhen ato që lajmin e bujshëm e kanë patur të vërtetë, apo nuk kanë funksionuar vetëm për shantazh. Rreziku nga Fake Neës i qëllimshëm është shumë i madh jo vetëm për çoroditjen që shkakton në publik por edhe mundësinë që nëpërmjet Fake Neës të ndikohet aq shumë publiku sa mund të shkaktojë edhe tronditje që kërcënojnë sigurinë kombëtare. Niveli i depërtimit të internetit në Shqipëri po rritet me shpejtësi, por jo me këtë shpejtësi ecën rritja e nivelit arsimor dhe kulturor. Në pranverën e vitit 2015 në rrjete sociale ishin shumë të ndjekura lajmet për suksesin e atyre që kishin ikur me autobus me Gjermani, dhe ishin bërë me shtëpi falas, me punë, me makinë.

Për një qytetar që e di shumë mirë se si funksionon jeta përtej kufirit shtetëror, një lajm i tillë shkaktonte vetëm buzeqeshje për gënjeshtren e trashë të ndokujt me apo pa qëllim. Por ajo që ndodhi si një epidemi ortek, ishte vërshimi i 50 mijë shqiptarëve në muaj drejt Gjermanisë për të kërkuar azil. Helmi i Fake Neës i bëri të shesin edhe pronat, dëshpërimi nga varfëria i bëri të shesin edhe sendet personale dhe të merrnin një autobus drejt Gjermanisë. Kjo nisi në Maqedoni e Kosovë dhe u përhap si epidemi në Shqipëri. Si fenomen i shkëputur mund të duket i rastësishëm dhe fajin e kishte qeveria, varfëria. Por si fenomen mbarëkombëtar edhe në mendjen më dyshuese për konspiracione mund të zërë vend mendimi, se dikush kishte luajtur shumë pisët. Më pas erdhi rradha e politikës për ta përdorur dhe keqpërdorur median për interesa të ngushta dhe synime tërësisht politike për të goditur rivalët dhe për të fituar zgjedhjet. Sot në Tiranë televizionet dhe mediat akuzohen për Kazan, apo për Fake Neës. Dhe kjo bëhet sepse nuk ju pëlqen pasqyra ku shohin vetën, e mirë apo e keqe qoftë ajo. Këtu në Tiranë politika bën moral, por a e dini se çbën politika pak kilometra larg nga Tirana.

Nëgjithë vendin janë mbi 100 tv lokale, me hapësira të vogla mbulimi por të mjaftueshme për synimet e atyre që i kanë në pronësi apo i marrin me qera. Dhe këta janë deputetë, kryetarë bashkie, vëllezër kryetarë bashkie, apo kryetar partie. Nëse një televizion lokal në Jug apo veri qoftë, do të mbijetojë duhet të marrin paratë e deputetëve që para fushatës i marrin me qera këto televizione, ose blihen prej tyre ose në fillim të vitit zgjedhor marrin në dorë një shumë të madhe parash. Pas kësaj, asnjë normë profesionale nuk zbatohet dhe propaganda e tipit Fake Neës është shumë e zgjuar. Po kjo klasë politike ka futur duart edhe në shumë prej atyre 2 mijë portaleve dhe blogjeve apo mijëra postimeve në rrjetet sociale. Politika nuk bën vetëm televizione në Facebook, por përdor profile anonime apo edhe të personave të ndryshëm për të informuar me syzët me ngjyrën përkatëse politike apo për të dizinformuar me Fake Neës. E në këtë vorbull nuk është aspak cudi që të përdoret nga forca të tjerë jashtë vendit për qëllime aspak të mira. Gjithë kjo rrëmujë ndodh sepse nuk ka më rregulla që kontrollojnë funksionimin e kësaj lloji medie. Është i nevojshëm miratimi i një ligji dhe ngritja e një strukturë e cila duhet të evidentojë se kush është kush në mënyrë që të përgjigjet para ligjit për shpifje dhe fake neës apo të shpërblehet nga llexuesit nëse bën gazetari të mirë. Rregjistrimi duhet shpëruar edhe me zbardhjen e burimeve të financimit, jo thjeshtë për të kapur evazionin fiskal, por për të penguar hyrjen në botën e medias on line të parave të pista, si nga krimi aashtu edhe nga paratë e pista të korrupsionit politik. Në asnjë mënyrë nuk duhet lejuar që opinioni publik të krijohet nëpërmjet mjeteve ilegale dhe të dyshimta.

Deri më tani nuk është marrë seriozisht ndonjë strukturë destruktive, ai ato që akuzohen për zgjedhjet amerikane apo për brexit, por nëse ndodh, atëherë ajo që vjen më pas do jetë tragjike. Shqipëria ka një supërngarkesë me media.

Përvec 2 mijë portaleve janë 100 televizione, radio dhe dhjetra gazeta. Sikur në një nga këto media, mesatatisht të punonin 6 persona, sot në Shqipëri duhet të kemi mbi 12 mijë të punësuar ligjërisht si gazetarë. Numri do ishte shumë më i madh edhe me të punësuarit në shërbimet ndihmëse. Italia ka diku te 15 mijë punonjës të mediave të organizuara në shoqata.

Informaliteti i lartë dhe tregu i vogël kanë krijuar një mjedis ku ata që mbijetojnë duke zbatuar pikë për pikë ligjin e bëjnë këtë me shumë sforcë, probleme financiare. Ndërkohë që në bota informale e medias nuk është vetëm në këto mini televizione apo portale por edhe në mediat që quhen të mëdha. Janë sa gishtat e dorës ato media që punonjësit e tyre i kanë të rregjistruar, me kontrata të rregullta sipas kodit të punës dhe që u paguajnë rrogat 100 përqind të deklaruara. Jam dëshmitar se si kolegët e mij, e quajnë gati absurd faktin që media në të cilën unë punoj prej vitit 2008 ka një marrdhëniet ligjore dhe financiare, të pastër me punonjësit e saj. Në një kohë që të flasësh për rrogën nga banka dhe rrogën e dorës në televizione dhe gazeta historike është tërësisht normale. Aty gjen kryeredaktorë që paguajnë taksa për 30 mijë lekë pagë në muaj, ndërsa në të vërtetë marrin 10 herë më shumë nën dorë nga pronarët e tyre. Ky nuk është thjeshtë evazion, por edhe një situatë pasigurie në botën e reporterëve të medias, asaj pjese që është edhe më e prekshme. Ju kujtohet kryeministri, i cili inatin me ata të tryezave të debatit ja zbrazi reporterëve të terrenit. Në një kohë kur kjo qeveri, dhe asnjë qeveri e mëparshme nuk ka ndërmarre, qoftë edhe më të voglin hap në ndihmë të pushtetit të rëndësishëm të informacionit. Duket e nisur me reporterët e terrenit, të cilët kanë pasigurinë e marrdhënies së punës, pagat e ulta, orët e zgjatura në punë dhe të papaguara dhe presionin se një fjalë e thënë gabim mund ta zemërojë pronarin mik me ministrin, deputetin, biznesmenin apo kriminelin. Të legalizosh marrdhëniet e punës së gazetarëve, është fare e lehtë. Mjafton vullneti dhe disa inspektorë tatimorë që redaksi me redaksi mund të gjejnë të punësuarit në të zezë. Legalizimi i mediave duhet të shoqërohet edhe me një politikë mbështetëse ndaj tyre. Ne sot kemi disa televizione me license kombëtare, një prej të cilëve është në pronësi publike.

Cdo qeveri e shikon një media private si një biznes të thjeshtë kur në të vërtetë nuk është ashtu, sepse për shkak të ndikimit të madh në publik, mediat kanë një rol të rëndësishëm kombëtar. Por ndërsa televizioni publik merr nga tatim paguesit dhjetra milionë euro në vit, për të mbajtur në këmbë një strukturë që nuk e ka forcën dhe shikueshmërinë e mediave jo publike, këto të fundit duhet të luftojnë 24 orë në 24 për të mbijetuar, për të mbajtur njerëzit në punë, për të paguar taksat dhe për të konkuruar. Mbase do ishte më vend që për mbajtur larg problemet që krijohen nga tregu i vogël dhe hallat e medha, edhe mediat private kombëtare të merrnin subvencion nga publiku përsëmbull për pjesën e informacionit, e cila në cdo televizion është një fasho orare që harxhon shumë financa dhe nuk prodhon. Kjo mbase duket utopi, por është një mënyrë për t'i dhënë frymë medias. Ta mendosh me psikologjinë e një kryeministri, një veprim të tillë nuk do të bëhej kurrë sepse ai do mendonte, "përse duhet t'u jap para, që të më sulmojnë dhe mos më mbështesin në zgjedhje". Fatkeqësisht ajo kohe kur të kemi drejtues qeverie që ta pranojnë se fondet e buxhetit nuk janë të tyre, por janë para të taksapaguesve edhe që i kanë votuar kundër, ende nuk ka ardhur.

Kjo është ajo që mendoj se duhet të bëjë politika, por ka dicka që duhet ta bëjnë edhe vetë gazetarët. Ne sot jemi të shpërndarë në dhjetra shoqata, grupime, sindikata, pjesa më e madhe me vetëm një kryetar të prekura nga fenomeni i Organizata Jo fitim prurëse por që sjellin fitime të mëdha për kryetarët. Është koha e krijimit të një strukture, sic mund të ishte urdhëri i gazetarit, pa lejen e të cilit asnjë media nuk mund të punësojë një gazetar. Një kod etike i cili do të ishte ligji mbi të cilin një gjykatë profesionale do të gjykonte rastet e shkeljes së kodeve të profesionit, në këtë mënyrë do të ndërtonim një barrierë të mirë, kundër Fake Neës, kundër informalitetit dhe do mund të krijojmë një mjedis ku duhet punë për ta merituar emrin gazetar.

EVOLUIMI ETIK I MEDIAS

Që kur i thashë “po” idesë, për të folur dhe analizuar etikën në media, për këtë aktivitet, më rrinte në kokë pyetja; nëse në këtë analizë, do të duhet të mbaja anën e medias, ku edhe vetë bëj pjesë aktive prej 20 vjetësh, apo t’i “numëroja kusuret”, që për hir të së vërtetës, nuk janë pak...Por i dhashë karar, duke bindur veten në rradhë të parë, se panorama nuk është e nuk ka, sesi të jetë bardh e zi.

Edhe pse kemi kod etik të medias, ai nuk njihet, nuk respektohet ose shkelet. Dhe kjo ndodh si në cdo fushë, ku ka psh urdhër mjeku, urdhër farmacisti, psikologu etj, e megjithatë, cdo ditë ndeshim raste të shkeljes apo tejkalimit nga ana e personave, që punojnë edhe në këto fusha.

Ndërsa mendoja shkaqet, se pse niveli i etikës në media, le për të dëshëruar, nuk munda ta ndaja këtë dukuri nga etika në politikë, qeverisje, apo niveli kulturor, social e tradita, që ne kemi.

Në vitin 2001, plot 16 vjet më parë, ndërsa kryeja një kurs specializimi në një televizion të Carolinës së Jugut, kolegja ime atje, me të cilën dilja shpesh edhe në terren, për të ballafaquar eksperiencat tona profesionale, iu drejtua një qytetari pa kamera, ndërsa ai furnizonte makinën me karburant, duke e pyetur, nëse mund ta filmonte, ndërsa ai kryente këtë veprim. Kolegja ime i sqaroi, edhe se, përse i duheshin pamjet dhe cila ishte ideja e raportimit të saj. Në atë kohë, diskutova gjatë me gazetaren, që njëlloj si unë, punonte në një televizion dhe kishte ambicie, për të bërë karrierë të gjatë në këtë profesion. Ajo m’u përgjigj, se televizioni ku punonte, ishte shumë etik dhe për këtë arsye, nuk mund të dhunonte qytetarët dhe të drejtën e tyre, duke i filmuar dhe shfaqur në televizion, pa u marrë leje më parë. Ndërsa unë “nxorra kartën” e gazetarisë së fortë, agresive, që për pak më kishte cuar mua dhe kolegët e mi në Tiranë, në thyerje dhëmbësh apo dëmtime të tjera, të atyre, që “binin pre” e dhjetëra mikrofonëve të drejtuar, për pyetje “surprizë”, që ne i kishim menduar më parë, apo thjesht na vinin aty për aty.

Pasi nuk u morëm vesh në këtë pikë, kolegja bëri një tërheqje të vogël, duke shpjeguar ndryshimin e mentalitetit në dy vendet tona, e unë në këmbim lëshova pak pe, duke thënë, se në vendin tim, unë intervistova njerëz të politikës, të cilët në fund të ditës, në cdo teori e praktikë gazetarie, e kanë hapësirën e lirisë, më të vogël, se qytetarët e thjeshtë. Me Lisën u ndamë në një marrëveshje “ëin-ëin situation”, por ai diskutim dhe ajo mënyrë sjelljeje më mbetën në mendje e më vunë në dilemën, se ndoshta dicka duhej ndryshuar në raportimin tonë, që duhet thënë, nuk kishte shumë ditë, pas skematizimit të medias në Shqipërinë komuniste.

Sot, parë nga distanca e 16 vjetëve nga ky shembull dhe 20 vjetëve nga puna aktive në disa televizione të rëndësishme në vend, shumë rrethana kanë ndryshuar. Maturimit të televizioneve, edhe në drejtim të etikës, i është vënë përballë, teknologjia, shpejtësia e së cilës, sfidon të gjitha armët dhe hapat tanë drejt etikës.

Disa nga problemet etike më prezente në raportimet mediatike, që unë kam renditur:

-Kujdesi në raportimet për fëmijët, personat apo kategoritë më vulnerabël.

Ka raste, që të mitur, apo persona me probleme shëndetsore, transmetohen me zë dhe figurë, duke rrezikuar denigrimin e tyre nga shoqëria, apo izolimin nga komuniteti, ku jetojnë. Ka raste që problemet e tyre, nuk sillen në media me kujdesin e duhur: thuhet shpesh fëmijë autikë, kur termi për ta, është “fëmijë me autizëm”, madje në shkrime e raportime më delikate përkufizohen si fëmijë

me “nevoja të vecanta”.

-Kujdesi nga gazetaria e provokimit, lincimit apo vënies në lojë.

Në rubrika, që vijnë si rubrika humori, shohim jo rrallë, që zgjidhen personazhe realë të paarsimuar, në nivele të mjerueshme ekonomike, sociale e kulturore dhe ata pyeten, për çështje, që nuk i kuptojnë, për të bërë më pas humor me përgjigjet e tyre.

-Kasetat apo materialet vizive të gatshme ulin kredibilitetin tonë.

Është bërë e modës, që zyrat e shtypit të njerëzve me pushtet në Shqipëri, filmojnë vetë aktivitetin e shefit, por nuk ndalen këtu. Ata cojnë materialin në dhomat e tyre të montazhit, përzgjedhin fjalitë e duhura dhe sjellin vetëm 2 minuta video, duke shndërruar në këtë mënyrë me djallëzi, atë që duhet të ishte raportim me interes publik, në propagandë të mirëfilltë, që nuk preket as në një pikë tangente me gazetarinë.

-Policia servit pamje aksionesh e në fund, personazhet e “telendisur publikisht” dalin të pafajshëm. Në këto raste “fajtori” kryesor është vetë institucioni, që krijon dhe shpërndan këtë mizanskenë, por nuk mbetet pas edhe media me kontribut, në përcimin e këtij fenomeni.

-Moria e portaleve, përgjithësisht jashtë kontrollit. Sot, që flasim, sipas Unionit të mediave, janë mbi 700 portale, kontrolli profesional dhe etik mbi të cilët është thuar se i pamundur. Ky numër i lartë i portaleve ka cuar dhe në një tjetër fenomen, atë që quhet edhe si:

-Gazetaria copy paste. Mjafton të shohësh një shkrim apo artikull në një portal dhe pa hezitim, po ashtu pa ndryshimin e një presjeje, i njëjti shkrim bën xhiron e të gjitha portaleve simotra.

-Titujt nuk përputhen me përmbajtjen. Nuk besoj se ka shumë vend për ilustrim, se të gjithëve na ndodh cdo ditë, që të klikojmë mbi një titull, për të gjetur argumentin më të zgjeruar, por argumenti i kërkuar nuk gjendet në brendi.

-Komentet, apo forumet për shkrime të ndryshme e bëjnë pothuaj të kotë përpjekjen për etikë në shkrim, sa kohë, që në komentet e qytetarëve mbi artikullin, nuk ndalen të turravrapin për denigrim me fjalor, që nuk njeht kufi. Stafet e vogla të mediave të shkruara dhe ëeb-eve e portaleve e bëjnë të pamundur kontrollin e komenteve, që shoqërojnë shkrimin. Edhe pse në përvojën time, jemi përpjekur, që të vëmë fjalë-kyce, që faqja e facebook-ut e emisionit “Stop”, sërish na duhet të shtojmë cdo ditë gamën e fjalëve fyese të ndaluar, pasi fantazia e “shkrimtarëve” të komenteve, e kalon fantazinë tonë, për t’i ndaluar shkrimet në rrjet.

-Rrjetet sociale, të kthyer në media sociale, po e sfidojnë kujdesin tonë për kontroll dhe etikë. Një njeri me një celular në dorë, as nuk pret e as kontrollon, kur ka nevojë të tregojë, denoncojë, apo thjesht të shprehet për dicka a dikë. Kësisoj, në pak sekonda, postimi i tij është publik për të gjithë ndjekësit e tij, apo ndjekësit e ndjekësve e kështu me rradhë në një zinxhir që nuk ndalet. Të gjitha këto fenomene e kanë bërë turravrapin vrapin për shpejtësi, një garë pa rregulla...

Këto janë, sipas meje, disa nga “plagët” e gazetarisë së sotme dhe pavarësisht të gjithave, sado të flasim e të përmirësojmë sëmundjet e medias, jemi në konkurrencë të pandalshme me kohën dhe teknologjinë. Format e reja të komunikimit, po e vjetërojnë edhe diskutimin për etikën e medias, që duhet thënë, se ka ekzistuar e do të vazhdojë të ekzistojë, sa herë të flitet për gazeta, radio-televizione, portale, agjensi shtypi. Nuk dua të dukem si ata, që nga gazetarët aktivë konsiderohen si njerëz të specializuar për seminare, por po rrezikoj, duke e mbyllur me një thënie të gazetarit të madh italian Enzo Biagi: “Kujtesa ka etikën e saj, jo thjesht, sepse të njohësh gabimet dhe dhe dramën e të shkuarës, do të thotë, të evitosh përsëritjen në të ardhmen. Ah sikur të ishte kështu.....!!! Dhe kjo vlen edhe për etikën në cdo kohë.

MEDIA MES (VETE) CENSURES E POLITIKES

Media si pushtet i katërt në Shqipëri, ka qenë gjithnjë në vëmendjen, por edhe në shënjestrën e politikës, pushtetit qëkërkon, ose votohet për të qeverisur një vend. Sa më problematike politika, aq më e madhe përplasja që ka me median. Arsyeja është krejt e thjeshtë dhe qëndron tek roli i medias dhe ndikimi isaj në jetët e njerëzve, përmes informacionit që përcjell. Mund të thuhet se qytetarët/shikuesit/lexuesit janë njëjti target grup, si i medias ashtu edhe i politikës. Të dyja kërkojnë ta ndikojnë, por vetëm njëra palë synon ta qeverisë dhe ajo është politika. E për këtë, vëmendja e politikës është tek pushteti i medias, që e ndjen si konkurente, sepse ndikon publikun, qytetarët. E thënë në mënyrë simpliste, pushteti i katërt e ka fuqinë që të shërbejë si “qen roje”, ndaj atyre që kanë pushtet a një pozitë, me të cilat ndikojnë jetët e njerëzve. Këtë e bëjnë duke synuar t’u japë qytetarëve informacionin që u duhet, në mënyrë që ata të mund të marrin vendimet më të mira për jetën e tyre dhe padyshim edhe për politikën. Këtë media e bëjnë duke raportuar sukseset, por edhe dështimet e saj. Cdo gazetar, fillestar a me përvojë, i njeh mirë ato që konsiderohen si 5 parimet bazë në punën e vet: e vërteta, pavarësia, objektiviteti, humanizmi dhe përgjegjshmëria.

Fatkeqësisht, media sot nuk po kalon ditët më të mira, edhe për shkak të perceptimit, që është krijuar mbi të. E para politika, që synon ta konsiderojë si një pushtet që duhet t’i bindet dhe e akuzon për mungesë profesionalizmi. E dyta, një mungesë ndërgjegjësimit e solidaritetit e vetë medias, për t’iu kundërpërgjigjur, duke sqaruar pozicionin e rolin e vet. Në vend të kësaj, media bie në kurthin e politikës, nis të kompleksohet prej saj, e të analizojë vetveten, nisur nga këndvështrimi që politika përpiqet të mbjellë për të në publik, në mënyrën më tinëzare, e fatkeqësisht jo pak efikase.

Dy pyetje të thjeshta, por edhe retorike, mjaftojnë për të kuptuar këtë mekanizëm.

A është i drejtë perceptimi se sot media është sa joprofesionale, e anëshme, aq edhe e (vetë)censuruar?
A është profesionalizmi i medias, merak i vërtetë i politikës?

Le t’i shohim disa fakte, bazuar në eksperiencën si gazetare aktive, për t’u dhënë një përgjigje sa më shteruese. Prej vitesh tashmë, Shqipëria duket e fiksuar në mënyrë të palëvizshme, në grupin e vendeve pjesërisht të lira, sa itakon lirisë së medias, por nga ana tjetër, duhet thënë se roli e misioni i saj publik, janë sfiduar fort vitet e fundit. Bazuar në eksperiencën mbi 20 vjetecare në këtë profesion, do doja të ndaja tre sfidat kryesore, ku mendoj se testohet panorama e medias sot, përtej leximeve sipërfaqësore, që i bëjnë situatës së saj. Ato janë raportimi, motivimi dhe besueshmëria.

Raportimi është thelbi i punës së medias. Megjithë dritëhijet që mund t'i vishen cilësisë së raportimit, duhet pranuar se në përgjithësi, raportimi klasik, pra, të treguarit e fakteve me vërtetësi e paanshmëri, nuk ndodh më. Jo vetëm për faj të medias, ajo nuk l mbikqyr dot më politikëbërësit.

Institucionet publike apo partitë politike, janë ato që përgatisin materialetë gatshme mbi punën, zakonisht të titullarëve të tË tyre dhe ua shpërndajnë mediave për transmetim e publikim, duke zëvendësuar kështu njoftimet klasike për shtyp, që ekzistojnë në cdo vend të botës, pasi media ftohet dhe e ndjek vetënjë aktivitet të caktuar. Dikur një përjashtim nga rregulli, tashmë kjo praktikë është kthyer në normë, edhe kur nuk jemi në periudhë fushate zgjedhore. Deri nëvëndoret e 2015-ës, kishte prej nesh që revoltoheshin dhe e kundërshtonin këtë situatë, si absurde. Por politika nuk u step. Ia doli ta fitonte këtë betejë, ndërsa media e pranoi në heshtje.

Si rrjedhojë e kësaj praktike, edhe aksesi në informacionin zyrtar është tepër i kufizuar. Shqipëria e ka një ligj për informimin publik të 2014-ës, por nëse i drejton një kërkesë a pyetje me ndjeshmëri publike një institucioni, përballesh me zvarritje e fshehje pas afateve ligjore, e më pas me heshtje. Vetëm në bazë të njohjeve personale, mund të sigurosh informacionin që të duhet.

Po t'ishtojmë kësaj panorame edhe faktin se konferencat për shtyp, si një formë e llogaridhënies publike dhe e komunikimit me publikun, janë zëvendësuar nga monologjet pothuaj të përditshme të aktorëve politikë, që detyrën për të cilën janë zgjedhur, nuk e kuptojnë përveçse para kamerave televizive, për të cilat kujdesen po vetë, duket qartë se ka tashmë kufij të vendosur sigurie, që media t'i afrohet politikës, vetëm aq sa e lejon ajo vetë. E kjo është një formë e pastër censure, e rrezikshme, sepse është e butë, e pa zhurmë dhe për më tepër, ia del t'u shpëtojë raporteve monitoruese ndërkombëtare mbi gjendjen e medias në Shqipëri. Kjo situatë na con tek sfida e dytë, që është mungesa e motivimit për profesionin. Demotivimi vjen si rrjedhojë e sfidës së parë. Vetë gazetarët, po i dorëzohen sot zyrave të shtypit të institucioneve e partive, me staf gjithnjë e më të madh në numër, sesa vetë redaksitë e mediave vizive a të shkruara. Me burime njerëzore e teknologji të fundit, një faturë që paguhet nga taksat publike, në "redaksitë" e institucioneve, prodhohen edhe me zë e figurë lajmet, e media i përcjell publikut, propagandën e një realiteti, që rrallë verifikohet në terren prej saj, edhe pse cdo shikues a lexues, e has ashtu sic është.

Padyshim që kjo praktikë e politikës ndaj medias, e shndërruar në normë sjell demotivim të gazetarëve, e më tej, atë që quhet vetëcensurë. E kombinuar me interesat, e lidhjet e pushtetit politik, me atë të pronarëve të medias, sjell demotivim për të kundërshtuar, a ndryshuar situatën. Rrezikshëm ky demotivim sjell praninë të këtij realiteti, që medias i cënon funksionin më bazik, atë të "qenit roje" të pushtetit.

Të dyja këto sfida të para, na japin atë imazh, që nuk duket fort nga ekranet e televizioneve, a faqet e gazetave, por edhe që anashkalohet nëpër analizat kritike a vetëkritike mbi gjendjen e medias sot. E pra ky realitet është kokëfortë e i matshëm në cdo redaksi televizioni a gazete: politika luan rolin e medias, e kjo e fundit thjesht e pranon. Prej këtu vijmë tek sfida e tretë, më e rrezikshme për median: cënimi i besueshmërisë. Për shkak të dy të parave, (mungesa e raportimit dhe demotivimi), besueshmëria e medias po cënohet, e në perceptimin publik, ajo po lexohet gjithnjë e më shumë, si zgjatim i njëjës, apo i tjetrës palë politike, fatkeqësisht pa marrë parasysh dy sfidat e mëparshme, që në fakt janë variablat, për të kuptuar realitetin e sotëm të medias shqiptare.

Një media që thjesht përcjell një realitet të prodhuar në zyrat e shtetit e të politikës, padyshim qëcënon besueshmëri të vet, nëse nuk ua bën të ditur origjinën e tij, shikuesve/lexuesve të vet, por ama në kushtet kur kësaj praktike i binden të gjitha mediat, akuzat e rastit për media të njërit, apo tjetrit apo tjetrit krah politik, tingëllojnë krejt pa vlerë. Nga ana tjetër, kur media përpiqet të gjejë hapësira të tjera për t'i dhënë publikut një informacion ndryshe, nga ai uniform, që shpërndahet nga politika, nis përplasja me të.

Ilustrimi më elokuent është epiteti i njohur tashmë "kazan", me të cilin kryeministri aktual i vlerëson mediat e vendit të vet, një tregues i reaksionit kimik të politikës ndaj medias, kur kjo e fundit del nga rreshti i riprodhimit të kronikave të gatshme, apo eventeve të drejtpërdrejta televizive, regjinë e të cilave e realizojnë "redaksitë", nëpër institucione publike a politike. Të tri këto sfida, me të cilat media sot po përballet kryesisht në heshtje, besoj se i japin përgjigje dy pyetjeve të shtruar në krye të prezantimit të tyre, mbi profesionalizmin e medias dhe rolin e politikës.

Përballë këtij realiteti (vetë)censure, duhet thënë se media po përpiqet të bëjë punën e vet, duke shfrytëzuar cdo hapësirë që i jepet.

Ka mes nesh qëpërkushtimin nuk e kanë prioritet, por mbeten të shumtë shembujt po mes nesh, të kolegëve që luftojnë për këtë profesion, për të thënë e raportuar të vërtetën, duke dhënë kontribut qoftë edhe modest, për ta bërë sa më funksionale demokracinë tonë hibride, bazuar në parimin e profesionit, se e vërteta duhet thënë, pavarësisht vështirësive.

Pa të vërtetën, sistemi që ende po ndërtojmë prej 27 vitesh pluralizëm, mund të jetë gjithçka, por jo demokraci. Pa të vërtetën, mbetet vetëm propaganda, mekanizmi shkatërrues që ky vend e kjo shoqëri, e kanë provuar për gati 50 vjet diktaturë komuniste. Fakt është se Ballkani Perëndimor po përjeton situatë të ngjashme, me një mjedis të vështirë e jo të lirë për median, e evidentuar më shumë nga organizatat e medias, sesa nga raportet monitoruese ndërkombëtare mbi rajonin tonë. Për pasojë, ka një vëmendje të shtuar tashmë nga BE, e konfirmuar nga eurokomisioneri për zgjerimin Johannes Hahn para disa ditësh gjatë një konference mbi median në Tiranë: "Ne kemi tërhequr vëmendjen - dhe kjo konferencë është dëshmi se ne vazhdojmë të veprojmë kështu - se udhëheqësit politikë në vendet candidate dhe ato anëtare janë përgjegjëse për garantimin e lirisë së medias, duke përfshirë sigurinë dhe kushtet e jetesës së gazetarëve. Nga perspektiva e procesit të pranimi, liria e mediave është një tregues i rëndësishëm i funksionimit të sundimit të ligjit. Ne vazhdimisht e trajtojmë këtë çështje në kontaktet tona me autoritetet përkatëse.

Por kjo e drejtë themelore që ne gjithmonë do të mbrojmë, shkon krah për krah me përgjegjësitë në një pjesë të mediave, siç është cilësia e raportimit, që nënkupton respektimin e standardeve dhe sigurimin e raportimit objektiv dhe të paanshëm", tha komisioneri dhe ky mbetet një premtim ende për t'u testuar.

Realiteti fakton se nga përplasja e politikës me median, kjo e fundit mbetet viktimë, në kuptimin jo vetëm metaforik. Të gjithë u shokuam nga vdekja e gazetares malteze Dafne Caruana Galicia, të cilës iu vu një bombë në makinë, një akt tipik mafioz. Cfarë bënte ajo? Si gazetare investigative, nxirrte në pah korrupsionin e qeverisë e opozitës. U hodh në erë në makinën e saj. Ndodhi në zemër të Europës, në një vend që është pjesë e BE prej 13 vitesh.

Nëse nuk ndodh sulmi fizik, nuk mungojnë intimidimet, kërcënimet e burgosjet e gazetarëve, diku për shpifje, e diku deri për grusht shteti, si është rasti flagrant i Turqisë, të raportuara në detaje nga organizatat e gazetarëve.

Fatmirësisht në Shqipëri nuk regjistrohen raste ekstreme, por justifikimi i politikës për median që e “bezdis”, ka një ngjashmëri mbresuese. “Fake neës” ka ardhur edhe në shqip, përmes ekuivalentit “kazan”. Lajmet e pavërteta nuk i bëjnë nder asnjë gazetari që i përcjell, qëllimshëm a nga mungesa e vëmendjes, por nuk duhet harruar se si të tilla, ato janë përdorur nga vetë politika, si armë ndaj kundërshtarit, një praktikë që natyrisht nuk ka lindur në Shqipëri. Për pasojë, kur politika flet për “fake neës” apo “kazan”, në fakt nënkupton, se nuk i pëlqen ajo që thuhet, e shkruhet për të. Një taktikë tashmë e evidente, për t’iu shmangur fakteve, e për të mos i pranuar ato, edhe kur media i sjell krejt të qarta.

Mes (vetë) censurës e politikës, cka mbetet fakt është se mediat, me të mirat e defektet, mbeten ato që u japin zë qytetarëve, atyre që pothuaj nuk dëgjohen më, nga monologjet e politikës, konflikteve që provokon për interesa të ditës, e për pushtetin me cdo kusht.

Ndryshe nga politika, media nuk ndihet në garë me të, por për të vërtetën, sa më objektive e profesionale, për të bërë diferencën mes kolegësh, e tërhequr sa më shumë shikues, a lexues.

Fshehja e të vërtetës, përmes taktikave që u përmendën më sipër, e con vendin pas, në modelin kur e vërteta kishte vetëm zërin e tonin e të vetmes parti që ekzistonte, e njehsuar me pushtetin.

Memoria e mbi 20 viteve në media, por edhe ende si pjesë aktive e saj, më con në konkludimin, se ka një shkallë të fortë ndërgjegjësimit mes gazetarëve sot, atyre që merren cdo ditë me lajmin, e që përpiqen ta sjellin të vërtetën, përmes cdo hapësire që u jepet. Investigime serioze që sjellin me fakte realitetin mbi dy problematika të forta, tashmë të identifikuara si sfida prioritare edhe nga politikëbërësit, kanabisi dhe krimi i lidhur me politikën, kanë ardhur nga gazetarë e media kurajoze shqiptare. Këto investigime ndahen mes kolegësh, si një mekanizëm vetëmbrojtës përballë politikës, duke shfrytëzuar cdo hapësirë për të sjellë të vërtetën, të qartë e të faktuar.

Cfarë mund të bëhet në këtë situatë?

- **Së pari**, nevojitet më shumë besim tek puna jonë dhe fuqia që ka ky profesion, për të mos u kompleksuar lehtë nga avancat apo presionet e politikës.
- **Së dyti**, solidariteti mes mediave, për të mos pranuar më materialet e parapërgatitura nga zyrat e institucioneve e të partive politike.
- **Së treti**, deri atëherë, emegjithë censurën e butë a të hapur, Media duhet të shfrytëzojë cdo hapësirë për të sjellë e faktuar të vërtetën, si e vetmja rrugë për të fituar ditë pas dite, besimin e shikuesve/lexuesve, e për pasojë edhe peshën konkrete si pushtet i katërt në demokraci.
- **Së katërti**, solidaritet me kolegët europianë e të organizatave ndërkombëtare të mediave, për të koordinuar përpjekjet, në mbrojtje të të drejtës për të ushtruar këtë profesion në një mjedis sa më të lirë, sidomos për vende si tonat, nën monitorim për t’u bërë pjesë e BE-së.

MBROJTJA E BURIMEVE TË INFORMACIONIT PËR MEDIAT

Kjo temë zë fill që te përkufizimet e para të lirisë së shtypit, themelimi i së cilës i njihet Suedisë. Në legjisllacionin e hershëm të këtij shteti u inkorporua në vitin 1766 një ligj, që i ndryshuar më vonë shumë herë, nuk ndali së rendituri deri më sot elementet e të parës prej lirive që sanksionoi: ndalimin e çdo censure, mbrojtjen e burimeve të informimit, parimin e aksesit të lirë në dokumentet zyrtare etj.

Këtë postulat liberal ka sanksionuar në mënyrë të heshtur Shteti i Virxhinias në Amerikë më 12 qershor 1776 në Virginia Bill of Rights: ***"Liria e shtypit është një nga mburojat e fuqishme të lirisë dhe s'mund të kufizohet veçse nga qeveritë despotike"***. Kjo porosi e vyer, e cila që atëhere mori vlerën e një parimi u fut më 1791 në Amendamentin I të Kushtetutës së Shteteve të Bashkuara me shprehjen: ***"Kongresi nuk do të nxjerrë asnjë ligj që kufizon lirinë e fjalës apo të shtypit"***.

Me po këto terma universalë, filozofë liberalë dhe konstitucionalistë francezë synuan dhe ia arritën të gdhendnin lirinë e fjalës në Deklaratën e të Drejtave të Njeriut dhe Qytetarit (1789), nëpërmjet një teksti lakonik të nenit 10 të saj: ***"Askush nuk mund të ndëshkohet për opinionet e veta"***. Ndërsa në nenin 11 të kësaj Deklarate gjendet fomulimi për lirinë e botimit: ***"Komunikimi i lirë i mendimeve dhe opinioneve vetjake është një nga të drejtat më të çmuara të njeriut; çdo qytetar mund pra të flasë, të shkruajë, të shtypë lirisht, por duhet të përgjigjet për abuzimin me këtë liri në rastet e përcaktuara nga ligji"***. Beteja për lirinë e botimit, që e shpalli Revolucioni francez, më pas kulmoi në Francë me ligjin e 29 korrikut 1881, që me ndryshime të herëpashershme ndjeshëm dhe në mënyrë të znaduar përbën edhe sot atje një bazë e së drejtës pozitive në fushën e shtypit.

* * *

Në kohët që pasuan, trashëgimtarët e filozofisë iluministe, të cilët përpunuan edhe doktrinën librare të informacionit, në mënyrë kategorike kundërshtuan aplikimin në këtë fushë të nocionit të autoritetit. Kjo doktrinë mjaftohet sot me pohimin se, askush nuk mund ta ketë monopolin e së vërtetës e kuptuar si përputhja e mendimit të shprehur me realitetin e vrojtuar; kjo e vërtetë nuk mund të jetë asnjëherë privilegj i një njeriu të vetëm, as i një klase të vetme. Në këtë kuptim pra, doktrina liberale i kundërvihet çdo përpjekjeje për ta vendosur të vërtetën në rrugë autoritare. Por, pa dyshim që është parimi i ***"interesit" publik*** ai që ka frymëzuar të gjitha rregullat e zbatueshme ndaj ndërmarrjeve të shtypit dhe mediave në përgjithësi, tërësia e të cilave është njohur dhe thirrur zakonisht si rregullimi ***"administrativ"*** i këtyre ndërmarrjeve apo sipërmarrjeve. Ky shqetësim, për shembull, në Francë ka justifikuar edhe sanksionimin e krimeve ndaj shtypit. Dhe lista e këtyre ka qenë atje e gjatë, aq sa i madh është liberalizmi në këtë fushë. Sidoqoftë, veçanërisht pas Luftës II Botërore, kufizimet specifike që i bëhen lirisë së shtypit,

kur shprehin vullnetin e ligjvënësit, përjashtojnë vetcensurën, që konsiderohet si forma më mashtruese e asaj që në gjuhën e përditshme quhet censurë. Këtë të fundit e përjashtonte kategorikisht në Republikën Federale të Gjermanisë Ligji Themelor më 25 maj 1949, duke urdhëruar: **“Nuk ka censurë”**.

Që këtej vijmë te Konventa Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive Themelore të Njeriut (më poshtë: KEDNJ, ose Konventa), që u hartua më 1950, veçse 1 vit pas krijimit të Këshillit të Evropës më 1949. Neni 10 i këtij Dokumenti bazik në këtë fushë është një nga 12 nenet (sot 25) që përmbante teksti original. Dhe ky kujdes i hartuesve ndodhi për faktin se, e drejta për lirinë e shprehjes jo vetëm që është një gur themeli i demokracisë, por është gjithashtu një pritje shpresëdhënëse për gëzimin e shumë të drejtave dhe lirive të tjera të mishëruara atëhere në këtë Konventë dhe, më vonë, në Protokollet Shtesë të saj. Për shkak të rëndësisë së kësaj të drejte, shumë nga çështjet që kanë përcaktuar standardet e interpretimit për parimet kryesore të Konventës, konsiderohet të kenë dalë nga neni 10 i saj.

“Çdokush ka të drejtën e lirisë së shprehjes. Kjo e drejtë përfshin lirinë e mendimit dhe lirinë për të marrë ose për të dhënë informacione ose ide pa ndërhyrjen e autoriteteve publike dhe pa marrë parasysh kufijtë. Ky nen nuk i ndalon shtetet që të vendosin regjim autorizimesh për sipërmarrjet e radiodifuzionit, të kinemasë, ose të televizionit” – kështu thuhet në paragrafin e parë të këtij neni, që i jep termit shprehje një fushë të gjerë veprimi. Një term pra, që zbatohet jo vetëm për informacionin e disponueshëm për publikun, por edhe për ato që fyejnë, trondisin Shtetin, ose çdo pjesë të popullsisë, në hierarkinë e vlerave dhe në kontekstin e debatit publik. Mirëpo, paragrafi i dytë i këtij neni parashikon, se ushtrimi i lirisë së shprehjes dhe i informimit përmban detyrime dhe përgjegjësi, që mund t’u nënshtrohen disa formaliteteve, kushteve, kufizimeve, ose sanksioneve të përcaktuara nga ligji dhe që në një shoqëri demokratike përbëjnë masa të nevojshme **“...për sigurimin kombëtar, integritetin territorial ose sigurinë publike, për mbrojtjen e rendit dhe parandalimin e krimit, për ruajtjen e shëndetit ose të moralit, për mbrojtjen e dinjitetit ose të të drejtave të të tjerëve, për të ndaluar përhapjen e të dhënave konfidenciale ose për të garantuar autoritetin dhe paanshmërinë e pushtetit gjyqësor”**.

Të mos harrojmë që edhe në Shqipëri, me disa vendime të Gjykatës Kushtetuese dhënë gjatë viteve të fundit, për respektimin e të drejtave dhe lirive themelore të njeriut KEDNJ ka fituar një status të njëjtë me dispozitat kushtetuese, të cilat (neni 17) përcaktojnë që **“Kufizimi duhet të jetë në përpjestim me gjendjen që e ka krijuar atë”** dhe se **“Këto kufizime nuk mund të cenojnë thelbin e lirive dhe të të drejtave dhe në asnjë rast nuk mund të tejkalojnë kufizimet e parashikuara në Konventën Evropiane për të Drejtat e Njeriut”**. Sidoqoftë, as Kushtetuta dhe as Konventa nuk e detyrojnë ligjvënësin që të hartojë dhe të miratojë një ligj, i cili bën të mundur përjashtimet në mbrojtjen e lirisë së informimit.

Por, që gazetari të mos bjerë “pre” e këtyre kufizimeve, atij i duhet të ndjekë një qëllim të konsideruar si legjitim, për shembull, shqetësimin për të informuar publikun rreth asaj që kërkon ai, proporcionalitetin e qëllimit të ndjekur për të informuar rreth një ngjarjeje apo zhvillimi me dëme të shkaktuara, një farë gjykimi në verifikimin e informacioneve, duke pasur kujdes për një farë maturie dhe duke kundërshtuar në çdo rast armiqësitë personale. Ndryshe, gazetari apo media përkatëse mund “të shkelë” në një fushë jo fort të bleruar, duke u akuzuar dhe ndëshkuar rëndom për shpifje, për injorim të konkurrencës së lirë apo për ndërhyrje në jetën private të tjetrit. Për këtë të fundit mund të thuhet se, e drejta e përgjithshme e personalitetit nuk mbështet pretendimin e individit për t’u paraqitur nga të tjerët ashtu siç e sheh ai veten apo siç dëshiron ai të shihet nga të tjerët. Një mbrojtje e mëtejshme e kësaj natyre, duke kërkuar për shembull ekspozimin e burimeve të informacionit,

jo vetëm nuk përputhet me qëllimin e saj për të kapërcyer deri në një farë mase rreziqet që i kanosen shpalosjes së personalitetit, por do të prekte edhe sferën e lirisë së të tretëve. Ndërsa, duke denoncuar skandalet, duke ekspozuar fajtorët, gazetarët dhe mediat ku ata janë të punësuar kënaqin, të paktën verbalisht, kërkesat e publikut dhe nevojën e tij të mundshme qoftë edhe për të protestuar. Dhe askush nuk duhet t'u kërkojë llogari atyre se ku i gjetën dhe kush i njohu me të dhënat për “plasjen” e këtij apo atij skandali.

E pra, për këto të themi denoncime gazetarët janë plotësisht të mbrojtur nga neni 10 i Konventës, sepse një nga aspektet e garantimit të ofruar gjatë ushtrimit prej tyre të lirisë së shprehjes dhe informimit është mbrojtja e burimeve konfidenciale të informacionit, të cilat formojnë bazën e gazetarisë investigative, por që mund të bien madje në konflikt edhe me ndonjë nga qëllimet legjitime të parashtruara në paragrafin 2 të nenit 10. Prandaj deklarimi i burimit të informacionit është i justifikueshëm vetëm kur këtë e kërkon një interes i përgjithshëm publik, ose edhe i një individi apo grupi të veçantë njerëzish, për të cilët shoqëria në përgjithësi pranon dhe pretendon mosdiskriminim të tyre.

* * *

Tani le të përmendim disa çështje gjyqësore konkrete të krijuara për motive të ndryshme, të cilat kanë gjetur zgjidhje në Gjykatën Evropiane të të Drejtave të Njeriut (më poshtë: GjEDNj, Gjykata, ose Gjyakata e Strasburgut), e cila si organ i Konventës e konsideron këtë në çdo rast si një “qenie” të gjallë dhe në zhvillim, jo si një dokument statik i vlefshëm veçse për kohën dhe kushtet kur është hartuar e ratifikuar nga Shtetet - Palë Kontraktuese. Për shembull, çështja HCLU **kundër Hungarisë** ishte rasti i parë ku u gjet shkelle e nenit 10, për ndërhyrje në të drejtën për akses në informacione shtetërore. Në këtë çështje, Gjykata u shpreh, se neni 10 i KEDNj garanton ‘të drejtën e aksesit të informacionit’, të mbajtur nga autoritetet publike; se kur Shteti posedon të dhëna me interes publik dhe kërkohet që t’ia publikojë ato një grupi mbikqyrës - shtypit dhe mediave apo Organizatave Jo Fitimprurëse, që kanë rol mbikqyrës - ai është i detyruar të mos pengojë rrjedhjen/dhënien e informacionit. Gjykata vuri në dukje se, Shtetet janë të detyruara që të eliminojnë barrierat ndaj ushtrimit të funksioneve të shtypit, në çështje të interesit publik, kur barrierat të tilla ekzistojnë vetëm për shkak të një monopoli të informacionit që mbahet nga autoritetet, duke arritur në përfundimin që kontrolli i Gjykatës Kushtetuese të Hungarisë ndaj informacionit të kërkuar krijonte një lloj ‘monopoli të informacionit’.

Ndërsa, për të arsyetuar mbi rëndësinë e ekuilibrit midis interesave të drejtësisë dhe të drejtave të të tjerëve nga njëra anë, si edhe interesit për të mbrojtur burimet e informimit nga ana tjetër, mund të shërbejë këtu përmendja e çështjes **Gudvin kundër Mbretërisë së Bashkuar** (1996). Ishte gazetari anglez Gudvin i gazetës ‘**The Engineer**’, i cili një ditë mori nga një ‘burim’ me telefon informacionin mbi firmën ‘**Tetra Ltd**’, se kjo ishte duke marrë një kredi të madhe, ndërkohë që kishte probleme të rënda financiare. Gjatë përgatitjes së një artikulli mbi këtë temë, Gudvin i telefonoi firmës për t’i marrë ndonjë koment rreth kësaj teme. Pas kësaj telefonate, firma ‘Tesla Ltd’ i kërkoi një gjykatë të vendit të tij që të urdhëronte mosbotimin e artikullit, duke argumentuar se, interesat e tyre ekonomike dhe financiare mund të pengoheshin seriozisht nëse informacioni do të bëhej publik. Urdhëri u dha dhe firma u dërgoi nga një kopje të gjitha gazetave kryesore. Pastaj, firma iu drejtua gjykatës për t’i kërkuar gazetarit që ky të zbulonte identitetin e burimit të tij. Por gazetari nuk e bëri këtë. Prandaj u gjodit, sipas gjykatës britanike, për “**pengim në zbatimin e drejtësisë**”. Pasi Gudvin iu drejtua Gjykatës së Strasburgut, kjo në vendim i saj u shpreh, se: “**Mbrojtja e burimeve gazetareske është një nga kushtet bazë për lirinë e shtypit, ashtu siç pasqyrohet në ligjet dhe kodet profesionale të sjelljes në një numër shtetesh Kontraktuese dhe siç është pohuar në disa instrumente ndërkombëtare mbi liritë gazetareske.**”

Pa një mbrojtje të tillë burimet mund të stepen dhe të mos ndihmojnë shtypin në informimin e publikut mbi çështjet e informimit publik". Përfundimisht, Gjykata e Strasburgut konkludoi se: "...urdhri që i kërkonte kërkuarit të zbulonte burimin e tij, edhe gjoha e vënë atij për refuzimin ndaj këtij urdhri, shkaktuan një shkelje të së drejtës së tij për lirinë e shprehjes".

Pa gjykimit të çështjes që pëtmendëm më sipër, më 8 mars 2000 Komiteti i Ministrave të Këshillit të Evropës miratoi një Rezolutë të posaçme mbi të drejtën e gazetarëve për të mos qenë këta të detyruar të zbulojnë burimet e informacionit. Sipas këtij Rekomandimi, sistemet ligjore kombëtare mund dhe duhet të përfshijnë në ligjet vendase klauzolat që mbrojnë burimet konfidenciale të gazetarëve. Madje edhe kushtet primare ose interesat jetike që kërkojnë të imponojnë zbulimin e këtyre burimeve duhet të balancohen kundrejt nevojës për mbrojtjen e mbrojtjen e burimeve të informimit, si pjesë e mbrojtjes së lirisë së shprehjes. Dhe, në vendet ku mbrojtja e burimeve të gazetarëve nuk bëhet me akte ligjore, gjykatat duhet ta pranojnë këtë mbrojtje si pjesë të ligjit Evropian dhe si pjesë e parimeve ligjore të njohura ndërkombëtarisht. Këto gjykata duhet të jenë ruajtëse të lirisë së shprehjes, që mbulon edhe nevojën e mbrojtjes së burimeve të gazetarëve në të gjitha insrtancat, duke përfshirë ato instanca ku gazetarëve u kërkohet të përgjigjen si mbrojtës apo edhe dëshmitarë. Ato duhet të mbajnë këtë qëndrim për t'u udhëhequr vetëm nga parimi i proporcionalitetit dhe nga roli i shtypit apo i mediave në demokraci.

Një rol i tillë, sidomos ai i gazetarisë investigative, nuk mund të jetë i efektshëm për sa kohë mediat nuk kanë akses në një burim informacioni të disponueshëm. Kur një burim i tillë i ofrohet gazetarit, për ta vënë në dispozicion të publikut, ky akses mbrohet nga liria e informimit. Por, sipas një vendimi të Senatit të Parë të Gjykatës Kushtetuese Federale të Gjermanisë, datë 24 janar 2001: **"Një burim informacioni ka akses për të gjithë, nëse ai është i përshtatshëm dhe i përcaktuar për t'u dhënë informacione të gjithëve..."**. Megjithatë, çështja e gazetarit Gudvin nuk mbeti e vetmja në dosjet e Strasburgut, edhe pas shpërndarjes së Rezolutës së Komitetit të Ministrave të Këshillit të Evropës. Kështu, GJEDNj konstatoi disa vite më vonë shkelje të nenit 10 atje ku autoritetet kishin kryer kontrollin të shtëpive dhe zyrave të disa gazetarëve, me qëllim marrjen e informacioneve për burimet e tyre, në rrethana kur nuk ekzistonte asnjë dyshim se ata mund të qenë përfshirë në ndonjë veprimtari kriminale. Në të dyja këto çështje: **Romen dhe Schmit kundër Luksemburgut** (2003), si edhe **Ernst dhe të Tjerë kundër Belgjikës** (2003), Gjykata konstatoi se kontrollin prishën mbrojtjen e burimeve të gazetarëve në një shkallë edhe më të madhe se sa masat në çështjen e Gudvin.

Dhe përsëri janë paraqitur në Strasburg ankesa të tjera nga shtetas të ndryshëm të Palëve Kontraktuese të Konventës. Për ilustrim ndoshta mjafton të tregojmë shkurtimisht një çështje të shqyrtuar së fundi, se si GJEDNj vendosi më 13 tetorin e këtij viti fatin e ankimit të gazetares norvegjeze, Cecilie Langum Becker, së cilës i ishte kërkuar me vendim gjyqësor në vendin e saj, si nga Gjykata e Oslos, po ashtu edhe nga Gjykata e Apelit në Borgarting, që të jepte dëshmi për kontaktet dhe burimet e një artikulli të saj rreth të metave të vërejtura në një kompani naftë. Në mungesë të atyre dëshmimeve, më janar 2012 znj. Becker u urdhërua që të paguajë një gjobë prej rreth 3,700 eurosh (konvertuar me monedhën vendase). Kur Gjykata e Strasburgut konfirmoi se e drejta e znj. Becker si gazetare për të mbrojtur burimet e saj konfidenciale nuk mund të hiqej automatikisht për shkak të sjelljes së një burimi, ose për shkak se identitetin e burimit ajo nuk e kishte bërë të njohur. Gjithashtu, Gjykata vlerësoi dhe vendosi që Norvegjia duhej t'i rimbursonte gazetares gjobën e urdhëruar për t'u paguar. Me këtë rast: **"Së bashku me degën e saj norvegjeze, Norsk Journalistlag (NJ), Federata Evropiane e Gazetarëve (EFJ) e mirëpret këtë vendim të qartë" - tha që atë ditë Sekretari i Përgjithshëm, Ricardo Gutiérrez. "Ky gjykim - shtoi ai - forcon mbrojtjen e burimeve të gazetarisë, e cila është një nga kushtet themelore për lirinë e medias. Prandaj u bëjmë thirrje Shteteve të miratojnë legjislacionin me qëllim të zbatimit të të drejtës së gazetarëve për të mbrojtur burimet e tyre, duke ndjekur standardet ndërkombëtare".**

Po në Shqipëri si duket situata? Gjatë instalimit edhe këtu të sistemit pluralist kanë ndodhur raste flagrante të djegjes në vitet '90 të gazetës së parë të pavarur, si edhe të shkatërrimit në vitet '2000 të një gazete tjetër nga një qeveri autoritariste, për shkak se kjo e kishte të pamundur që të kërkonte zbulimin apo identifikimin e burimeve opozitare të këtyre gazetave, kur këto përfshinin pjesën më të madhe të popullsisë. Në vijim, jo shumë kohë më parë një gazetar investigativ u ndalua nga Prokuroria e Krimeve të Rënda për rreth 48 orë dhe, pasi gazetari nuk iu përgjigj pyetjes së organit të hetimit, se cilat qenë burimet e tij për çka kishte shprehur në një media informative, më së fundi e lanë të dilte nga qelia, por duke i mbajtur celularin ku shpeshohej që të identifikoheshin ato burime. Dhe ku mbështetej Prokuroria në këtë veprim arbitrar? Pikërisht te një dispozitë çuditërisht ende e pa amenduar apo e pa ndryshuar e tekstit origjinal të Kodit tonë të Procedurës Penale, i cili u hartua më 1994 dhe hyri në fuqi në fillim të vitit 1995, pra përpara se sa Republika e Shqipërisë të miratonte dhe ratifikonte Konventën Evropiane për Mbrotjtjen e të Drejtave dhe Lirive Themelore të Njeriut, si edhe Kushtetutën në vitin 1998. Konkretisht, në pikën 3 të nenit 159, "Ruajtja e sekretit profesional", Kodi shprehej se: ***"Dispozitat e parashikuara nga paragrafi 1 dhe 2 zbatohen edhe për gazetarët profesionistë lidhur me emrat e personave nga të cilët ata kanë marrë të dhëna gjatë ushtrimit të profesionit të tyre. Por, kur të dhënat janë të domosdoshme për të provuar veprën penale dhe vërtetësia e këtyre të dhënave mund të dalë vetëm nëpërmjet identifikimit të burimit, gjykatat urdhëron gazetarin që të tregojë burimin e informacionit të tij"***. Një dispozitë kjo që është në kundërshtim të plotë me nenin 10 të KEDNj dhe, si e tillë, të konsiderohet nul.

* * *

Duke e mbyllur diskutimin tim, mund të them se asnjë urdhërim apo kërcënim ndaj gazetarëve për të ekspozuar burimet e informacioneve të tyre "nuk pi ujë", nuk mund të japë efekt, gjithashtu edhe se, ashtu sikurse neni 10 i Konventës përmend te kufizimet e parashikuara në paragrafin e dytë të tij kujdesin për mbrotjtjen e dinjitetit dhe të të drejtave të të tjerëve, ky kujdes duhet treguar edhe nga gazetarët dhe për vetë gazetarët. Sepse, po të tregojnë haptazi ata identitetet e atyre personave, që në mirëbesim përbëjnë burime konfidenciale të informacioneve, atëhere jo vetëm që dëmtojnë seriozisht punën e tyre në të ardhmen, por edhe dëmtojnë rëndë dinjitetin, ***dinjitetin immanent*** të qenies së vet, siç e përmend Deklarata Universale e të Drejtave të Njeriut (1949), në frymën e së cilës u hartua edhe KEDNj. Vetëm ai, dinjiteti pra, konsiderohet dhe njihet ndërkombëtarisht me vlerë absolute, në ndryshim nga të drejtat dhe liritë themelore, të cilat vërtet që nuk e kanë këtë atribut, por mbështeten fort dhe bindshëm mbi të.

INVESTIGIMI NË SHQIPËRI, GAZETARËT E RINJ DHE NAFTA NË LABORATOR

Gazetaria investigative cilësohet si një nga misionet më të vështira që profesionistët e kësaj fushe duhet të përballen. Dihet se investigimi kërkon të shkojë përtej asaj që duket, nuk mjaftohet me deklaratimet formale, por kërkon të zbulojë apo të rish-qyrtojë faktet dhe nuk mjaftohet thjesht me përshkrimin e tyre. Një shkrim investigativ kërkon një “punë të nëndheshme” duke gërmuar thellë që në përfundim të sjellësh një shkrim të argumentuar me fakte mbështetës dhe bindës për publikun.

Jo çdokush mund të bëjë një shkrim investigativ, kjo jo për shkak të paftësisë apo paditurisë, por për disa shkaqe që ndonjëherë nuk varen nga gazetari. Të investigosh mbi një çështje së pari të duhet një kohë e konsiderushme. Nëse fillon të hulumtosh dhe të mbledhësh fakte mund të të duhet të punosh me muaj në mënyrë që të sjellësh një shkrim të argumentuar. Por në një treg mediatik më të cilin përballen sot gazetarët në Shqipëri, duket si “mission impossible”, pasi më shumë se cilësi në redaksi kërkohet sasi. Së dyti, të investigosh kërkon të ardhura, të cilat ekonomia e medias shqiptare nuk arrin t’i përballojë ose nuk i intereson për shkak të politikave redaksionale. Këto janë ndoshta dhe dy arsytet se pse gazetaria e ka humbur rolin e watchdog-ut dhe është kthyer në një mjet propagandues të politikës apo interesave komerciale.

LABORATORI INVESTIGATIV ME GAZETARË TË RINJ

Laboratori i Gazetarisë Investigative u krijua në vitin 2016 dhe vazhdon ende në ditët e sotme. Laboratori është një nismë për trajnimin e studentëve, mbështetur financiarisht nga Ambasada e SHBA në Tiranë dhe Zyra e Programeve Alumni të Departamentit të Shtetit të SHBA. Një laborator ku mësohet jo vetëm si të bëhesh një gazetar i mirë investigativ, por mbi të gjitha si ta marrësh një çështje seriozisht, ta zbërthesh deri në grimcën më të vogël, ta duash atë që bën duke fjetur dhe u zgjuar me një të njëjtin “ekucion” që duhet zgjidhur. Në projekt janë zgjedhur pikërisht gazetarë të rinj, me perspektivën që e nesërmja e gazetarisë të jetë më e mirë se ajo që është sot. Në fazën e parë të projektit janë publikuar gjithsej 7 shkrime investigative, të cilat janë rishpërndarë dhe botuar në media, duke dhënë një impakt të madh tek publiku.

SI U NGJIZ INVESTIGIMI “NAFTA NË SHQIPËRI, HISTORIA E NJË KRIMI TË PANDËSHKUAR”

Cilësia e naftës shqiptare është një nga temat më të ndjeshme që haset në disa sfera të jetës. Të gjithë ankoheshin nëpër rrjete sociale dhe forume (dhe vazhdojnë ende të ankohen) se nafta që merrej jashtë kufijve ishte e një cilësie më të mirë dhe digjej më ngadalë se nafta që blihej në pikat e karburantit brenda vendit tonë. Një temë pothuajse e paprekur më parë, me fakte se nafta po shkatërronte makinat, por asnjë vërtetim laboratorik se si ishte cilësia e produktit që blihej në karburantet shqiptare. Këto dhe shumë të tjera ishin shtysat e para që ne vendosëm të bënim një analizë laboratorike të naftës brenda vendit dhe asaj të vendeve fqinje, më pas për të dalë në konkluzionin që të gjithë përdoruesit e automjeteve pëshpërisnin në bisedat e përditshme: Cilësi e dobët e naftës.

HARTA E MENDIMEVE

Pasi caktuam temën, krijuam një listë me institucionet ku mund të vilnim çfarëdo informacioni që kishte të bënte me naf-tën. Insitucioni i parë në listë ishte ISHTI (Inspektoriati Shtetëror Teknik dhe Industrial), i cili është përgjegjës për kontrollin periodik të karburanteve dhe cilësisë të produktit që tregtonin. Institucioni i dytë ishte Agjencia Kombëtare e Mjedisit prej të cilës duhet të mësonim se çfarë dëmsh mjedisore provokon cilësia e naftës. Pasi të mblidhnim disa informacione bazë, ne duhet të mblidh-nim mostra naftë në vendet kufitare dhe në karburantet brenda vendit për t'u testuar më pas laboratikisht në një laborator privat jashtë shtetit. Së bashku me informacionet zyrtare, e nevojshme ishte dhe mbledhja e dëshmimeve dhe eksperiencat personale të përdoruesve të automjeteve.

FILLIMI I PUNËS, KISHIM MARRË NË DORË NJË NGARKESË TË RËNDË

Si fillim institucioni i parë që kemi kërkuar informacion ka qenë ISHTI, i cili shënoi fillimin e punës në muajin nëntor të vitit 2016. Vështirësia e parë që hasëm ishte që tek dera e institucionit ku roja i subjektit na ndaloi hyrjen pasi me të drejtë nuk kishim lënë asnjë takim. Por pasi u prezantuam si gazetarë investigativë dyert e institucionit u hapën pavarësisht se me dyshimin që nu-hatej në veprimet e nëpunësve. Një sqarim paraprak na hapi dyert për një takim me drejtorin e institucionit së bashku me drejtorët e dy departamenteve. Kjo nuk ishte hera e parë dhe e fundit që ne vizituam institucionin kyç për çështjen tonë. Pas herës së parë, takimet e tjera ishin shumë herë më të lehta, gjithmonë ishte një drejtor që merrte në ngarkim të na servirte informacionet që na nevojiteshin.

Proçesi i takimeve zgjati rreth 3 muaj dhe gjatë kësaj kohe ISHTI filloi që të bënte funksionale website-in e tyre dhe informa-cionet që më përpara merreshin dorazi filluan të bëheshin publike në faqen e tyre zyrtare.

Gjatë kësaj kohe, drejtuesit na mundësuan dhe një vizitë në laboratorin e institucionit (në të cilin hynin vetëm personat përgjegjës) për të na treguar më nga afër sesi funksiononte procesi i marrjes së mostrave nga karburantet dhe analiza e tyre labo-ratorike.

Një tjetër institucion që na u desh të përballeshim ishte Agjencia Kombëtare e Mjedisit, në të cilën, na u desh të për-balleshim me ironitë dhe jo-profesionalizmin e kreut të institucionit. Pasi kishim takuar sekretaren dhe kishim dërguar në mënyrë elektronike një kërkesë informimi, na u mundësua një takim me drejtorin, të cilin e takuam në zyrën e tij.

Me një kërkesë informimi në dorë, dy gazetarët kemi hyrë në zyrën e drejtorit në të cilën nuk mund të shihje qartë për shkak të tymit të cigares që kreu i kësaj drejtorie konsumonte. Kreu i Agjensisë Kombëtare të Mjedisit që shkel ligjin Antiduhan. Cfarë paradoksi! Por pjesa më e pazakontë fillon në momentin kur zotëria në fjalë lexon me tallje se kush ishim ne. Me një ton ironizues dhe mospërfillës drejtori lexon me zë të lartë "Laboratori i Gazetarisë Investigative" dhe një shfryrje në fund të leximit. Më pas, gjatë bisedës nisi të na sillte vërdallë duke na pyetur se pse kishim ardhur në atë institucion, kush na kishte orjentuar, se informacioni që kërkonim s'kishte kuptim, se agjencia e tij nuk e kishte këtë informacion, e më pas duke na përcjellë nga dera që erdhëm.

Jo më vonë se 3 ditë, në e-maillet tona mbërrin një e-mail me informacionet që kërkonim dhe me dashamirësi na kërkohet që të drejtoheshim për kërkesë informimi sa herë që kishim nevojë.

VËSHIRËSITË E KAMUFLIMIT DHE PËRDORJA E EMRIT TË PROJEKTIT

Shumë herë na është dashur të përdorim fjalinë “Gazetarë investigativë nga një projekt i financuar nga Ambasada Amerikane” për të marrë, së pari respektin në institucione dhe së dyti informacionin që kërkonim. Në rastet kur e kemi “përdorur” emrin e projektit ne si gazetarë të rinj kemi marrë më shumë mbështetje dhe mikpritje nëpër institucione duke na pritur dhe përcjellë me mirësjellje. Por dhe në shumë raste të tjera na është dashur të deklarohejmë që jemi thjesht studentë që po bëjmë një detyrë shkolle për të marrë disa informacione që nëse do të ishte e ditur që do të ishim gazetarë nuk do të na ofroheshin, por në të njëjtën kohë për të parë dhe anën tjetër si trajtohen qytetarët e tjerë.

Një rast i tillë është hasur gjatë një dite pune, larg temës së naftës. Dy grupe të ndara rastësisht jemi paraqitur në orare dhe ditë të ndryshme pranë ILDKPI-së. Ajo që të gjithëve na bëri përshtypje ishte mikpritja me dy standarte. Disa nga kolegët tanë që ishin prezantuar si gazetarë të projektit i kishin orientuar drejt zyrës së marrëdhënieve të publikut, zyrë që ndodhej brenda institucionit, në një mikëpritje më shumë për të shuar kuriozitetin dhe për të psikologjisur se cili ishte qëllimi i këtyre gazetarëve investigativë. Pas “intervistës” së shkurtër kolegët kishin dorëzuar kërkesën e informimit dhe ishin përcjellë me dashamirësi.

Ndërsa ne, grupi i dytë që u paraqitëm si qytetarë që donim të merrnim informacion, na orientuan tek protokollin e institucionit, një zyrë ngjitur me institucionin në të cilën na u desh të kalonim përmes një garazhi me beton e tulla, pra tërësisht informal. Pasi pritëm disa minuta, që dikush të na përgjigjej dhe të ngrihej nga tavolina e punës për të na dhënë disa sqarime, na përçollën duke na informuar se materialet merreshin vetëm përmes postës dhe jo dorazi apo në formë tjerër në të cilat ligji për të drejtën e informimit e lejon.

PUNA NË TERREN ME NAFTËN

Gjithsej u morën tetë kampione naftë, pesë prej të cilave në Tiranë, Elbasan, Shkodër dhe zonat kufitare të Shqipërisë dhe tri të tjera në pikat e karburanteve të vendeve fqinje. Në Tiranë dy mostrat u morën nga dy pika karburanti të vendosura në Tiranën e Re. Një nga mostrat u mor në afërsi të Bradasheshit në Elbasan, një mostër u mor në qytetin e Shkodrës dhe e pesta u mor në afërsi të pikës doganore të Kapshticës.

Të pesta mostrat në Shqipëri u morën në pika karburanti të përzgjedhura rastësisht, duke pasur si qëllim analizimin e kompanive më të rëndësishme që operojnë në tregun e shpërndarjes së naftës në vend. Mostrat e naftës u morën në pikat e shpërndarjes së kompanive Eko Al, Alpet, Gega Oil, Gulf dhe Kastrati.

Në Malin e Zi, Maqedoni dhe Greqi mostrat u morën në pika kufitare, nën emrin e shpërndarësve të rëndësishëm të naftës në këto vende, përkatësisht në Kalamper Oil, MakPetrol dhe Elin Oil.

Mostrat u ekzaminuan në laboratorin shkencor NAIAS në Pire të Greqisë, për t`u analizuar më pas nga një inxhinier me eksperiencë në fushën e hidrokarbureve, i cili përdori për to shkallën e vlerësimit nga 0 deri në 5 (yje), ku zero ishte cilësia më e ulët e gjetur dhe pesë ajo më e larta. Ekspertit iu dhanë elementët për t`u interpretuar, pa përcaktuar se cilës kompani i përkisnin apo nga cili vend mostrat vinin.

Pavarësisht se në Shqipëri kanë munguar investigimet e pavarura apo institutet dhe laboratorët privatë për të analizuar cilësinë e naftës, qindra-mijëra qytetarë ndjejnë çdo ditë pasojat e cilësisë së saj të ulët në automjetet e tyre dhe miliona të tjerë efektet e saj në ndotjen e ajrit.

DËSHMITË E GJALLA TË NAFTËS ME SHUMË PROBLEME

Arditi, një taksist i ri nga Shkodra, tha për PSE se, pas përvojave të hidhura me naftën që shitej në pikat e karburantit të qytetit të tij, ai së bashku me kolegë të tjerë furnizoheshin me naftë në Ulqin, rreth 40 kilometra nga kufiri.

“Ne shkojmë në Ulqin, se nafta është më e lirë dhe më cilësore. Ndryshimi duket qartë, kur furnizohesh me naftë vendi dhe kur me atë malazeze. Mua personalisht më është prishur makina “Benz” nga cilësia e keqe e karburantit. Më ka mbetur makina në shtëpi nga dëmtimi i motorit. Naftën këta e përziejnë me solar”, – tha ai.

Ndërkaq, K. L., kamerier në një bar në pikën kufitare të Kapshticës, nuk ngurroi të tregonte për PSE se, çdo shqiptar që kishte mundësinë të kalonte me lehtësi këtë pikë doganore me Greqinë, nuk ngurronte të furnizonte me karburant makinën e tij. “Nafta nga ana greke është më lirë dhe me cilësi më të mirë. Ne andej e mbushim. Edhe doganierët shqiptarë andej furnizohen me karburant”, – tregoi ai.

GJURMËT QË LA PAS INVESTIGIMI I NAFTËS

Pas publikimit të investigimit, impakti ishte i madh. Shkrimi filloi të ripublikohej në të gjitha website-t dhe në gazetatat print. Ajo që binte më shumë në sy ishte shpërndarja e materialit pa ndryshuar asnjë gërmë nga investigimi, e mbi të gjitha, emri ynë si gazetarë të rinj nuk ishte hequr nga asnjë website, ndryshe nga ç`ndodh me shkrimet e tjera në portale ku justifikohen vetëm me përdortimin e emrit të medias në ndonjë cep të shkrimit.

Në statuset e shumta në rrjetet sociale vlerësohej puna kërkimore që ne kishim bërë dhe përgëzimet për pavarësinë që kishim treguar në shkrimin tonë. Ajo që binte më shumë në sy gjatë bisedave ishte sesi një temë kaq e ndjeshme për publikun nuk ishte trajtuar më parë.

I pyetur nga gazetari Lutfi Dervishi në RTSH mbi rezultatet e investigimit, kryeministri Rama u shpreh:

“Patjetër që ka një problem serioz në këtë aspekt dhe, edhe për këtë ne jemi përgatitur shumë seriozisht për të ristrukturuar rrënjësisht të gjithë skemën e kontrollit të naftës dhe për të shfrytëzuar një kontratë të trashëguar me një kompani të huaj që markon apo shënjon naftën dhe për të avancuar në këtë aspekt me futjen e teknologjisë së re qysh në hyrje të naftës në gjithë

rrugën që pastaj përshkohet deri kur vjen tek makina”.

KONKLUZIONE DHE REKOMANDIME

- **Së pari**, të qenit një gazetar i ri në treg nuk është shumë favorizues, pasi pyetja e parë që të drejtohet është: në cilin televizion/gazetë punon? Dhe në momentin që ti nuk tregon emrin e një medie të njohur, nënvlerësohesh dhe të jepet një informacion i cunguar, ose refuzojnë të të përgjigjen. Por me durim dhe këmbëngulje qëllimi primar arrihet.
- **Së dyti**, pritja në insitucione lë për të dëshiruar. Përpos burokracive duhet të përballësh shpeshherë me njerëz aspak të komunikueshëm dhe që nuk bëjnë punën për të cilën paguhen.
- **Së treti**, terreni për të bërë gazetari investigative është normalisht aspak miqësor. Duhet të mendohesh shumë herë për të publikuar me emër një kompani apo institucion, pasi je në një terren të turbullt ligjor.
- **Së katërti**, publiku ka nevojë për më shumë shkrime investigative dhe të karakterit hulumtues. Po ashtu të lexojë më shumë rreth çështjeve që ata i prek drejtpërdrejt, e pas kësaj të jepet një zgjidhje.
- **Së pesti**, në universitet, studentët duhet të përgatiten më shumë me botën e gazetarisë që i pret përtej auditorit, të mësojnë më shumë për gazetarinë investigative dhe hulumtimet e detajuara.
- **Së fundmi**, mediat tradicionale akoma janë burimi kryesor i informimit për masën duke bërë kështu që televizioni dhe gazeta ka dhe duhet të ketë më shumë përgjegjësi për të qenë më afër publikut.

LIRI MEDIATIKE? PO, POR PA REKLAMA!

Në prill të vitit 2017 tri kompanitë më të mëdha celulare në vend bënë një lëvizje thuajse të sinkronizuar: çmimet e paketa-ave bazë të Vodafone, Telekom Albania dhe Albtelecom u bënë njësoj.

Ky zhvillim shkaktoi shumë dyshime e reagime në rrjetet sociale, por jo në media. Duke qenë se Citizens Channel ka në fokus të tij mbrojtjen e konsumatorit, kontaktova disa gazetarë që mbulojnë zhvillimet në fushën e ekonomisë për të bërë një analizë të kësaj lëvizjeje.

Sapo u propozoja temën pothuajse të gjithë më përgjigjeshin se jemi në kushtet e pastra të një oligopoli, por nuk donin të shkruanin artikullin sepse kishin frikë se i pushonin nga puna në mediat ku punonin me kohë të plotë. Vetëm një gazetare e televizionit me profil ekonomik SCAN pranoi të shkruante analizën, por vetëm pasi i premtova disa herë se nuk do t'i publikoja emrin.

Artikulli u publikua pa emër. Autoriteti i Konkurrencës po atë muaj nisi një hetim ndaj tri kompanive celulare, i cili zgjati 6 muaj.

Në fund të muajit shtator një koleg që punon për televizionet 24 orë me lajme më nis në WhtasApp raportin hetimor që ishte publikuar në faqen e Autoritetit të Konkurrencës. „Amarildo botoje ti, - më shkruan, – se unë nuk mund ta publikoj.“ Raporti u publikua menjëherë.

Në raport ndër të tjera dilej në përfundimin se **“tre kompanitë më të mëdha të telefonisë celulare në vend kanë shkelur ligjin për Mbrojtjen e Konsumatorit sepse nuk bëjnë transparent çmimin për njësi për çdo shërbim të përfshirë në paketat e hedhura në treg.”**

Gjithashtu se **“lëvizja e njëkohshme e tre kompanive më të mëdha celulare në vend për të njehsuar kohëzgjatjen pa-paketave bazë të komunikimit në katër javë, mund të shtrihet në tregje të tjera si internet, telefonia fikse, paketat televizive, etj., gjë e cila do të ishte në dëm të konsumatorëve”.**

Duke qenë se në Shqipëri me dokumente janë rreth 4.2 milion numra aktivë dhe të gjithë preken nga kjo lëvizje e kompanive celulare që vret konkurrencën në kurriz të qytetarëve, padyshim është informacion që është në interesin publik.

Nëse përfundimet e raportit do të publikoheshin gjerësisht në media do të shkaktonte probleme në imazhin e tri kompanive. Por raporti nuk u publikua nga asnjë televizion, nuk u botua nga asnjë gazetë, madje as edhe në portale.

Kjo nuk është aspak çudi kur të dhënat tregojnë se këto kompani janë reklamuesit më të mëdhenj në vend dhe shikon buxhetin qëpërdorin për publicitet. Sipas të dhënave të Monitor të marra nga deklaratimet në bilanc në vitin 2015 buxheti i marketingut të Vodafone ishte 1.14 miliardë lekë Telekom Albania 997 milionë lekë dhe Altelecom 516 milionë lekë.

Përfitues të këtyre parave janë televizione, gazeta, revista dhe portale, të cilët natyrisht duan të rinovojnë sërish kontratën me pagesit e rrogave të stafit të tyre, prandaj nuk do të botonin asnjë artikull që do të dëmtojte imazhin e burimit të parave sepse në të kundërt 'burimi mund të shterojë'.

Citizens Channel që botoi raportin nuk ka si reklamues asnjë nga këto kompani, madje asnjë reklamues tjetër. Prej pothuajse një viti portali jo-fitimprurës me profil social funksionin vetëm me anë të financimeve të donatorëve.

Ky është vetëm një nga shembujt e shumtë që mund të sjell kur reklamues të mëdhenj, në forma direkte apo indirekte, janë bërë pengesë për publikimin e artikujve në media.

Gjatë eksperiencave si gazetar në redaksitë e televizioneve News24, Top Channel, Planet TV ose Radio Travel, jam përballur shpesh herë me censurën dhe autocensurën vetëm për shkak se raportimet mund të preknin sadopak interesat e kompanive që kishin kontrata me departamentin e marketingut.

Lirinë më të madhe si gazetar e kam provuar gjatë kohës që kam qenë pjesë e redaksisë shqipe të Deutsche Welle, ku axhendën nuk e vendosin zyrat e shtypit të partive, institucioneve apo zyrat e PR të kompanive, isha i lirë nga çdo presion politik apo presion që mund të vinte nga reklamuesit.

Cilat janë mediat më të besueshme sot në Shqipëri? Pikërisht Deutsche Welle, Zëri Amerikës, BBC, AFP dhe së fundmi reporter.al.

Çfarë kanë të përbashkëta të gjitha këto medie? Nuk kanë qëllim fitimin dhe në faqet e tyre në internet nuk është e pranishme me reklama apo njoftime asnjë kompani private apo institucion shtetëror. Buxheti i tyre nuk varet as nga reklamat e as nga klikimet, por nga cilësia e punës që bëjnë.

Nëse katër mediat e para kanë buxhete prej miliona eurosh që vijnë nga paratë e taksapagueseve të secilit prej vendve, reporter.al financohet nga paratë e donatorëve të ndryshëm, ashtu si edhe Citizens Channel.

Në këto portale publikohen artikuj të bazuar në fakte, respektohet etika, shkruhen artikuj dhe prodhohen video për tema që përbëjnë vlerë të interes publik, nuk publikohen lajme me tituj bombastikë për hir të klikimeve, në fund të çdo artikulli është emri i një gazetari dhe ka një ndarje të qartë mes opinionëve dhe artikujve.

Kjo është gazetaria e vërtetë, qëfatkeqësisht redaksitë tradicionale i janë larguar për hir të mbijetesës nga kockat që hedhin departamentet e marketingut të kompanive, sepse tashmë buxheti i reklamave po gllabërohet nga Facebook, Google, Twitter, Instagram dhe Youtube.

Akoma më e rëndësishme situata në redaksitë e mediave online, të cilat si barometrin kryesor të suksesit të tyre kanë numrin e klikimeve, që më pas gjenerohet në të ardhura. Të flasësh për etikë në këto portale është diçka utopike, çdo parim shkelet me të dyja këmbët.

Drejtuesit e redaksive tradicionale duhet të kuptojnë se duke publikuar informacione që përmbajnë propagandë, që nuk janë në interes të publikut apo lajme të rreme, publiku do të largohet drejt burimeve alternative të informacionit që janë të besueshëm.

Gazetaria cilësore tashmë nuk është më privilegj i grupeve të mëdha mediatike. Aktorë të rinj po shpikin me lehtësi dhe entuziazëm gramatikën e re të mediave, të shkëmbimeve, të qarkullimit të informacionit të së nesërme. Ata e bëjnë shpesh falas këtë, sepse media Web është eksituese dhe në të ka vende bosh!

Redaksitë jo fitimprurëse në vendet perëndimore janë dukë bërë të njëjtën punë si redaksitë tradicionale, por pa qëllime fitimi ose varësi ndaj reklamuesve. Madje duke qenë se pjesa më e madhe e redaksive tradicionale vazhdojnë të ndjekin axhendën e politikës dhe zyra të PR të biznesve, redaksitë jofitimprurëse kanë zgjedhur të bëjnë punën e vështirë dhe të shtrenjtë të investigimit.

Fatmirësisht kjo gjë po ndodh edhe në Shqipëri, edhe pse me ritme më të ngadalta në krahasim me vende të tjera të rajonit apo të Europës.

Në dekadën e fundit në Shtetet e Bashkuara dhe Europë, janë krijuar shumë uebsajte të financuar në modelin crowdfunding. Në vitin 2014 në të gjithë botën ishin aktive 1.250 platforma të mbështetura nga një fond prej 16,2 miliard Dollarësh, ndërsa në 2015 platformat crowdfunding u mbështetën me 34.4 miliard Dollarë.

Pra gjithnjë e më shumë qytetarë dhe organizata duan të informohen më shumë nga këto redaksi të pavarura jo-fitimprurëse dhe jo nga mediat tradicionale, prandaj edhe i mbështesin.

Disa nga shembujt më të suksesshëm në Europë janë The Guardian në Britaninë e Madhe dhe De Correspondent në Holandë. Puna e gazetarëve të The Guardian mbështetet sot financiarisht nga 300 mijë qytetarë, ndërsa në 2016 ishin vetëm 12 mijë.

Por nëse media britanike ishte krijuar dhe funksiononte më parë, De Correspondent në Holandë, është një krijim tërësisht i rreth 40 mijë qytetarëve holandezë, të cilët kontribuan me 1.7 milion Dollarë. Sot numri i qytetarëve që mbështesin redaksinë ka arritur në 55 mijë dhe numri i gazetarëve me kohë të plotë ka shkuar në 21.

¹ A na duhen gazetarët?, Eric Scherer, Papirus 2012, Fq. 33

Disa nga këto praktika tregojnë se publiku do të kërkojë gjithmonë produktet profesionale, të besueshme dhe se gazetaria do të vazhdojë të ekzistojë edhe në të ardhmen.

Ky është edhe modeli në të cilin bazohet edhe Citizens Channel. Pas një periudhe financimi pa asnjë ndikim në linjën editoriale nga donatorë të ndryshëm derisa të bëhet i njohur mjaftueshëm dhe një zë i besueshëm mediatik, qëllimi është që redaksia të financohet 100% nga qytetarët shqiptarë, duke e gjykuar si të vetmen mënyrë për të qenë të pavarur.

Shumë kolegë janë treguar skeptikë dhe numërohen me gishtat e njëdore ata që mendojnë se ne do t'ia arrijmë këtij qëllimi në Shqipëri, por ekipi i Citizens Channel beson se diçka e tillë është e mundur dhe ka ardhur momenti!

GRUPET E MARGJINALIZUARA NË SYTË E MEDIAS SHQIPTARE

- Mediat tradicionale dhe ato online zakonisht luajnë një rol pozitiv dhe informues në shoqëri. Sidoqoftë ka mjaft raste të dokumentuara të materialeve mediatike me përmbajtje diskriminuese dhe përforcim të stereotipeve.
- Analizimi i treguesve strukturalë – media, profesionistët e medias, etj – dhe treguesve të përmbajtjes së materialeve mediatike, është i rëndësishëm për institucionet përkatëse të identifikojnë llojin dhe kohën e përshtatshme të “ndërhyrjes” në media.
- Ekzistojnë një numër i madh mundësish për të “ndërhyrë” në përmirësimin e situatës mediatike, që nga trajnimi i gazetarëve, forcimi i marrëdhënieve me vet komunitetet e marginalizuara etj.

Mediat kanë luajtur gjithmonë një rol themelor në zhvillimin e shoqërive demokratike duke denoncuar abuzimet e të drejtave të njeriut dhe promovimin e respektimit të tyre. Gjatë viteve të fundit, informacioni i shpërndarë në media ka filluar të luajë një rol të madh në ndikimin e interpretimit të realitetit, duke i dhënë kështu mediave një përgjegjësi të re për shkak të impaktit politik, social dhe kulturor që lajmet marrin jo vetëm në një vend por edhe ndërkombëtarisht.

Mediat mund të ndikojnë nga njëra anë në lëvizjen e një shoqërie drejt gjithëpërfshirjes sociale por edhe drejt thellimit të hendekut midis minoriteteve dhe maxhorancës së popullsisë. Kjo ndodh jo vetëm në mënyrë direkte dhe me dashje nga profesionistët e mediave por edhe indirekt kur ka aftësi të dobëta profesionale tek reporterët, editorët etj, apo kur kultura e medias është e pazhvilluar mirë. Në rrethana të tilla është më e mundshme që gazetarët të nxisin diskriminimin apo të përforcojnë stereotipet nëpërmjet mënyrës së raportimit, edhe pse qëllimet e tyre mund të mos jenë domosdoshmërisht dashakeqëse.

Nëpërmjet këtij punimi synohet të paraqitet një panoramë e përgjithshme e gjuhës që përdor media shqiptare tradicionale dhe online ndaj grupeve të ndryshme sociale. Ky hulumtim është i ndarë në dy seksione. Në seksionin e parë paraqiten qëndrimet e përfaqësuesve të disa prej organizatave në mbrojtje të grupeve të marginalizuara në vend. Duke u ndalur tek roli që luan media sot në zhdukjen apo përforcimin e perceptimeve diskriminuese në shoqëri si edhe format më të shpeshta të diskriminimit që hasim në media për gratë, komunitetin Rom dhe Egjiptian, LGBTI dhe Personat me Aftësi të Kufizuara. Ndërsa në seksionin e dytë bëhet një panoramë e situatës mediatike online, bazuar në monitorimin e bërë në dy vitet e fundit nga portali për të drejtat e njeriut “Historia Ime” – “Gjuha e Urrejtjes dhe Diskriminuese në Median Online”.

ÇFARË QUAJM DISKRIMINIM?

Diskriminimi është procesi në të cilin anëtarët e një grupi të përcaktuar në shoqëri trajtohen ndryshe për shkak të “anëtarësismit” të tyre në atë grup (Krieger 1999). Diskriminimi paraqet një model të trajtimit të padrejtë, i justifikuar nga besimet dhe i shprehur nëpërmjet ndërveprimeve mes individëve dhe institucioneve dhe synon të ruajë privilegjet e “anëtarëve” të grupeve dominante me koston e privimit të të tjerëve (Krieger 1999). Diskriminimi mund të bazohet në një sërë karakteristikash, duke përfshirë: orientimin seksual, identitetin gjinor, përkatësinë etnike, kulturën, gjininë, fenë, aftësinë e kufizuar, moshën etj.

Në Shqipëri garantohet me ligj mbrojtja nga cilado formë e diskriminimit. Sipas ligjit **“Për Mbrojtjen nga Diskriminim” (LMD) i hartuar me bashkëpunimin e OSBE-së dhe i ndryshuar në datë 04.02.2010, në nenin 1 thuhet: „Ky ligj rregullon zbatimin dhe respektimin e parimit të barazisë në lidhje me gjininë, racën, ngjyrën, etninë, gjuhën, identitetin gjinor, orientimin seksual, bindjet politike, fetare ose filozofike, gjendjen ekonomike, arsimore ose shoqërore, shtatzaninë, përkatësinë prindërore, përgjegjësinë prindërore, moshën, gjendjen familjare ose martesore, gjendjen civile, vendbanimin, gjendjen shëndetësore, predispozicione gjenetike, aftësinë e kufizuar, përkatësinë në një grup të veçantë, ose me çdo shkak tjetër“.**

Ligji përfshin që nga reklamata diskriminuese, deri tek pjesëmarrja në politikë, punësimi, arsimi dhe të mirat dhe shërbimet si në sektorin publik dhe atë privat. Por miratimi i këtij ligji nuk solli domosdoshmërisht zbatimin në mënyrë të drejtë të tij, ndaj në raportet e vit pas viti të DASH apo KE për Shqipërinë, rekomandohet implementim më i mirë i ligjeve.

1.SI ËSHTË SITUATA SOT?

Format e ndryshme të marrjes së informacionit në mediat tradicionale dhe online janë burimi dominues përmes të cilit mësojmë rreth të tjerëve dhe botës së tyre, zhvillojmë qëndrime dhe besime siç manifestohen në shprehjet mediatike dhe formulojmë ndjenjën tonë të identitetit. Të njejtat media bëhen edhe burime diskriminimi nëpërmjet imazheve të ngarkuara me vlera që përjetësojnë përfaqësime përgjithësuese dhe stereotipe mbi grupe të ndryshme sociale, veçanërisht ndaj komuniteteve Rome dhe Egjiptiane, LGBTI, Personave me Aftësi të Kufizuar apo stereotipeve me bazë gjinore.

Në kuadër të këtij hulumtimi, janë realizuar biseda me përfaqësues të disa prej organizatave në mbrojtje të grupeve të marginalizuara. Të gjithë pranojnë se gjuha e përdorur në media ka ndryshuar në vitet e fundit, por vazhdon të ketë mangësi të mëdha në terminologji specifike si dhe “etja” për klikime dhe sensacionalizmi i lajmeve në mediat e reja ka çuar në përdorimin e gjuhës diskriminuese.

GRATË

Shoqëritë patriarkale mbahen nëpërmjet kultivimit të kujdesshëm – shpesh të pandërgjegjshëm – të sjelljeve që favorizojnë gjininë mashkullore dhe nxisin shoqërinë të besojë se një gjini është më mirë se tjetra, fenomen i njohur ndryshe edhe si seksizëm. Sipas Irena Shtraza, psikologe dhe menaxhere programi e Rrjetit të Fuqizimit të Gruas në Shqipëri (AWEN), raportimet në media nuk kanë pësuar ndryshime të mëdha. **“Të ndryshosh mënyrën se si portretizohen gratë në media do të thotë që të kesh ndryshuar edhe vetë perceptimet që ka shoqëria jonë”.**

Duke qenë se përmirësimi ka qenë i ngadaltë, edhe roli ndihmës që luan media në zhdukjen e këtyre fenomeneve është i kufizuar. Por nga ana tjetër stereotipet gjinore vazhdojnë të përforcohen dukshëm, duke filluar që nga reklammat mediatike ku tregohet se çfarë pritet nga një grua apo një burrë në shoqërinë tone e deri tek rastet e raportimit të dhunës me bazë gjinore apo krimeve në famlje me viktimë gruan. Sipas Shtrazës ka një nivel të lartë të mungesës së profesionalizmit:

“Në të shumtën e rasteve raportimet ngjajnë si biseda kafesh. Dua të them që fokusi vihet tek arsyet pse burri e dhunoj apo vrau gruan, çfarë e ka shtyrë, duke justifikuar shumë shpesh sjelljen e agresorit dhe duke vënë përballë ‘gjyqit’ publik gruan e masakruar”.

Por nuk është nevoja të pritet për krimet në familje, gjuhën diskriminuese me bazë gjinore dhe seksiste në media, e gjejmë lehtësisht edhe në raportimet për vajzat e trafikuar duke i vënë në faqet e para të gazetave dhe kronikave duke i quajtur “prostitutë”, duke publikuar imazhe e foto të papërshtatshme, detaje personale nga identiteti dhe historia e tyre; E gjejmë në emisione Talk Show ku që në momentin kur prezantohen gratë paneliste iu vendosen epitete (komplimente) që ka lidhje me pamjen e saj të jashtme (e bukur, elegante, e re, etj) apo rolin e saj riprodhues (nënë e 2 fëmijëve, etj) e shumë momente të tjera mediatike.

Irena Shtraza sqaron gjithashtu se gjatë punës është përballur me gra dhe vajza që për shkak të publikimit të mënyrës se si media i ka paraqitur faktet apo shkaqet që kanë çuar në shfaqjen e fenomenit - duke ‘legjitimuar’ arsyet e ngjarjes – kanë çuar në braktisjen e viktimës nga familjarët dhe miqtë dhe e kanë detyruar të largohet nga qyteti /fshati i saj. ·

KOMUNITETI ROM DHE EGJIPTIAN

Sipas Ervis Cota nga organizata “Lëvizja Rinore Egjiptiane – Rome”, në median shqiptare nuk ka ndodhur ndonjë ndryshim madhor sa i përket gjuhës së përdorur për raportimet ndaj komuniteteve rome dhe egjiptiane. Shpesh është një mungesë e thellë e njohurive rreth romëve dhe egjiptianve që ushqejnë klishe, paragjykime dhe shkaktojnë mbulim negativ mediatik, duke i lidhur Romët dhe Egjiptianët me varfërinë e skajshme, martesat e hershme apo probleme të tjera sociale.

Sipas Cotës, fakti që media trajton pothuajse vetëm anën e errët dhe të trishtë të këtyre grupeve vulnerable, nuk bën gjë tjetër veçse thekson dhe përforcon edhe më shumë stereotipet ndaj këtyre grupeve në sy të maxhorancës.

Një tjetër problematikë në mënyrën e raportimit të medias mbi komunitetin Rom dhe Egjiptian lidhet me mungesën e njohurive të gazetarëve me terminologjitë përkatëse. Shpesh ndodh që të paraqiten element të kulturës rome për familje egjiptiane dhe anasjelltas, të mos bëhet dallimi mes dy grupeve si dhe të përdoren përfaqësime përgjithësuese ndaj tyre.

Kujtojmë këtu rastin e përdorimit të gjuhës diskriminuese nga ana e ish-deputetit Ben Blushi. gjatë fjalimit të tij në takimin e Partisë Socialiste në Elbasan, deputeti Ben Blushi i është drejtuar një prej antarëve të asamblesë së PS, Hektor Çiftja, me një frazë fyese ndaj komunitetit Egjiptian – “Çiftja e jevgut”. Lajmi u përhap në media si diskriminim ndaj komunitetit Rom. Edhe vet ish-deputeti, i ftuar disa ditë më pas në emisionin “Opinion” i kërkoi ndjesë komunitetit Rom. Nisur nga kjo ngjarje, organizatat Rome dhe Egjiptiane i kanë dërguar një letër ku i japin informacione mbi dallimin dhe të përbashkëtat e komuniteteve.

Sipas aktivisit Ervis Cota, gjuha e përdorur në media – shpesh e legjitimuar edhe nga figura publike (kujtojmë rastet e analistit Henri Çili dhe Zv. Kryeministres Senida Mesi) – ndikon negativisht në jetesën e këtyre grupeve duke iu krijuar barriera si në marrëdhënie me institucionet ashtu edhe me shoqërinë.

KOMUNITETI LGBTI

Komuniteti LGBTI ka qenë në vitet e fundit një ndër komunitetet më të përfaqësuar në media. Përveç shtimit të tematikave LGBT në programet e mediave tradicionale dhe online, edhe nëpërmjet medias së komunitetit “Historia Ime”.

Një nga problemet kryesore të medias shqiptare sot është mungesa e njohurive mbi terminologjinë LGBTI (lezbike, gej, biseksual, transgjitorë, interseks). Ende ka media që nuk e shkruajnë siç duhet akronimin apo nuk i njohin përmbajtjen e tij. Shpesh sheh artikuj ku përdoret “transvestit” në vend të “transgjitor” pa pasur parasysh domethënien e secilit, të përdorurit të tërmit “transgjitor” si orientim seksual dhe jo identitet gjitor, e shumë mangësi të tjera. I tillë është rasti i pak muajve më parë në emisionin e pasdites “Rudina”, ku e ftuar ishte Linda Rei. Moderatorja i është drejtuar të ftuarës “**..ne do të fillojmë menjëherë me të ftuarin apo me të ftuarën..**” duke e dyzuar seksualitetin e të ftuarës edhe pse identiteti gjitor me të cilin Linda tashmë identifikohet është grua (pra e ftuar).

Një tjetër problematik lidhet me sensacionalizmin e ngjarjeve LGBTI. Sipas Xheni Karaj, edhe pse sot është shtuar interesi i gazetarëve për të mbuluar çështjet LGBTI, vazhdon të ketë artikuj me përmbajtje sensacionale si në përmbajtje dhe tituj me qëllime komerciale dhe jo informuese/ edukuese për publikun.

Edhe në rastin e personave LGBTI, problematike ngelen rastet e përkrahjes së gjuhës diskriminuese në hapësirat publike nga personazhe të njohura të politikës, gazetarisë dhe artit (Kujtojmë këtu reagimet e politikanëve Mesila Doda, Nard Ndoka, Eduart Ndoca, Artan Lame etj, artistët Julian Deda dhe Eneda Tarifa apo moderatorin Enkel Demi) dhe pasqyrimin e tyre në media pa mbajtur qëndrime ndaj reagimeve kundra të drejtave të njeriut.

Pasojat direkte të këtyre qëndrimeve bien mbi vet jetën e komunitetit LGBTI, si mbi individë të caktuar, ashtu edhe në përfundimin e stereotipeve dhe qëndrimeve negative ndaj një komuniteti të tërë. Për shkak të stereotipizimit dhe mbulimeve jo profesionale në media, një transgjitorë (A) ka vuajtur dhe vazhdon të ketë pasiguri në marrjen me qira të një banese për të jetuar. Shkak për mos lëshimin me qira nga ana e qytetarëve janë perceptimet e krijuara nga mbulimet mediatike si punonjëse seksi, e pastrehë etj. .

PERSONAT ME AFTËSI TË KUFIZUAR

Problematikat me të cilat hasen personat me aftësi të kufizuara në Shqipëri janë të shumta, duke filluar që nga mungesa e aksesit në shërbime në përditshmëri e deri në komunikimin e përdorur ndaj tyre. Blerta Çani, drejtuese e Fondacionit Shqiptar për Personat me Aftësi të Kufizuara (ADRF), thotë se sot shihen mjaft ndryshime në gjuhën e përdorur në media, duke ulur numrin e etiketimeve fyese dhe diskriminuese.

Sipas Çanit, trajnimet mbi etikën dhe terminologjinë me profesionistët e mediave dhe disa Fakultete të Gazetarisë në vend disa vite më parë, kanë sjellë ndërgjegjësimë në gjuhën e përdorur sot.

Problematikat e personave me aftësi të kufizuar janë ndër çështjet më pak të trajtuara nga mediat. Problematika kryesore sipas Çanit është se edhe kur trajtohen, shihen nën frymën e mëshirës dhe mundësisë për të dhuruar me qëllim për plotësimin e nevojave bazike të kësaj kategorie. Sot në media më shpesh haset gjuhë diskriminuese dhe jo etike ndaj aftësisë së kufizuar intelektuale.

2. PO MEDIAT E REJA KU QËNDROJNË?

Gjatë dy viteve të fundit, portali për të drejtat e njeriut “Historia Imë” ka realizuar një monitorim 3-mujor (në secilin vit) mbi “Gjuhën e urrejtjes dhe diskriminuese në mediat online”, për disa prej faqeve kryesore informative shqiptare. Qëllimi i monitorimit ka qenë vlerësimi i etikës në media dhe diagnostifikimi i problematikës së gjuhës së urrejtjes dhe diskriminimit në median shqiptare. Vëmendje e posaçme i është kushtuar portretizimit të grupeve të marginalizuara si dhe respektimit ose jo të të drejtave të njeriut.

Diskursi i përdorur nga media ka ndikim në praktikën diskriminuese dhe forcimin e stereotipeve në një shoqëri. Me fjalë të tjera, stereotipizimi thekson “anët tona të mira” dhe “anët e tyre të këqija”. Gjatë monitorimit, është vënë re se format më të shpeshta të gjuhës diskriminuese janë përmes:

- Përdorimi i fakteve të pavërteta, ekzagjerimeve, pavërtetësisë, fakteve mashtruese.
- Argumentimeve me të meta (përmes shtrembërimeve apo nxjerrjes jashtë kontekstit) ·
- Gjuha përçarëse e tipit NE vs. ATA

Gjatë vitit 2015 janë monitoruar 750 artikuj, nga të cilët në 123 është vërejtur përmbajtje diskriminuese direkte (në tekst) ose indirekte (nëpërmjet formave të multimedias). Në nivel përqindje, rezultojnë se gjuha e urrejtjes dhe diskriminimit në këtë monitorim ka qenë e drejtuar në 67.7 përqind të rasteve ndaj grupeve shoqërore (ndaj LGBT, komunitetit Rom, grave, grupeve të caktuar për shkak të bindjeve politike dhe grupeve me etni të ndryshme) dhe 32.3 përqind ndaj individëve të caktuar. Nga individët e diskriminuar apo të portretizuar me gjuhë urrejtje 59 përqind kanë qenë gra dhe 41 përqind kanë qenë burra.

Gjatë monitorimit të dy viteve, format më të spikatura të diskriminimit vijnë përmes:

- Titujve (shembull: **Jam këtu me skllaven time, gratë duhet të punojnë për ne/ Urimi i veçantë i Elseid Hysaj për Krisht lindje**)
- Rendit të fjalëve në fjali – (shembull: **...ka pafund raste të dënimit të burrave të dënuar për homoseksualizëm, kaq të shumtë ishin?**)
- Imazheve



- Mekanizmave retorikë – (shembull: **Tek e fundit kjo është politika e shqiptarëve, të na detyrojmë të ikim nga shtëpitë tona**)

PËRFUNDIME DHE REKOMANDIME

Media luan një rol të rëndësishëm në përforcimin e stereotipeve dhe diskriminimit ndaj grupeve të marginalizuara. Një ndër mënyrat si kjo realizohet është nëpërmjet gjuhës së përdorur në raportime, përdorimit të termave të gabuar, portretizimit negativ të grupeve të marginalizuara etj. Shpesh gjuha diskriminuese vjen nga figura të njohura publike (politikanë, media people, njerëz me pozitë), cka sjell dhe amplifikimin e deklaratave të tyre në media, duke shpërndarë gjuhë diskriminuese pa pasur një filtër nga gazetarët. - Pasojat direkte të këtyre qëndrimeve bien mbi vetë jetën e komuniteteve, si mbi individë të caktuar, ashtu edhe në përforcimin e stereotipeve dhe qëndrimeve negative ndaj grupeve të caktuara.

- Stereotipet gjinore, gjuha seksiste dhe ajo diskriminuese vazhdojnë të gjenden në mediat shqiptare, duke filluar që nga reklamat mediatike ku tregohet se çfarë pritet nga një grua apo një burrë në shoqërinë tone e deri tek rastet e raportimit të dhunës me bazë gjinore apo krimeve në familje me viktimë gruan. Shpesh fokusi vihet tek arsyet pse burri e dhunoi apo vrau gruan, çfarë e ka shtyrë, duke justifikuar shumë shpesh sjelljen e agresorit dhe duke vënë përballë 'gjiqit' publik viktimën.
- Vihet re një mungesë e thellë e njohurive të reporterëve rreth terminologjive specifike kundrejt komuniteteve LGBTI, Rome dhe Egjiptiane. Përkundrazi përdoren terma që ushqejnë klishe, paragjykime dhe përforcojnë perceptimet ekzistuese ndaj këtyre komuniteteve. Ka raste ku paraqiten elementë të kulturës rome për familje egjiptiane dhe anasjelltas, të mos bëhet dallimi mes dy grupeve si dhe të përdoren përfaqësime përgjithësuese ndaj tyre. Sa i përket personave LGBTI, ende ka media që nuk e shkruajnë siç duhet akronimin apo nuk i njohin përmbajtjen e tij. Shpesh sheh artikuj ku përdoret "transvestit" në vend të "transgjitor" pa pasur parasysh domethënien e secilit, të përdorurit të tërmit "transgjitor" si orientim seksual dhe jo identitet gjinor e shumë mangësi të tjera.

- Një tjetër përfundim lidhet me përfshirjen e komuniteteve të marginalizuara në media vetëm në lajme, apo ngjarje që përfocojnë perceptime klishe dhe trajtojnë pothuajse vetëm anën e errët dhe të trishtë të këtyre grupeve vulnerable. Kjo nuk bën gjë tjetër veçse thekson dhe përforcon edhe më shumë hendekun mes grupeve vulnerable dhe maxhorancës së shoqërisë.
- Në rastin e personave LGBTI, problematike ngelen momentet e përkrahjes së gjuhës diskriminuese në hapësirat publike nga personazhe të njohura të politikës, gazetarisë dhe artit (Kujtojmë këtu reagimet e politikanëve Mesila Doda, Nard Ndoka, Eduart Ndocaj, Artan Lame etj, artistët Julian Deda dhe Eneda Tarifa apo moderatori Enkel Demi) dhe pasqyrimin e tyre në media pa mbajtur qëndrime ndaj reagimeve kundra të drejtave të njeriut.
- Problematikat e personave me aftësi të kufizuar janë ndër çështjet më pak të trajtuara nga mediat. Problematika kryesore është se edhe kur trajtohen, shihen nën frymën e mëshirës dhe mundësisë për të dhuruar me qëllim për plotësimin e nevojave bazike të kësaj kategorie. Më shpesh haset gjuhë diskriminuese dhe jo etike ndaj aftësisë së kufizuar intelektuale.
- Diskursi i përdorur nga media ka ndikim në praktikën diskriminuese dhe forcimin e stereotipeve në një shoqëri. Gjatë monitorimit “Gjuha e urrejtjes dhe diskriminuese në mediat online” të realizuar nga portali për të drejtat e njeriut “Historia Ime”, format më të shpeshta të gjuhës diskriminuese janë përmes: Përdorimit të fakteve të pavërteta, ekzagjerimeve, pavërtetësisë, fakteve mashtruese; Argumentimeve me të meta (përmes shtrembërimeve apo nxjerrjes jashtë kontekstit) dhe Gjuhës përçarëse e (NE vs. ATA).

Sic tregon ky hulumtim, mediat mund të jenë mjete të fuqishme të përdorura nga aktorët që synojnë nxitjen e diskriminimit. Mediat janë shumëfishues: ato përforcojnë dhe shpërndajnë mesazhe dhe mendime. Media informon dhe keqinformon, formon pikëpamjet e individëve për të tjerët dhe mund të rrisë tensionet ose të nxisë mirëkuptimin. Ndaj lind nevoja për ndërhyrje që i referohen mbështetjes për zhvillimin e mediave profesionale.

- Mënyra kryesore është rritja e kapaciteteve të burimeve njerëzore nëpërmjet trajnimit të gazetarëve për terminologjitë apo gjuhën që duhet përdorur ndaj komuniteteve të caktuara, apo përmes trajnimit të kolegëve të tyre të kryer nga vet gazetarët (peer-to-peer). Sepse janë gazetarët ata që janë ura lidhëse ndërmjet komuniteteve dhe publikut të gjerë. Me gjithë zhvillimet e teknologjisë, në fund të fundit është etika e gazetarit ajo që përcakton cilësinë e raportimit. Përmirësimi i komponentëve teknikë ose materialë të mediumit nuk përmirësojnë në vetvete mesazhin.
- Promovimi i diversitetit në grupet e gazetarëve dhe mediat. Për të njohur një komunitet nuk mjafton të lexohet mbi ta por edhe të njihen realitetet e tyre. Është e rëndësishme të punohet me pjesëtarë të grupeve të caktuara sociale dhe OJF lokale, për t'i ndihmuar ata të përfshihen në media.
- Monitorimi i vazhdueshëm i sjelljes së medias në përpjekje për të identifikuar treguesit e përshkruar më lart në mënyrë që të mund të ndodhin ndërhyrjet e duhura si edhe bashkëpunimi ndërmjet strukturave përkrahëse për ta ndjekur deri në fund denoncimin e një rasti diskriminimi në media. Funksionimi si një zinxhir i institucioneve përkrahëse monitoruese të medias, organizatave lokale për komunitetet e caktuara dhe institucioneve përkrahëse mbrojtëse nga diskriminimi.



PARIMI I PREZUMIMIT TË PAFAJËSISE DHE RESPEKTIMI I TIJ NGA MEDIA

Rezoluta për etikën e gazetarisë e miratuar nga Asambleja Parlamentare e Këshillit të Evropës në vitin 1993 parashikon se **“Në gazetari, informacioni dhe opinionet duhet të respektojnë parimin e prezumimit të pafajësisë, në veçanti për çështjet që vazhdojnë të jenë nën gjykim dhe duhet të kufizohet dhënia e gjykimeve për këto çështje”.**

Sipas nenit 30 të Kushtetutës së RSH **“Kushdo quhet i pafajshëm, përderisa nuk i është provuar fajësia me vendim gjyqësor të formës së prerë”.** Neni 6, pika 2 e Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (KEDNJ) parashikon se **“Çdo person i akuzuar për një veprë penale prezumohet i pafajshëm, derisa fajësia e tij provohet ligjërisht”.** Edhe pse këto dy formulime janë disi të ndryshme, thelbi është i njëjtë.

Neni 4 i Kodit të Procedurës Penale, amenduar me ligjin nr. 35/2017, datë 30.3.2017, parashikon se **“1. I pandehuri prezumohet i pafajshëm gjersa nuk vërtetohet fajësia e tij me vendim gjyqësor të formës së prerë. Çdo dyshim për akuzën çmohet në favor të të pandehurit. 2. Gjykata jep vendim fajësie kur i pandehuri rezulton fajtor për faktin penal që i atribuohet përtej çdo dyshimi të arsyeshëm.”**

Zbatimi i prezumimit të pafajësisë vepron si në fazën e hetimeve paraprake dhe gjatë gjykimin. Është e drejtë e të akuzuarit të mos flasë. Është detyrë e prokurorisë të provojë akuzën, e cila ka barrën e provës. Për të qenë objektiv në bazë të versioneve të ngritura, prokuroria duhet të bëjë hetime të plota dhe të gjithëanshme, të mos jetë e njëanshme, të mos paragjykojë. Nëse çështja shkon për gjykim është prokurori që duhet të vërtetojë akuzën në gjyq. Është gjykata që duhet të respektojë kërkesën kushtetuese për një proces të rregullt ligjor, të jetë e panashme në administrimin dhe vlerësimin e provave, të argumentojë fajësinë apo pafajësinë e të pandehurit.

¹ Prezumimi i pafajësisë sipas KEDNJ-së, me fokus në rolin e medias dhe zyrtarët publikë - Konrad-Adenauer-Stiftung e.V., Rule of Law Program, South East Europe, Thorsten Geissler

Prezumimi i pafajësisë vlen edhe për median, në të cilën vetë ato raportojnë lajmin. Aty ku lajmet deklarohen ose nënkuptojnë fajin e një individit përpara se ai të dënohet, kjo minon prezumimin e pafajësisë dhe është shkelje e nenit 30 të Kushtetutës sonë dhe pikës 2 të nenit 6 të KEDNJ. Media dhe autoritetet publike duhet të shmangin cenimin e parimit të prezumimit të pafajësisë. Në disa raste, fushata intensive e medias mund të kërcënojë besueshmërinë e procesit gjyqësor, duke ndikuar opinionin publik dhe nëpërmjet tij gjyqtarët (**Baragiola kundër Zvicrës**).

Me ndihmën e dy juristeve të reja (Rovena Gashi dhe Ardita Kolmarku), janë vëzhguar në mënyrë sistematike në ditë të ndryshme të tre javëve të para të muajit Nëntor 2017, katër portale online, një gazetë si dhe faqet zyrtare të dy televizioneve të vendit tonë. Qëllimi i këtij vëzhgimi ishte të vlerësohej se sa respektohej nga media, parimi i prezumimit të pafajësisë, në raportimin për publikun të ngjarjeve apo çështjeve me natyrë penale. Mënyra se si media raporton ngjarjet e lidhura me personat e ndaluar, të arrestuar, personat nën hetim, të pandehurit apo atyre ndaj të cilëve mund të jetë paraqitur një kallëzim penal apo ekzistojnë dyshime se mund të kenë kryer vepër penale, të bën që të arrihet në përfundimin se shpesh, parimi i prezumimit të pafajësisë nuk respektohet. Mosrespektimi i këtij parimi në rastet e konstatuara vlerësoj se vjen edhe për shkakun se shpesh media nuk ka një kuptim të drejtë për pozitat procedurale në të cilat ndodhet personi për të cilin raportohet dhe për të drejtat që ai/ajo gëzon në të gjitha fazat e kryerjes së veprimeve nga policia, prokuroria dhe gjykata (para se vendimi të marrë formë të prerë).

Respektimi i këtij parimi nga mediat e monitoruara vlerësoj se është nën nivelin mesatar. Në rastet kur ky parim shkelet, kjo vihet re së pari më së shumti në titullin e lajmit dhe më pak në përmbajtjen e tij. Megjithatë, nuk mungojnë rastet kur si titulli dhe përmbajtja e lajmit përmbajnë citime që bien ndesh me kërkesat e këtij parimi. Përdorimi i titujve që cenojnë prezumimin e pafajësisë mund të vijë për të terhequr vëmendjen e publikut dhe rrjedhimisht për të rritur shikueshmërinë e lajmit. Në fakt, shpesh lexuesit e portaleve, për ekonomikitet të kohës mund të mjaftohen vetëm me leximin e titullit, shikimin e fotos, çka krijon ose mund të krijojë menjëherë tek ata bindjen e gabuar për fajësinë e personit. Pyetja që lind është se ku gabohet më së shumti nga media kur pasqyrohen ngjarje të tilla? Gabohet kur personi i dyshuar etiketohet me fjalë të tilla si “vrasës”, “abuzues”, “autor”, “autori i veprës penale” (i vrasjes, i përdhunimit, i vjedhjes, etj). Vihet re që në disa raste, media nuk ka një koncept të drejtë se çfarë është seanca gjyqësore për vlefësimin e ndalimit/arrestimit në flagrancë dhe të caktimit të masës së sigurimit. Nëse gjykata vleftëson ndalimin/arrestimin dhe cakton masë të sigurimit personal “arrest në burg” ose “arrest në shtëpi”, probabiliteti për të cenuar parimin e prezumimit të pafajësisë në lajmet e publikuara në media rritet. Nga një studim që Komiteti Shqiptar i Helsinkit ka bërë për zbatimin e masës së sigurisë “arrest në burg”, ka rezultuar një aplikim i lartë i kësaj mase. Në takimet e zhvilluara me gjyqtarët të gjykatave të monitoruara është raportuar se presioni publik, në mënyrë të veçantë ai mediatik si dhe mënyra se si reagojnë politikanët, funksionarë të lartë publikë në radhët e ekzekutivit për çështje të caktuara, kanë ndikuar në rritjen e trendit të zbatimit të kësaj mase.

Në ndonjë rast, media jep vlerësim për vendimin gjyqësor, i cili është sërish në shkelje të parimit të prezumimit të pafajësisë. Kështu, në titullin e një portali shkruhet “U dyshua si pjesë e grupeve kriminale/ Gjykata liron terroristin”. Një nga format e tjera në të cilat cenohet ky parim, është kur media pasqyron mekanizmin e ngjarjes, duke i përçuar faktet tek publiku në mënyrë të tillë që krijon bindjen tek ky i fundit se personi është fajtor. Kjo është vënë re, kur përdoren shprehje të tilla si, “Policia ndjek makinën e hajdutëve shqiptarë”, “Kanosi ish bashkëshorten”, “furnizonte gjimnazistët me lëndë narkotike”, etj. Kur media citon në mënyrë korrekte deklaratat e policisë ose të prokurorisë, vihet re një respektim më i mirë i parimit të prezumimit. Kjo për arsye se në njoftimet për shtyp, policia dhe në mënyrë të veçantë prokuroria janë të kujdesshme për të mos bërë referime që cenojnë prezumimin e pafajësisë së të shoqëruarve, ndaluarve/ arrestuarve, personave nën hetim apo të pandehurve.

² Portalet Shqiptarja.com, Lapsi.al, City News.al, Balkan web, Gazeta Shqip, Top Channel TV dhe Ora News TV.

Parimi i publicitetit në seancën gjyqësore i mundëson medias dhe publikut të ketë akses në të dhënat dhe informacionet lidhur me procesin gjyqësor. Në vendimin e dt.24 Janar të vitit 2001, Gjykata Kushtetuese Federale Gjermane vlerësoi se ndalimi me ligj i filmimeve televizive dhe regjistrimeve radiofonike në seancat gjyqësore, sipas ligjit për procedurat gjyqësore, është në përputhje me Kushtetutën. Sipas kësaj Gjykate, e drejta për çeljen e një burimi informacioni, nuk rrjedh nga liria e informimit dhe as nga liria e radiotelevizionit. Mbi bërjen të njohur të një burimi informacioni dhe modalitetet e përcimit të tij, vendos ai që është i autorizuar të ushtrojë këtë të drejtë.

Në këtë vendim, Gjykata Kushtetuese Federale e Gjermanisë vlerëson ndër të tjerash se “Kufizimi i publikimit me zë dhe me figurë në proceset gjyqësore merr parasysh kërkesën për ruajtjen e personalitetit si dhe nevojën për një procedurë të drejtë, për gjetjen e së vërtetës dhe së drejtës. Gjatë seancës gjyqësore mbrojtja e paprekshmërisë së personit merr një domethënie më të madhe sesa ajo që njeh ligji normalisht. Kjo nuk vlen vetëm, por sidomos për mbrojtjen e të akuzuarve dhe të dëshmitarëve në procese penale, të cilët pa dëshirën e tyre duhet t’i nënshtrohen situatës së tensionuar emotive të seancës por edhe të opinionit publik. ... Gjithashtu, mundësia për të regjistruar dhe filmuar duhej përjashtuar në interes të një procesi të rregullt dhe të garancisë, që të vihet drejtësi dhe të gjendet e drejta pa u shqetësuar. Opinioni mediatik është krejt i ndryshëm nga ai në sallën e gjyqit. Shumë njerëz ndryshojnë sjellje në prani të medias. Disa marrin zemër nga prania e tyre dhe disa dekurajohen. Rregullsia e procesit gjyqësor rrezikohet veçanërisht në proceset gjyqësore penale për të paditurit apo dëshmitarët, nëse për shkak të regjistrimeve apo filmimeve nga media, atyre u vjen turp të tregojnë gjëra të rëndësishme për gjetjen e të vërtetës, ndoshta gjëra intime, të sikletshme për ta për shkak të rrethanave të pamoralshme. Procesi i zbulimit të së vërtetës, mund të rrezikohet edhe kur personat e përfshirë në të, kanë predispozicion që t’ia përshtasin sjelljen e tyre efektit që pritet nga media.”

Në legjislationin tonë të brendshëm, nuk janë vendosur kufizime specifike ndaj medias sa i takon regjistrimit dhe transmetimit nga media të kronikave që mbulojnë çështjet gjyqësore, sidomos atyre penale, me përjashtim të rasteve kur Kodi i Procedurës Penale parashikon zhvillimin e seancës me dyer të mbyllura.

Me interes është qëndrimi i mbajtur nga Gjykata Supreme e Shteteve të Bashkuara të Amerikës për ndikimin e publicitetit, që i jep media fazës para gjyqësore në çështjet penale. Në disa vendime të hershme të kësaj Gjykate, publiciteti i medias gjatë kësaj faze ka ndikuar në cenimin e parimit të paanshmërisë së jurisë, rrjedhimisht edhe të parimit të prezumimit të pafajësisë së të pandehurve. Me kalimin e viteve, qëndrimi i kësaj gjykate ka ndryshuar në këtë drejtim, duke i dhënë epërsi publicitetit të medias në fazën paragjyqësore, i cili nuk ndikon në paanshmërinë e jurisë, vetëm nëse ka prova evidente që vërtetojnë të kundërtën. Edhe pse sistemi ligjor në shumicën e shteteve të Kontinentit Evropian, përfshi edhe vendin tonë, më së shumti ndryshon nga sistemi ligjor amerikan, ajo çka përbën me interes në jurisprudencën e Gjykatës Supreme Amerikane është mënyra se si ka evoluar interpretimi i saj për ruajtjen e balancës së drejtë midis parimeve të publicitetit, paanshmërisë dhe prezumimit të pafajësisë.

Me interes është pikëpamja e Gjykatës Supreme nën drejtimin e kryetarit Earl Warren mishëruar në opinionin për çështjet Marshall kundër Shteteve të Bashkuara (360 U.S. 310 (1959)) dhe Irvin kundër Dowd, 366 U.S. 717 (1961). Vendimim për çështjen Marshall u morr duke u mbështetur më shumë tek atributet mbikëqyresë të Gjykatës Supreme ndaj gjykatave federale se sa ndaj interpretimeve të Kushtetutës. Gjykata vendosi se juria, e cila kishtë dëgjuar nga shtyp për rekordet e mëparshme penale të të akuzuarit, prezumohet se është e paragjykuar pasi ky informacion nuk mund të jetë i pranueshëm në mënyrë tipike në fazat fillestare të gjyqimit të çështjes nga shteti.

Në çështjen Irvin, prezumimi i paragjykimit u bazua në Kushtetutë dhe u shkaktua nga një kombinim faktorësh. Gjykimi për këtë çështje u zhvillua në një zonë rurale, afër qytetit ku kishte ndodhur krimi. Publiciteti para se të fillonte gjykimi në zonën përkatëse ishte intensiv dhe i qëndrueshëm gjatë gjashtë muajve para se të zgjidhej juria.

Për shembull, shtypi deklaroi se Irvin ishte dënua për krime të mëparshme dhe se ai ishte identifikuar nga një formacion policor si vrasës i gjashtë personave, se ai ishte vendosur në vengjarjen e krimit për të cilin akuzohej, se ai kishte pranuar gjashtë vrasjet dhe se atij i ishte ofruar të pranonte fajin në këmbim për nëntëdhjetë e nëntë vjet burg. Shumë prej jurive që u caktuan për këtë çështje u ndikuan nga këto të dhëna. Në fillim të gjykimit, 268 nga 430 anëtarë potencialë të jurisë pranuan se kishin mendim absolut (të pandryshueshëm) se Irvin ishte fajtor. Rreth 90% e anëtarëve potencialë të jurisë, përfshi 8 prej tyre që u përzgjedhën, deklaruan se kishin disa opinione se Irvin ishte fajtor. Në këto rrethana, Gjykata e Lartë konkludoi se juria duhet të prezumohej se ishte e paragjykuar. Aplikimi i parimit të prezumimit të paragjykimit u kufizua nga Gjykata e Lartë në vendimin për çështjen Patton, k. Yount, 467 U.S. 1025 (1984). Një mësues i shkollës së mesme, Yount, u dënua nga gjykata e shtetit të Pensilvanisë pas gjykimit për herë të dytë, zhvilluar disa vite pasi kishte ndodhur krimi, një vrasje brutale e një prej studenteve të tij femra. Edhe në fillimet e gjyqit të dytë, vetëm 2 nga 163 anëtarët potencialë të jurisë nuk kishin dëgjuar për vrasjen dhe 126 prej tyre deklaruan se nuk mund të përjashtonin opinionin e tyre për fajësinë e Yount. Pesë nga 12 anëtarët e jurisë që morrën pjesë në gjykimin e dytë, deklaruan se ata e kishin krijuar paraprakisht mendimin për fajësinë e Yount dhe një prej tyre deklaroi se do kërkonte të silleshin prova pafajësie që të ndryshonte këtë mendim. Pavarësisht nga këto, Gjykata e Lartë konkludoi se gjyqtari i çështjes nuk kishte gabuar në procedurën për të gjykuar me juri. Ky vendim krijoi një precedent tjetër se paragjykimi që vjen nga publiciteti në raste të rralla mund të përbëjë bazë për kundërshtime të natyrës kushtetuese, përveç kur një anëtar jurie e ka pranuar/ deklaruar këtë paragjykim. Në përgjithësi, prezumimi i paragjykimit do të lindë vetëm kur mbulimi i medias ka qenë jashtëzakonisht nxitës apo kur shtypi ka mbizotëruar sallën e gjyqit duke bërë që shumica dërrmuese e anëtarëve të ardhshëm të jurisë të krijojnë mendime/opinione absolute (fikse) se i pandehuri është fajtor.

Lidhur me cenimin e parimit të prezumimit të pafajësisë ka një praktikë të larmishme Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut (GJEDNJ). Neni 6, paragrafi 2 i KEDNJ ndalon deklaratat e zyrtarëve publikë për hetimet penale që janë në proces, deklaratat këto që mund të inkurajojnë publikun për të besuar se personi i dyshuar është fajtor dhe që paragjykojnë vlerësimin e provave nga një organ gjyqësor kompetent (**Ismoilov dhe të tjerë k. Ruisë, § 161; Butkevicius k. Litanisë, § 53**).

Ka interes të dihet dhe të theksohet nëse duhet që ky parim duhet të respektohet nga çdo zyrtar publik, edhe nëse nuk e ushtron detyrën apo funksionet në organet e drejtësisë. Për ta bërë më të qartë këtë, më lejoni të veçoj dy nga vendimet e GJEDNJ-së. Në çështjen **Allenet de Ribemont kundër Francës**, Gjykata e Strasburgut konstatoi se informimi nga oficerët e lartë të policisë gjatë konferencës së shtypit, në prani të Ministrit të Brendshëm dhe me pjesëmarrjen e tij, se i ndaluar është fajtor për krimin ishte në kundërshtim me parimin e prezumimit të pafajësisë. Për vrasjen e një deputeti dhe ish – ministri, në konferencën për shtyp e cila u zhvillua në të njëjtën ditë që u ndaluan disa shtetas nga policia kriminale, Ministri i Punëve të Brendshme dhe dy oficerët të lartë të policisë përmendën çështjen e vrasjes. Televizioni francez transmetoi një reportazh nga konferenca në programet e informacionit. Ministri mes të tjerash deklaroi se **“Të gjithë personat e përzierë në çështjen gjenden në arrest pasi u ndalua z. De Varga – Hirshi. E para kjo është një çështje shumë e thjeshtë. ... Njëri nga oficerët, pyetjes së një gazetari se kush ishte figurë qendrore në këtë çështje, u përgjigj se nxitës ishin De Varga – Hirshi dhe de Ribemoni. Gjithashtu u përshkrua se si duhet të jetë kryer mekanizmi i krimit.**

³ Prezumimi i pafajësisë sipas KEDNJ-së, me fokus në rolin e medias dhe zyrtarët publikë - Konrad-Adenauer-Stiftung e.V., Rule of Law Program, South East Europe, Thorsten Geissler

⁴ Vendimi – 10 Shkurt i vitit 1995

GJEDNJ nënvizoi ndër të tjerash se “Autoriteteve nuk mund tu ndalohe të informojnë opinionin publik mbi zhvillimin e hetimeve në çështjen penale, por pa cenuar prezumimin e pafajësisë”. Konkluzion mjaft i rëndësishëm që paraqitet në këtë vendim është ai që prezumimi i pafajësisë mund të shkelet jo vetëm nga gjyqtari, por gjithashtu edhe nga autoritete të tjera publike.

Në vendimin e vitit 2013, **Ûrfi Çetinkaya k. Turqisë**, GJEDNJ konstatoi shkelje të parimit të prezumimit të pafajësisë. Në 5 Dhjetor të vitit 2003, pas konfiskimit të një sasive të konsiderueshme heroine, Komanda e Xhandërmarrisë lëshoi një deklaratë për shtyp, sipas të cilës shtetasi turk u etiketua si “trafikant ndërkombëtar droge” si dhe deklaroi që hetimet ishin në proces. E gjithë çështja pati një mbulim të gjerë mediatik në shtypin vendas dhe njoftimet në shtyp ishin jo profesionale. GJEDNJ kritikoi përdorimin e termit “trafikant ndërkombëtar droge”, i përdorur në mënyrë jo profesionale për të përshkruar **Ûrfi Çetinkaya** në njoftimin për shtyp. GJEDNJ e ka bërë të qartë në çështje të tjera se parimi i prezumimit të pafajësisë nuk i ndalon autoritetet të informojnë publikun për hetimet penale që janë në proces, por ky parim kërkon që ata ta bëjnë këtë me diskrecion dhe maturinë e nevojshme, në mënyrë që ky parim të respektohet (Fatullayev k. **Azerbajxhanit**, § 159; **Allenet de Ribemont k. Francës**, § 38; **Garycki k. Polonisë**, § 69). Lidhur me rolin e medias, GJEDNJ pranon se në një shoqëri demokratike, komentet e ashpra nga shtypi janë në disa raste të paevitueshme për çështjet që kanë lidhje me interesin publik (Viorel Burzo v. Romania, § 160; **Akay k. Turqisë**). Megjithatë, fushata e ashpër mediatike, ndikon negativisht në gjykimin e drejtë, duke ndikuar tek opinion publik, dhe rrjedhimisht, në trupin gjykues i ili duhet të vendosë për fajësinë ose jo të të akuzuarit (**Kuzmin k. Rusisë**, § 62)

Nëse do ti referoheshim praktikës tonë, nuk kanë qenë të pakta rastet që gjykatat më të larta të sistemit tonë gjyqësor kanë shqyrtuar çështje me objekt të cenimit të këtij parimi. Kam mendimin se ky parim është cenuar herë pas here edhe në konferencat e shtypit të organizuara nga përfaqësues të Kuvendit apo zyrtarë të tjerë të lartë. Organet e sistemit të drejtësisë penale kanë detyrimin ta zbatojnë këtë parim që në momentin kur kryhet kallëzim për ndjekje penale apo kur vihen në lëvizje kryesisht. Mirëpo në disa raste zëdhënësit e organeve të procedimit penal kanë bërë deklarata të parakohshme, jo vetëm për fajësinë e të ndaluarve, të akuzuarve apo të arrestuarve, por edhe për motivet e kryerjes së krimit.

Ajo çka ne shohim në rastet e krimeve të rënda është se prokuroria dhe policia janë nën presion. Puliku pret që hetimi të japë rezultate konkrete në kohë të shkurtër. Por kjo nuk mund të justifikojë mosrespektimin e dispozitave ligjore që udhëheqin parimin e procesit të rregullt. Gjithashtu gazetarët janë nën presion. Kryeredaktorët dhe pronarët e medias presin një qarkullim të lartë të lajmit që prodhohet nga media e tyre si dhe synojnë shifra të larta të shikueshmërisë së lajmeve. Historitë e mërzitshme nuk shiten. Por kjo nuk do të thotë që gazetarët mund të shkruajnë ose transmetojnë, çfarëdo që ata duan.

⁵ Prezumimi i pafajësisë sipas KEDNJ-së, me fokus në rolin e medias dhe zyrtarët publikë - Konrad-Adenauer-Stiftung e.V., Rule of Law Program, South East Europe, Thorsten Geissler

BIBLOGRAFI DHE REFERENCA

1. Konventa Evropiane e të Drejtave të Njeriut
2. Rezoluta për etikën e gazetarisë e Asamblesë Parlamentare të Këshillit të Evropës (1993)
3. Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë
4. Kodi i Procedurës Penale, miratuar me ligjin Nr.7905, datë 21.3.1995
5. Vendimi Gjykatës Kushtetuese Federale Gjermane (dt.24 Janar 2001)
6. Vendimet e Gjykatës Supreme Amerikane, Marshall kundër Shteteve të Bashkuara (360 U.S. 310 (1959) dhe Irvin kundër Dowd, 366 U.S 717 (1961), Patton, k. Yount, 467 U.S. 1025 (1984)
7. Prezumimi i pafajësisë sipas KEDNJ-së, me fokus në rolin e medias dhe zyrtarët publikë - Konrad-Adenauer-Stiftung e.V., Rule of Law Program, South East Europe, Thorsten Geissler
8. Jurisprudencë GJEDNJ (Baragiola kundër Zvicrës, Allenet de Ribemont kundër Francës (1995), Ürfi Çetinkaya k. Turqisë (2013)
9. Portalet Shqiptarja.com, Lapsi.al, City News.al, Balkan web, Gazeta Shqip, Top Channel TV dhe Ora News TV